



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË LUSHNJE

RAPORT AUDITIMI
MBI
(Auditimin Financiar dhe Përputhshmërisë)

“BASHKIA LUSHNJE”

TIRANË 2024

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4-11
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4-8
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	9-11
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	11
II.	HYRJA	11-15
1.	Objekti i auditimit	11
2.	Qëllimi i auditimit	11
3.	Identifikimi i çështjes	12
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	12
5.	Përgjegjësitë e audituesve	12
6.	Kriteret e vlerësimit	12-13
7.	Standardet e auditimit	13-14
8.	Metodat e auditimit	14-15
9.	Dokumentimi i auditimit	15
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	15-117
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	15
2.	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit.	16
2.1.	Mbi kontrollin e brendshëm financiar publik	16-38
2.2.	Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit	39-66
2.3.	Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për opinionin e pasqyrave të vitit 2022	66-95
2.4.	Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik	95-111
2.5.	Mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit	111-114
2.6.	Mbi organizimin dhe funksionimin e IMTV	114-117
2.7.	Të ndryshme të dala nga auditimi.	117-121
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	121-137
V.	ANEKSET	138-149

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
APP	Agjensia e Prokurimit Publik
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
NJA	Njësi Administrative.
IMTV	Inspektoriat i Mbrojtjes Territorit të Njësisë vendore

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 866/1, datë 13.10.2023, të miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi nga data 13.10.2023 deri në datën 20.11.2023, për periudhën nga 01.01.2022 deri më 31.12.2022 në Subjektin Bashkia Lushnje, u krye auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe Përputhshmërie” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

M. B, Përgjegjës Grupi

I.SH, anëtar

M. K, anëtar

E. S, anëtar

Fushat mbi të cilat është shtrirë auditimi, sipas programit të auditimit, janë pasqyrat financiare, për të cilat u auditua regjistrimi i të dhënave dhe mbajtja e kontabilitetit, saktësia e pasqyrave financiare, aplikimi i parimeve kontabël si edhe nëse transaksionet janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe parimet për një qeverisje të mirë në përmbushje të objektivave të institucionit, ngritja dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, vlerësimin e njësisë së auditit të brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, planifikimi për të ardhurat dhe masat e marra për arkëtimin e tyre, si edhe zbatimi i legjislacionit në fushën e prokurimeve, etj. Për këto u analizuan evidencat e marra nga subjekti i audituar, si dhe u përdorën testet e nevojshme si pjesë e procedurës së auditimit. Për pasqyrat financiare, auditimi u krye për pasqyrat e vitit 2022. Për gjetjet e konstatuara nga grupi i auditimit janë mbajtur 10 akte konstatimi, të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit Bashkia Lushnje, brenda afatit të periudhës së auditimit. Nga subjekti i audituar janë paraqitur observacione, mbi aktet e konstatimit dhe projektraportin për të cilat u reflektua nga grupi i auditimit, mangësitë e konstatuara gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, i cili i dërgohet subjektit për njohje dhe marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
-----	-----------------------	------------------------	----------	-------------

1	<p>Për vitin 2022 realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifet vendore në Bashkinë Lushnje paraqitet në masën 71.59 %, nga 610,900 mijë lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 437,372 mijë lekë. Referuar akt-rakordimeve për të ardhurat konstatohet se, për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet më shumë mbi planin, fakt që tregon se planifikimi i të ardhurave në disa zëra të ardhurash nuk është mbi baza reale si dhe në disa zëra të tjerë të ardhurash nuk është bërë punë e mjaftueshme për arkëtimin e tyre, gjë që ka sjellë ndikim negativ në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifet vendore, duke mospasqyruar saktë burimin e të ardhurave. Vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në fund të vitit 2021 është në vlerën 1,487,784,334 lekë, vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2022 është 155,493,118 lekë dhe gjendja e debitorëve në mënyrë progresive në fund të vitit 2022 është në vlerën 1,643,276,112 lekë e cila përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Detyrimet nga taksat dhe tarifet e biznesit të vogël dhe të madh në shumën 409,906,944 lekë; - Detyrimet nga taksat dhe tarifet e familjareve në shumën 1,233,369,168 lekë; <p>Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 89,90,91 93 dhe 94, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime neni 181.VKB nr. 100, datë 23.12.2021 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Lushnjes dhe penalitetet për kundravajtjet administrative për vitin 2022”.</p>		E lartë	<p>Drejtoria e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Lushnje, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifet vendore në fund të vitit 2022 në vlerën progresive 1,643,276,112 lekë, ku përveç masave shtërguese të marra si urdhër bllokimet e llogarive bankare, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme), në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar dhe nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal. - Të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Lushnje, për mos kalimin e subjekteve debitore me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq. - Në dosjet e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.
2	<p>Në Bashkinë Lushnje aktualisht familjet ngarkohen me detyrime për taksën e ndërtesës e truallit dhe tarifet pastrim-gjelbërim-ndricimit. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, në Bashkinë Lushnje dhe NJA taksohen gjithësej 57680 familje më shumë se numri i familjeve të regjistrit aktual të Gjendjes Civile prej 20,283 familje, numër i cili shërben për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë "familjar". Nga familjarët e taksuar konstatohet se në Bashkinë Lushnje dhe NJA në fund të vitit 2021 janë trashëguar 44366 familje me vlerë debitorë prej 770,085,178 lekë dhe në fund të vitit 2022, janë gjithësej 45411 familje debitore për vlerën 815,931,493 lekë, nga të cilat 39768 taksapagues për vlerën 61,451,531 lekë janë debitor të krijuar brenda vitit 2022. Bashkia Lushnje ka si Agjent Tatimor për arkëtimin tarifës së</p>		E lartë	<p>Bashkia Lushnje nëpërmjet Drejtorisë së Ardhurave Vendore të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksa dhe tarifet vendore të debitorëve familjarë në vlerën vlerën 815,931,493 lekë, si dhe të plotësojë e përditësojë regjistrin për taksapaguesit e kategorisë familjare me të gjitha të dhënat e nevojshme, i cili të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve vendore, që ju linden familjeve referuar paketës fiskale</p>

	<p>pastrimit dhe taksën e ndërtesës Sha Ujësllës-Kanalizime Lushnje, e cila sipas aktrakordimit me Bashkinë Lushnje për të ardhurat rezulton se deri në fund të vitit 2022 ka mbetur pa u derdhur Bashkisë vlera në mënyrë progresive prej 58,253,311.09 lekë nga vlera e deklaruar e maturimit prej 58,253,311.09 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me VKB nr.100, datë 23.12.2021, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Lushnjes dhe penalitetet për kundravajtjet administrative për vitin 2022”, Kreu III neni 16,17, Kreu V “Taksa mbi truallin” neni 24, me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, neni 12 pika 1, me ligjin nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4 pika 7, me ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 70 dhe 117.”</p>			<p>të miratuar të Bashkisë Lushnje. Gjithashtu të shqyrtohet mundësia e arkëtimit të shumës së të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore të mbledhur nga agjenti tatimor Sha Ujësllës Kanalizime Lushnje në vlerën 58,253,311 lekë, nëse nuk është e mundur të shikohet mundësia e ndëshkimit me gjobë sipas dispozitave ligjore në fuqi për detyrimin e paderdhur ndaj Bashkisë.</p>
3	<p>Nga auditimi konstatohet se, realizimi i taksës bujqësore është në vlerën 45,904 mijë lekë nga 100,000 mijë lekë ose në masën 45.9%, ku 27648.16 Ha, sipërfaqe e shërben si bazë për planifikimin e kësaj takse. Rregjistri i taksës për tokën bujqësore ka mangësi në numrin e taksapaguesve objekt taksimi, pasi në këtë rregjistër nuk janë kryer përditësimet për cdo vit, pasi ASHK Lushnje nuk ka dërguar të dhëna mbi transaksionet e kryera në tokën bujqësore (shitje-blerje) me qëllim përditësimin e regjistrit të taksës së tokës bujqësore. Arkëtimi i kësaj takse paraqitet me problem në Bashkinë Lushnje, për arsye se familjet, të cilat taksohen për tokën bujqësore në 60 % të tyre janë të identifikuara me të dhënat personale (emër, atësia, mbiemër, Nr. Id, datëlindje) dhe 40 % e taksapaguesve nuk janë të identifikuara me të dhënat personale, me qëllim arkëtimin e kësaj takse. DAV Bashkia Lushnje arkëtimin e kësaj takse e mundëson vetëm kur familjari/personi që ka në përdorim/ pronësi tokë bujqësore, aplikon pranë Bashkisë Lushnje për të marrë një vërtetim/shërbim të caktuar, si dhe duke kryer procedurën e dërgimit të Njoftim detyrimeve me anën e shërbimit postar pranë adresave të deklaruara. Debitorët për taksën e tokës bujqësore në fund të vitit 2021 janë në vlerën 346,648,955 lekë, gjatë vitit 2022 janë krijuar 15047 familje debitorë për vlerën 70,788,720 lekë dhe në fund të vitit 2022 debitorët në vlerë progresive janë 417,437,675 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 pika 1, Aneksi 1 dhe me VKB nr.100, datë 23.12.2021, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Lushnjes dhe penalitetet për kundravajtjet administrative për vitin 2022” Kreu IV “Taksa mbi tokën bujqësore”</p>		E lartë	<p>Bashkia Lushnje, nëpërmjet Drejtorisë së të Ardhurave Vendore të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksën e taksës bujqësore nga debitorët fermerë në vlerën 417,437,675lekë. Drejtoria e të Ardhurave Vendore nëpërmjet Strukturave drejtuese të bashkëpunojë me ASHK Lushnje për marrje informacioni dhe të marrë masa për të identifikuar numrin e familjeve me të dhënat personale, që kanë në pronësi apo në përdorim tokë bujqësore si dhe sipërfaqen e saktë që ato zotërojnë, me qëllim krijimin e një regjistri me të dhëna të plota dhe të sakta. Ky regjistër më pas të shërbejë si bazë për të bërë, planifikimin e plotë dhe përlogaritjen e detyrimeve që ju lindin këtyre familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Lushnje.</p>

4	<p>Nga auditimi i dokumentacionit financiar të pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet e ndërtimeve informale rezulton se, në Bashkinë Lushnje vlera debitore për taksën e infratstrukturës nga përfituesit e legalizimeve deri në datë 31.12.2022 është 33,991,462 lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Lushnje. Vlera e debitorëve në fund të vitit 2021 prej 40,144,563.3 lekë e raportuar në KLSH nga bashkia Lushnje është vlerë e pasaktë për arsye se, është bërë mbledhja e gjendjes debitore progresive në fund të vitit 2020 prej 15,337,415.55 lekë dhe gjendja debitore progresive në fund të vitit 2021 prej 24,807,149lekë, duke dubluar vlerën e debitorëve. Nga korespondenca zyrtare e Bashkisë Mirditë me ASHK Rajonale Lushnje për periudhën objekt auditimi rezulton se, gjatë vitit 2022 është krijuar gjendje debitore prej 9,787,133 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, me ligjin nr. 95/2018 “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c, me ligjin nr. 98/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesane ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 1, “në nenin 27, pika 3, shkronja “c”, me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “ Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave përndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5 dhe me VKB nr. 100, datë 23.12.2021, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Lushnjës dhe penalitetet për kundravajtjet administrative për vitin 2022” kreu VII.</p>		E lartë	<p>Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Lushnje të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore mbi subjektet debitore për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 617 debitorë në vlerën 33,991,461 lekë, si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Lushnje të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) Rajonale, Lushnje për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen, si dhe të bëhen marrëveshje për bllokimin e veprimeve në dhënie e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.</p>
5	<p>Në territorin e Bashkisë Lushnje për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 78 subjekte me status “aktive” në QKB nga të cilët 68 subjekte me aktivitet karburant dhe 10 me aktivitet tregti gazi, gjithashtu 20 subjekte janë me status ç’regjistruar ose pezulluar. Për vitin 2022 janë konstatuar 38 subjekte pa licencën e tregtimit me pakicë të karburantit dhe 5 subjekte tregti gazi. Me shkresën nr.prot.6769, datë 01.08.2022 Bashkia Lushnjë ka dërguar informacion në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës dhe Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial u ka kërkuar marrjen e masave nga ana e tyre për bllokimin e të gjithë karburanteve dhe pikave të tregtimit të gazit, të cilat nuk janë të pajisura me Autorizimin përkatës, si dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar për marrjen e masave për të gjithë ata subjekte, të cilët nuk janë të pajisur me autorizimin e hyrje-dalje në autostradë. Nga ana e institucioneve të sipërpërmendura nuk është ndërmarrë asnjë masë për moslejimin e ushtrimit të aktivitetit për këto subjekte. Referuar dosjeve të subjekteve që operojnë në territorin e Bashkisë Lushnje për shitje me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tij konstatohet se, kanë detyrime të papaguara 39 subjekte në vlerën 29,550,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për</p>		E lartë	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Publike dhe Sociale të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për tarifën e autorizim/licencën në ushtrimin e aktivitetit të shitjes së hidrokarbureve, të papaguara nga 39 subjektet në vlerën 29,550,000 lekë të paraqitur në aneksi</p> <p>Nga strukturat drejtuese të Bashkisë Lushnje të vazhdohet komunikimi zyrtar institucional me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës, me Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial për marrjen e masave nga ana e tyre për bllokimin e të gjithë karburanteve dhe pikave të tregtimit të gazit, të pa licencuara, si dhe me Autoritetin Rrugor Shqiptar për marrjen e</p>

	<p>buxhetin e e Bashkisë Lushnje. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, nenet 4,15 dhe 20/2” dhe me VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, kreu II, pika 3, pika 15.1</p>			<p>masave për subjektet, të cilët nuk janë pajisur me autorizimin e hyrje-daljeve në autostradë.</p>
6	<p>Bashkia Lushnje ka lidhur 71 kontrata për dhënien me qira të aseteve, me subjekte të ndryshëm fizik/ juridik, kryesisht për veprimtari bujqësore e blegtorale e kultivim të ullirit në parcelat e fondit të tokave bujqësore të pandara, ku 48 kontrata në vitet 2013 me afat 99 vjecar, 1 me afat 40 vjecar dhe 11 me afat 30 vjecar, për dhënie me qira të pasurisë “truall” 2 kontrata me afat 20 vjecar, për veprimtari “Agropylltari” 3 kontrata me afat 10 vjecar dhe 1 kontratë me afat 5 vjecar për shfrytëzim të burimeve ujore nëntokësore në parcelat nga fondi pyjor, si dhe 5 kontrata me afat 1 vjecar për dhënie me qira të ambienteve të ndertesave për veprimtari tregtare. Kontratat shumëvjeçare nuk janë të noterizuara si dhe nuk ka të dhëna nëse janë rregjistruar në ASHK Drejtoria Lushnje. Kontratat nuk janë shoqëruar me procesverbalin e marrjes në dorëzim të parcelave sipas inventarizimit fizik të gjendjes në terren. Në asnjë rast të kontratave të qiradhënies nuk është parashikuar në kontratë marrja në konsideratë e ndryshimeve ligjore në lidhje me tarifën e qirasë si dhe nuk është kryer monitorimi i kontratave në lidhje me objektin dhe detyrimet e përdoruesit. Në fund të vitit 2021 janë debitorë 7 subjekte në vlerën 6,196,410 lekë, gjatë vitit 2022 është shtuar vlera debitore 479,806 lekë, ndërsa në fund të vitit 2022 janë 7 subjekte debitorë në vlerën 6,676,216 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Lushnje. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, nenet 826-829-840, me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4/ 26, neni11/4 dhe neni 12/f dhe UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kap III, pika 30, me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozoë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, me VKM nr. 391 datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” dhe me kontratat përkëtesë pika 4 “dispozita të veçanta”, neni “Pagesa”ose “Të drejtat dhe detyrimet e përdoruesit”</p>		E lartë	<p>Bashkia Lushnje nëpërmjet strukturave përgjegjëse për hartimin, menaxhimin dhe monitorimin e kontratave të qiradhënies të aseteve, të marrë masa për monitorimin e kontratave, në lidhje me zbatimin e objektit të kontratës, realizimin e detyrimeve të palës qiramarrëse, në lidhje me dëmtimet e pronës, dhe në të gjitha rastet të mbahen procesverbale dypalëshe. Nëse konstatohen parregullsi në zbatimin e kontratave të ndiqen procedurat administrative dhe ligjore pas shqyrtimit dhe miratimit në Këshill Bashkiak të problematikës. Të verifikohen nëpërmjet korespondencës zyrtare nëse kontratat afatgjatë janë të rregjistruara në ASHK Drejtoria Lushnje, nëse jo të bëhet rregjistrimi i tyre. Të ndiqen të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës debitore të 7 subjekteve, që nuk kanë paguar detyrimet kontraktore të tarifës së qirasë në vlerën 6,676,216 lekë.</p>

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinioni i auditimit financiar.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Lushnje për vitin ushtrimor 2022, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dhe shënimet në relacionin për llogaritë, që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një *opinion të pamodifikuar/pakualifikuar me theksim të çështjes* për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Lushnje, duke arritur në përfundimin se, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin e Pakualifikuar”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale (pa anomali materiale), pozitën financiare të njësisë vendore më 31 dhjetor 2022, në përputhje me bazën ligjore që rregullon raportimin financiar dhe atë buxhetor, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes, janë adresuar disa çështje (jo thelbësore), të cilat paraqiten në paragrafin “Theksimi i Çështjes” dhe duhet të jenë në vëmendje të njësisë vendore për sistemimin e tyre.

Baza për opinion:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë eProjekt Raportit të auditimit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 - Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30 - Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000 - Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare - Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipër përmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 2,042 mijë lekë. Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2022 kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare nuk përmbanin gabime materiale, por ekzistojnë aspekte që duhen nënvizuar, fakt ky që përbën bazën për opinion (ISA-705; ISSAI-1705). Këto aspekte nuk konsiderohen materiale, prandaj vetëm meritojnë evidentim, si theksim çështjesh. Për këto arsye kemi dhënë opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes, sipas përshkrimit të çështjeve të trajtuara në paragrafin e mëposhtëm:

“Theksimi i çështjes”

- Bashkia Lushnje ka 4 njësi shpenzuese të cilat janë Aparati dhe tre institucione të varësisë si: Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Pasurisë Publike, Qendra e Kulturës dhe Klubi i Sportit dhe Qendra e Arsimit, nga ku rezulton se për vitin 2022 nuk janë hartuar Pasqyrat Financiare të Konsoliduara.

- Në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, që në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 1,738,957,622 lekë, është përfshirë në mënyrë të gabuar sipas kërkesës së degës së Thesarit Lushnje gjendja e llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 15,538,975 lekë në pasiv të bilancit, e cila duhet të ishte pjesë e gjendjes së llogarive kundërparti të saj në aktiv të bilancit si llog. 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” ose llog. 4342 “Të tjera operatione me Shtetin (të drejta)”..

- Nga verifikimi i përlllogaritjeve të amortizimit të AAGJ, rezulton se amortizimi është llogaritur për grup aktivesh në total dhe jo aktiv për aktiv, duke mos përlllogaritur saktësisht amortizimin, pasi aktive të ndryshme kanë vlerë të ndryshme amortizimi të akumuluar sepse kanë kohë (vite) të ndryshme përdorimi. Në mungesë të regjistrit të aktiveve me të dhënat e tij u bë e pamundur sondazhi i përlllogaritjes së amortizimit për aktive të veçanta në llogari të ndryshme si dhe përlllogaritja e saktë e amortizimit të aktiveve për të bërë diferencën. Kështu në rastin e përlllogaritjes së aktiveve artikulli “kompjuter” është përlllogaritur gabim norma e amortizimit në masën 20% dhe jo 25%, sa i takon këtij grup aktivesh.

- Në inventarët kontabël të aktiveve materiale gjendje në fund të vitit 2022 në llogaritë: 210 “*Toka, Troje, Terrene*” është në vlerën 15,786,107 lekë; 211 “*Pyje, Plantacione*” në vlerën 249,000 lekë, 212 “*Ndërtesa Konstruksione*” në vlerën 411,698,111 lekë; 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” në vlerën 3,569,343,129 lekë; 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” në vlerën 23,109,446 lekë janë azhurnuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit, sipas emërtesave të projekteve të investimeve, pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv. Për këto aktive nuk është kryer inventar fizik për të verifikuar statusin e tyre, nëse ekzistojnë apo jo dhe marrjen e masave për ndjekjen e procedurave ligjore për sistemimin e tyre.

II. Opinioni mbi përputhshmërinë.

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Lushnje, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës për periudhën 01.01.2022-31.12.2022.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Lushnje, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin “Baza për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një *opinionit të modifikuar* për përputhshmërinë.

Baza për dhënien e opinionit të modifikuar:

Opinionin e dhënë e mbështesim në anomalitë e konstatuara, si më poshtë:

- Bashkisë Lushnje dhe 8 NJA i janë transferuar në pronësi /përdorim 6462 prona, nga të cilat janë hipotekuar 57 prona dhe janë në proces hipotekimi 54 prona. Për pjesën tjetër të pronave nuk është bërë inventarizimi dhe përditësimi i të dhënave. Nuk janë kryer procedurat për miratimin e listave përfundimtare të pronave dhe transferimin e tyre në Bashkinë Lushnje për 4 NJA Ballagat, Karbunarë, Hysgjokaj dhe Fiershegan.

- Kontratat shumëvjeçare për dhënien me qira të parcelave pyjore të tokave të pandara nuk janë të noterizuara si dhe nuk ka të dhëna nëse janë regjistruar në ASHK Drejtoria Lushnje si edhe nuk janë të shoqëruara me procesverbalin e marrjes në dorëzim të parcelës. Në asnjë rast të kontratave të qiradhënies së pronave nuk janë parashikuar në kontratë ndryshimet ligjore në lidhje me tarifën e qirasë, si dhe nuk është kryer monitorimi i tyre. Në fund të vitit 2022 janë 7 subjekte debitore në vlerën 6,676,216 lekë.

- Në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit mungon struktura (drejtori/sectorë/njësi) e dedikuar për Informacionin Gjeohapësinor (GIS), duke mos kryer proceset e grumbullimit, përpunimit dhe përditësimit të informacionit. Plani i detajuar vendor, nuk figuron i azhurnuar në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit në sistemin GIS.

- Struktura e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit nuk është plotësuar me punonjës sipas kërkesave ligjore, pasi K/Inspektori nuk është me profesion inxhinier ndërtimi.

- Në 3 raste prokurimesh në DST është kërkuar në mënyrë të gabuar *Çertifikata e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit OHSAS 18001-2007 ose ISO 45001-2018*, pasi është shfuqizuar dhe për rrjedhim do të duhej të kërkonte vetëm çertifikatën për standartin e përditësuar (ISO 45001:2018).
- Nga auditimi është konstatuar se në 5 procedurat e prokurimit si në DST ashtu dhe në Kontratat e lidhura me operatorët fitues, referuar grafikut të pagesës, nuk kanë qenë në dispozicion fondet e plota të nevojshme për realizimin e punëve, edhe pse kontratat kanë kohëzgjatje jo shumë vjeçare.
- Detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore për biznesin dhe familjarët në fund të vitit 2022 janë në vlerën 1,643,276,112 lekë;
- Për vitin 2022 janë konstatuar 38 subjekte pa licencën e tregëtimit me pakicë të karburantit dhe 5 subjekte tregëti gazi si edhe 39 subjekte kanë detyrime të papaguara në vlerën 29,550,000 lekë,
- Detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet e ndërtimeve informale deri në datë 31.12.2022 janë 33,991,461.8 lekë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë.

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimin të pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe të gjithë veprimtarisë që zhvillon Bashkia Lushnje.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH.

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojme bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

II. HYRJJE

1. Objekti i auditimit: Dhënia e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e Audituesve:

- nëse pasqyrat financiare janë hartuar në përputhje me rregullat dhe ligjet e kontabilitetit;
- nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik;
- nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në zbatim të ligjit të Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të të dhënave financiare;

2. Qëllimi i auditimit është dhënia e opinionit financiar për pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave,

kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord të procedurave të prokurimit, mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e Rekomandimeve për përmirësime. Për auditimin e **përputhshmërisë**, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara në periudhën nën auditim. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

3. Identifikimi i çështjes. Projektraporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjëseve të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektesë dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi. Ky Projekt Raport Auditimi, synon edhe përmisimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Lushnjë, si dhe përmirsimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. Kryetari i Bashkisë Lushnje (*Nëpunësi autorizues*) dhe Drejtori i Financës (*Nëpunësi zbatues*), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi. Sipas përcaktimeve të pikës 6 e neni 34, neni 65- *Administrata e njësisë administrative* dhe pika 1 “Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori” e neni 91, të ligjit nr. 139/15, dt. 17.12.15 “Për vetëqeverisjen vendore”.

5. Përgjegjësitë e Audituesve. Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

a) nëse shpenzimet janë ekzekutuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

b) nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;

c) nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara; etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320, dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm relevant në Bashkinë Lushnje, në mënyrë që të programoheshin procedurat e auditimit, që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit.

6. Kriteret e vlerësimit. Legjislacioni bazë e dytësor dhe dispozita të tjera si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, me ndryshime;

- Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funkcionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- Ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”.
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; i ndryshuar.
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 114/2015 “Për Auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
- Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK”.
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 ”Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”
- Udhëzimi MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, etj.
- UMF nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”.
- Rregullore “Mbi procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, daë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së e ndryshuar.
- Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Lezhë”;
- Ligji nr.162/2020 “Mbi prokurimin publik”, i ndryshuar

7. Standardet e auditimit të aplikuar në kryerjen e punës.

Standardet e zbatuara gjatë kryerjes së auditimit:

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik” që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 1000-2999 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;
- ISSAI 1300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”;
- INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik”si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë".
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime;
- Manuali i Auditit të Brendshëm, etj.

8. Metodat e auditimit.

Teknikat audituese:

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që

përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*)

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshime.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

Metodat audituese: -Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me **ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450**, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet. Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve.

Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

-Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti.

Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit.

Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH aplikon¹.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të **Riskut të Auditimit prej 5 %**, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (**ISSAI 1520**) dhe testeve thelbësore të kryera.

-Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve ne regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike si dhe në *kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra si dhe çështje të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura për përgatitjen e Projekt Raportit të Auditimit. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe përgatitjen më pas, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Evidencat mbështetëse si dhe dokumentacioni i përgatitur nga Grupi i Auditimit, janë pjesë e Projekt Raportit të Auditimit dhe për Raportin Përfundimtar të Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i shkurtër mbi subjektin.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi i auditimit i është referuar dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluar për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP për realizimin e prokurimeve me fonde publike dhe të ardhurave të veta, aktivitetet kryesore të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Auditimi në Bashkinë Lushnjë u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan shmangie dhe të meta në fushën e financës por jo të përhapura si dhe të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në fushën e të ardhurave, etj.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e konkluzioneve. Dokumentacioni i marrë për auditimin është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

¹ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

Në përfundim të punës audituese në terren, grupi i auditimit mbi problemet e konstatuara ka mbajtur akt-konstatime për çdo problematik të konstatuar, kopjet e të cilave u dorëzuan në zyrën e protokollit Bashkia Lushnjë deri me datë 20.11.2023, datë e mbylljes së punës audituese në terren. Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi i auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP për realizimin e prokurimeve me fonde publike dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Bashkia Lushnjë është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, Rregulloren e funksionimit të Këshillit Bashkiak, Rregullorja dhe akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Lushnjë.

1. Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik:

Profili i Bashkisë Lushnjë

Bashkia Lushnje numëron një popullsi banuese prej 83.659 vetë, ndërsa në Regjistrin Civil rezultojnë një popullsi prej 129.000 vetë. Sipërfaqja e bashkisë është 372.72 km². Në bazë të censusit, densiteti i popullsisë është 244.7 banorë për km² ndërsa në bazë të regjistrit civil densiteti është 341.91 banorë për km².

Kjo bashki përbëhet nga 11 njësi administrative, të cilat janë: Lushnjë, Allkaj, Bubullimë, Hysgjokaj, Golem, Dushk, Karbunarë, Ballagat, Fier Shegan, Kolonjë dhe Krutje. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Lushnjës dhe qarkut Fier. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 85 fshatra.



2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik

-Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Ky auditim u krye në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ndryshuar, si aktet ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar në planifikimin dhe përdorimin e burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, dhe si ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga Bashkia Lushnjë si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”

Mjedisi i kontrollit i jep tonin njësisë, duke influencuar vetëdijen kontrolluese të njerëzve të saj. Ai përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë duke siguruar disiplinën dhe strukturën. Mjedisi i kontrollit përbëhet nga dy aspekte: strukturat formale dhe aspektet e sjelljes individuale; dhe të dy duhet të ndërveprojnë. Menaxhimi ka rolin kyç në miratimin dhe mbështetjen e mjedisit të kontrollit. Faktorët e mjedisit të kontrollit përfshijnë integritetin, vlerat etike dhe aftësinë e stafit të njësisë; filozofinë e drejtimit dhe stilin e punës; mënyrën sesi menaxhimi cakton përgjegjësi dhe të drejta dhe organizon dhe zhvillon stafin, si dhe përkushtimin dhe orientimet që jep bordi i menaxherëve.

Parimi 1 - Njësia Publike demonstron angazhim për integritet dhe vlerat etike

Nëpërmjet këtij parimi është vlerësuar angazhimi i Bashkisë Lushnje në hartimin dhe zbatimin e elementëve dhe mekanizmave të nevojshëm për zhvillimin e integritetit dhe vlerave etike në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Nga analizimi i përgjigjeve të dhëna në pyetësorin e vetëvlerësimit evidentojmë se, Bashkia Lushnje ka miratuar Kodin e Etikës me urdhër nr.197, datë 12.12.2018 dhe Rregulloren e Brendshme nga Kryetari i Bashkisë me Vendimin nr.36 datë 06.04.2021 ku janë përfshirë rregullat e etikës, në të cilat përcaktohen parimet që duhet të respektojë çdo punonjës në punën e tij, si dhe rastet e konfliktit të interesit për zbatim nga stafi i punonjësve të bashkisë gjatë veprimtarisë në këtë institucion. Njohja e stafit me rregulloret dhe bazën ligjore në fuqi kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike sipas fushës dhe strukturave përkatëse nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore. Në këtë dokument, janë përcaktuar parimet, funksionimi, kompetencat dhe detyrat për çdo strukturë të institucionit.

- Për procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, është miratuar një veprim strategjik mbi antikorrupsionin dhe përmirësimin e transparencës me publikun për vitet 2020-2023. Gjithashtu është miratuar rregullorja “Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetin në Bashkinë Lushnje” dhe me vendimin nr. 172/1, datë 09.08.2021 rregullore “Për miratimin e rregullores për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në Bashkinë Lushnje”. Në Rregulloren e Brendshme në nenet 43 dhe 44 janë përcaktuar veprimet që parandalohen, të gjitha detyrimet dhe normat e sjelljes, ndërsa për ndëshkimin e rasteve ndiqen procedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjislacionin për Shërbimin Civil dhe Kodin e Punës. Eshte ngritur me Vendimin nr.2, datë 06.01.2021 Struktura përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve për Bashkinë Lushnje me dy specialistë të Auditit e cila raporton çdo fillim viti në Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit të Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të interesave (ILDKPKI).

Nga testimi rezultoi se nuk ka pasur raste të raportuara të shkeljeve të kodit etik.

Nuk ka programe të trajnimit nga Bashkia Lushnje për integritetin dhe sjelljen.

Për vitin 2022, punonjës të Bashkisë Lushnje nuk kanë marrë pjesë në trajnime të organizuara për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

- Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (zyra e marrëdhënieve me publikun), duke iu adresuar Kryetarit të Bashkisë dhe përgjigjia kthehet nga zyrat përkatëse. Në bashki është vendosur kutia e kërkesë -ankesave. Kjo procedurë është përcaktuar në nenin 20 të

Rregullores së Brendshme. Proceset e vlerësimit të punonjësve që kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil bëhen sipas formularit tip lidhja 2, çdo 6 muaj.

Parimi 2 - Titullari demonstron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.

-Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse, që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë përcaktuar që në rregulloren e brendshme të veprohet në bazë të saj.

- Nga Drejtoritë dhe Sektorët janë hartuar planet vjetore dhe mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve. Në Rregulloren e Brendshme, në detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha niveleve janë përcaktuar mënyra e raportimi i realizimit të planeve mujore nga Drejtorët në Aparatin e Bashkisë, Administratorët e NJA si dhe Drejtorët e Njësive të Varësisë drejtuar Nënkyretarëve të bashkisë sipas fushave që mbulojnë. Për çdo mbledhje të titullarit me stafin për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse janë mbajtur procesverbale.

-Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE:

Raporti i 4-mujorit të parë të vitit 2022 mbi zbatimin e buxhetit dhe raporti i vlerësimit financiar për situatën e gjendjes financiare është dërguar në ministri me shkresën nr.4739, dt 30.05.2022. Materiali është futur për informacion në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të muajit maj 2022.

Raporti i zbatimit të buxhetit për 4-mujorin e dytë dhe raporti i vlerësimit financiar për situatën e gjendjes financiare për 4-mujorin e dytë të vitit 2022 janë dërguar me shkresën nr.7948 date 12.09.2023 Materiali është futur për informacion në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të muajit shtator 2022.

Raporti Vjetor i Konsoliduar i zbatimit të buxhetit për vitin 2022, është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr.1749, datë 27.02.2023. Materiali është futur për miratim në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të muajit shkurt 2023.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Bashkia merr raportime në lidhje me vendim-marrjen e këshillit drejtues dhe raportime 6-mujore për performancën financiare për SHA ku bashkia është aksionere. Bashkia Lushnje ka tre shoqëri aksionere të cilat raportojnë pranë Këshillit bashkiak.

- Titullari nuk merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga Auditi i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese.

-Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

-Mungon ndarja e proceseve të punës dhe përcaktimi i detyrave që ka secili punonjës. Drejtoria Juridike nuk bashkëpunon me drejtoritë e tjera si Drejtoria e Financës, Drejtoria e Aseteve etj, për të zbatuar detyrat funksionale.

Parimi 3 - Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.

- Është hartuar Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionimit të Bashkisë Lushnje me Vendimin e Kryetarit nr.197, datë 06.04.2021.

- Është hartuar dhe miratuar deklarata e misionit dhe dokumenti i PBA me vendimin e këshillit bashkiak nr.62, dt.28.07.2022, por këto nuk janë përfshirë në rregulloren e brendshme. Në dokumentet e PBA-ve ka miratuar strategjinë me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje

me ligjin organik të buxhetit, si dhe plan veprimet e menaxhimit të financave, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.

- Sipas kontakteve të bëra me menaxhimin dhe pyetësorët, në hartimin e PBA-së, konfirmohet se kanë marrë pjesë drejtorët e drejtorive dhe të sektorëve (menaxherët e programeve), për të cilat janë mbajtur procesverbale të takimeve të tyre.

- Mënyra e informimit të stafit punonjës me rregulloren e brendshme, është kryer me metodën shkresore dhe elektronike, por nuk ka urdhër të veçantë të Kryetarit së Bashkisë.

-Rregullorja e brendshme i përgjigjet dhe përputhet me ndryshimet e strukturave organike, pasi për ndonjë funksion të ndryshuar apo të shtuar pranë Drejtorive.

-Eshtë hartuar plan i veprimi për menaxhimin financiar për vitin 2022 për monitorimin dhe arritjen e objektivave, në të cilin përfshihen, aktivitetet, plan veprimet për arritjen e qëllimeve strategjike, duke përcaktuar dhe afatet përkatëse dhe sektorët me personat përgjegjës.

Për periudhën objekt auditimi është miratuar struktura organizative në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e Bashkisë. Organigrama e Bashkisë Lushnje është e ndërtuar në mënyrë të tillë që, 2 nën/Kryetarët dhe 4 drejtuesit e Drejtorive kryesore bashkë me 15 Administratorët e NJA e 3 Titullarët e institucioneve të varësisë varen direkt nga Kryetari, ku dhe llogaridhënia është direkt tek Kryetari i Bashkisë në linjë horizontale, ndërsa nga niveli më i ulët specialist, përgjegjës sektori e specialistët llogaridhënia është në linjë vertikale. Strukturat organike sipas viteve janë:

Për vitin 2022 me Urdhër të Kryetarit nr. 229, datë 07.12.2021 “Për miratimin e strukturës organizative të bashkisë për vitin 2022 ” me 302 punonjës të miratuar dhe strukturë: Kabineti, 10 Drejtori, 11 Sektorë dhe 15 NJA.

- Në Rregulloren e Brendshme janë përfshirë baza ligjore, që i përket gjithë fushave të veprimtarisë së saj. Për çdo Drejtori janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialist, por nuk janë përcaktuar objektivat për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë. Po kështu edhe në dosjet e personelit janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, kurse objektivat për secilin punonjës janë të pasqyruara në vlerësimet e punës.

-Bashkia Lushnje ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet në të cilën janë paraqitur dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësi vendore.

-Vlerësimin e punës së strukturës organike, bashkia e kryen nëpërmjet plotësimit të vetëvlerësimit, nëpërmjet raporteve të auditimit, të cilat në fakt janë të përputhshmërisë dhe ka raporte performance të hartuar me ndihmën e projektit Bashki të forta.

Parimi 4 - Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave.

- Janë hartuar përshkrimet e punës për çdo pozicion pune dhe janë rishikuar për çdo vit. Janë kryer vlerësimet periodike të rezultateve individuale në punë të punonjësve sipas nën ndarjeve dhe fushave përkatëse.

- Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit, ka një plan vjetor të miratuar të rekrutimit, i cili është dërguar edhe pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

Në 3 raste të testuara të rekrutimit rezultoi se ishin kryer procedurat në përputhje me ligjin për Shërbimin Civil. Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale, e cila përmban të dhëna për marrëdhëniet e punës, arsimin, rekrutimin, kualifikimin, trajnimin, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë. Dokumentet përkatës që vërteton pohimin e bërë si: certifikata e gjendjes familjare; diploma e shkollës së lartë, lista e notave; certifikatat ose diplomat e kualifikimeve ose të specializimeve; dëshmi të gjuhëve të huaja, të tjera.

- Është një plan vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit por nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Nga vetë Bashkia ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

Gjithashtu, nga Bashkia Lushnje është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxherët e programeve, e cila i është dërguar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike.

-Për Bashkinë nëpunësi autorizues është Kryetari i Bashkisë, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor. Në kuptimin e filozofisë së menaxhimit dhe stilit të vepruarit nga menaxheri i njësisë në njësi veprohet në bazë të detyrave të caktuara në rregullore dhe kërkesa e llogarisë organizohet sipas hierarkisë së organigramës të përcaktuar, duke realizuar mbikëqyrjen e punonjësve për kryerjen e detyrave. Përsa i përket politikave dhe praktikave të ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregullore janë përcaktuar detyrat sipas Drejtorive dhe Sektorëve dhe linjat e raportimit. Në datë 23.12.2021 është miratuar nga Këshilli Bashkiak "Buxheti për vitin 2022" dhe Programi Buxhetor Afatmesëm 2022-2024. NA për vitin 2022 ka nxjerrë Urdhërin e ngritjes së GMS dhe të Ekipeve të Menaxhimit të Programeve nr.196, datë 31.01.2022.

- Nëpunësi zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin të përshtatur me pozicionin si Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit.

Parimi 5 - Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.

Në Rregulloren e Brendshme janë parashikuar “funksionet/detyrat që delegohen” në zbatim të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dalë nga protokoli i institucionit rezulton se për periudhën objekt auditimi nuk ka patur urdhëresa për delegime detyrash.

- Në zbatim të ligjit organik të buxhetit, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2019 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimit të MFE nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde për përgatitjen e PBA të njësive të Qeverisjes Vendore” Titullari i Bashkisë ka nxjerrë urdhra për ngritjen e GMS:

Për vitin 2022, për zbatimin e buxhetit të vitit 2022 miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak nr.101, dt 23.12.2021 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programeve për programe buxhetore me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr.196, datë 31.01.2022. Në rregulloren e Brendshme janë përcaktuar komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë, duke përfshirë edhe Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS). Nga verifikimi rezulton se GMS ka realizuar mbledhje periodike, 7 mbledhje të dokumentuara me PV përkatëse.

Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm” i cili përcakton se “Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Parimi 6 - Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me këto objektiva. Në regjistrin e riskut janë parashikuar të gjitha ngjarjet negative që ndikojnë në realizimin e objektivave të Bashkisë.

Bashkia Lushnjë në hartimin e PBA-ve miratuar me vendim të këshillit bashkiak nr.62, datë 28.07.2022 ka vendosur objektiva edhe në planet operacionale strategjike, në planet vjetore të veprimtarisë, në planifikimin e investimeve, në planet buxhetore vjetore, të cilat janë në përputhje me strategjitë dhe politikat sektoriale si dhe me vizionin dhe misionin e njësisë të përcaktuara në Planin e përgjithshëm Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Lushnjë. Këto objektiva bëhen të

njohura, si në stafin e bashkisë nëpërmjet shkresave drejtuara Drejtorive dhe duke u paraqitur bashkë me dokumentin e PBA në MFE, në këshillin Bashkiak, si dhe në dëgjesat me publikun. Për çdo Drejtori janë identifikuar fushat me risk të lartë të cilat ndikojnë në arritjen e objektivave dhe impakti që ato japin në realizimin e objektivave.

Në disa raste ka mospërputhje midis objektivave afatmesme (PBA) dhe objektivave të parashikuara në buxhetin vjetor të njësisë, por këto mospërputhje janë të vogla.

Parimi 7 - Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave.

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme nëse këto objektiva do të realizohen.

Në nenin 10 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se “Koordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinator i riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike. Në përmbushje të përgjegjësisë së tij, nëpunësi autorizues mund t’i delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e koordinimin e riskut punonjësve, pjesë të strukturës së financës.

Me urdhërin nr. 196, datë 26.07.2022 është përcaktuar koordinatori për menaxhimin e Riskut në Bashkinë Lushnje.

Është hartuar rregjistri i riskut me vendimin nr.4279 prot dt.17.05.2019(2019-2021) i rishikuar nga ai i viteve 2017-2019), ku është bërë identifikimi dhe vlerësimi i risqeve për Drejtoritë përkatëse. Në dokumentin e PBA-së është hartuar një kapitull i veçantë për riskun e çdo programi buxhetor por dhe sidomos për drejtoritë kryesore si për zyrën e Aseteve dhe Drejtorinë e të Ardhurave vendore.

Parimi 8 - Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrim

Krahas vlerësimit të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Në këto kushte, evidentohet se Bashkia Lushnje nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrim dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.

- Në Rregulloren e brendshme janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

Parimi 9 - Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm

Bashkia Lushnje në politikat dhe procedurat e veprimtarisë së saj ka marrë vazhdimisht në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni, apo nga ndryshimet në menaxhim, duke marrë masa për ti paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke përcaktuar detyrat në personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara.

III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”

Parimi 10 - Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë krahas detyrave janë identifikuar pak a shumë edhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës, të cilat i referohen edhe hartës së proceseve të punës të përcaktuara në dispozitat ligjore (si procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj).

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimit i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Financës dhe Buxhetit (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Nëpunësi Zbatues/Autorizimi i pagesës nga Kryetari i Bashkisë (NA). Struktura e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit përbëhet nga 5 punonjës, 1 Drejtor, 1 Përgjegjës Sektori.

- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit të komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i pranimit të mallit. Detyrat dhe përgjegjësit e NjHDT dhe KVO janë parashikuar edhe kapitullin V të Rregullores së Brendshme.

- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili është azhurnuar sa herë ka ndryshime fondesh dhe objekte prokurimesh. Ekzistojnë dosjet e procedurave të prokurimeve, ku gjurma e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumente autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet etj., të vulosura nga dega e Thesarit, e cila konfirmohet me regjistrimin në SIFQ dhe kalimin e veprimit financiar, pasi ka bërë çeljen e fondeve sipas kërkesës së institucionit, duke konfirmuar fondet disponibël.

- Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet si për shtesat edhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet i këtyre aktiveve.

Parimi 11 - Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë

- Bashkia Lushnje nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo cdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Ruajtja e të dhënave bëhet në mënyrë shkresore dhe elektronike.

Faqja Zyrtare e Bashkisë Lushnje në internet ka një sistem back-up.

Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

Parimi 12 - Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave

- Për aktivitetet e kontrollit janë përcaktuar përgjegjësitë si për drejtuesit dhe personelit tjetër të caktuar, ku përgjegjësitë janë të identifikuar në rregulloren e brendshme dhe në veprimtarinë e përditshme të Bashkisë, nuk ka plan-veprime të ndryshme operative për menaxhimin e riskut, pavarësisht se është bërë identifikimi dhe vlerësimi i riskut sipas aktiviteteve.

-Në nenin 8 të rregullores së brendshme janë përcaktuar qartë dhe të ndara detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit për të gjitha nivelet në të gjitha aktivitetet e përfshira, duke eliminuar riskun që i njëjti person të mos kryejë dy detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar si hartim, miratim, zbatim, monitorim.

-Për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve, duke iu referuar dispozitave ligjore në fuqi merret Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Administrimit të Pyjeve. Këto funksione janë përfshirë në detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre drejtorive neni 29 të rregullores së Brendshme.

-Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listëpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. Pasqyrat Financiare konfirmohen nga NA dhe NZ.

Kontabiliteti dhe hartimi i pasqyrave financiare kryhet në bazë të dispozitave ligjore në fuqi (Udhëzimit të MFE nr.8 datë 09.08.2018 “Për hartimin e PF”). Nga Auditi i jashtëm (KLSH) jepet opinion mbi besueshmërinë dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë në fund të vitit ushtrimor, mbi të cilat Bashkia është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

IV. Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”

Parimi 13 - Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor

Drejtuesit në Bashkinë Lushnje kanë identifikuar dhe përcaktuar informacionin e kërkuar nëpërmjet raportimit financiar dhe operacional, në nivelet përkatës dhe specifikat e duhura tek personeli i duhur.

Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit hartohen çdo 4-mujor dhe vjetori dhe dërgohen në MFE. Ka raportime periodike dhe vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit fondeve dhe analiza faktoriale të paraqitura pranë menaxhimit dhe këshillit bashkiak.

- Raportet për detyrimet e konstatuara, por të papaguara hartohen çdo muaj dhe paraqiten në degën e thesarit dhe çdo katër muaj në MFE. Stoku i detyrimeve të prapambetura për vitin 2022 është në vlerën 15,537mijë lekë (pa ndërmarrjet vartëse) Detyrimet dhe të drejtat janë paraqitur në llog. e klasës 4 në aktiv dhe pasiv të bilancit të PF.

- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Lushnje për mbajtjen e kontabilitetit operon me program excel, pa e dubluar programin SIFQ. Regjistrimet apo evidentimi në SIFQ i transaksioneve financiare së bashku me dokumentet shoqërues kryhet nga Specialistet e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit. Në bazë të këtij programi kontabiliteti me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe hartimi i pasqyrave financiare. Ndërsa monitorimi i të ardhurave kryhet me program Excel që e menaxhon Drejtoria e Tatim-Taksave. Për çdo muaj dhe vit kryhen akt-rakordimet me Degën e Thesarit për të ardhurat dhe shpenzimet. Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet bankës. Për lëvizjet AAGJM mbahen dokumente financiare dhe për çdo vit kryhet inventarizimi i tyre. Për aktivet e amortizuara dhe pa vlerë përdorimi kryhen procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimi në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

Parimi 14 - Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm, sistemin elektronik dhe shkresor

Parimi 15 - Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm ka faqen e saj zyrtare

Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit në nenet “Bashkëpunimi ndërmjet strukturave të administratës së Bashkisë”, neni 9 “Marrëdhëniet me Këshillin bashkiak”, neni 17 “Marrëdhëniet me institucionet e tjera”, neni 18 “Marrëdhëniet me publikun” neni 22 “Marrëdhëniet me Median”.

Informacioni që sigurohet nga drejtuesit dhe përgjegjësit e sektorëve i transmetohet Titullarit herë pas here, i cili informohet vetëm mbi shpenzimet aktuale dhe buxhetin e planifikuar. Nuk ka informacione nga Drejtoritë dhe sektoret e tjera si auditi, juridiku, urbanistika, imtv, etj..

Komunikimi zyrtar mes punonjësve të bashkisë realizohet me komunikim verbal e shkresor, gjithashtu kryhet edhe nëpërmjet sistemit elektronik përmes postës elektronike personale. Për mbledhjet e ndryshme të stafit drejtues dhe të menaxherëve me këshillin Bashkiak janë mbajtur procesverbale. Në faqen e Bashkisë Lushnjë janë të publikuar dokumentet kryesore, broshura, planet strategjike, raportet periodike, struktura organike, vendimet e këshillit bashkiak, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e Bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet, që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve.

- Ka raporte periodike dhe publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.

-Nga Bashkia Lushnje kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, të cilat janë të evidentuara në dokumentin e konsultimit publik.

Në lidhje me komunikimin e jashtëm, Bashkia Lushnje ka një faqe zyrtare <http://bashkia.lushnje.gov.al> në të cilën paraqiten informacione për publikun.

V. Komponenti “Monitorimi”

Parimi 16 - Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme

- Procedurat periodike të raportimit, që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, por mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet çdo 4 muaj. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.

- Bashkia monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar çdo vit pranë Drejtorisë Përgjithshme e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave,

- Për vitin 2022 me shkresën nr.prot.11086, datë 27.02.2023, të cilat janë dërguar Njesisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave “Deklarata për cilësinë e e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë Bashkia Lushnje dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”.

Në këto dokumente të hartuara është bërë deklarimi se si ka funksionuar në parim kontrolli i brendshëm në lidhje me realizimin e sistemeve të aktivitetit të Bashkisë në këto drejtime kryesore:

-Vlerësimi i performancës së Aparatit të Bashkisë nëpërmjet monitorimit.

-Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas përshkrimit në pyetësoin e vetëvlerësimit.

-Rekomandimet të metat dhe mangësitë e gjetura.

-Hartimi i plan-veprimeve për zbatimin e rekomandimeve dhe sidomos për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që përshkruhen në aktivitete e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe në përshkrimin e komponentëve të MFK.

Pjesë e Deklaratës është edhe fakti se si është realizuar ngritja dhe zbatimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej nëpunësit autorizues, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës.

Kjo realizohet nëpërmjet:

Monitorimit të veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe të rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit. Realizimit të “gjurmës së auditimit” që përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendim-marrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

Mbikëqyrjes së ndarjes së detyrave, caktimin e përgjegjësive, rishikimin sistematik dhe shprehjen e miratimit për punën e secilit punonjës në pika kritike, në mënyrë që të sigurohet se ajo është kryer sipas parashikimit. Udhëzimeve të dhëna dhe kryerjes së trajnimeve të nevojshme për punonjësit, për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe se direktivat e dhëna, të cilat duhet të kuptohen dhe të arrihen nga punonjësit.

- Në Bashkinë Lushnje mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, por është hartuar plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

- Për sistemin e kontrollit të brendshëm janë dhënë rekomandime nga KLSH dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të KBFP për vitin 2022, gjithashtu ka rekomandime edhe nga Auditi i brendshëm.

- Në Bashkinë Lushnje aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të performancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave të përshtatshmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

- Një nga drejtimet e monitorimit ka të bëjë me aktivitetin e Auditimit të Brendshëm.

Për vitin 2022 janë audituar nga Auditi i Brendshëm 10 Auditime nga 10 Auditime të planifikuara, por nuk janë audituar subjekte të vlerësuara me risk në planin strategjik, si Bashkia Lushnje. Gjatë vitit 2022 janë kryer 4 auditime të plota në njësitë e vartësisë si njësi shpenzuese me vehte dhe 6 auditime përputhshmërie. Për çdo auditim janë lënë rekomandimet përkatëse të cilat janë pasqyruar në Raportin për sistemin e kontrollit të brendshëm. Njësia e Auditit të Brendshëm ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara. Bashkia Lushnje nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi.

Parimi 17 - Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura në sistemin e kontrollit të brendshëm nga Drejtuesit e Programeve janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

- Titullari i këtij institucioni për rekomandimet e lëna nga KLSH edhe për ato të lëna nga Auditi i Brendshëm, është angazhuar për ndërmarrjen e masave korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Sa më sipër arrihet në konkluzion se:

Komponenti “Mjedisi i kontrollit”

-Bashkia Lushnje nuk ka hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike. Një problematikë tjetër e evidentuar është mungesa e programeve të trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullore apo kodin e etikës.

Është një plan vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit por nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

- Titullari nuk merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga Auditi i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese.

-Mungon ndarja e proceseve të punës dhe përcaktimi i detyrave që ka secili punonjës. Drejtoria Juridike nuk bashkëpunon me drejtoritë e tjera si Drejtoria e Financës, Drejtoria e Aseteve etj, për të zbatuar detyrat funksionale.

- Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm” i cili përcakton se “Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm.

Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Krahas vlerësimit të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Në këto kushte, evidentohet se Bashkia Lushnje nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.

Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”

- Bashkia Lushnje nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo cdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Ruajtja e të dhënave bëhet në mënyrë

shkresore dhe elektronike. Faqja Zyrtare e Bashkisë Lushnje në internet ka një sistem back-up. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

Komponenti “Informimi dhe komunikimi”

Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

Komponenti “Monitorimi”

- Në Bashkinë Lushnje mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, por është hartuar plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

-Në Bashkinë Lushnje aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të performancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave të përshtatshmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

-Njësia e Auditit të Brendshëm ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara. Bashkia Lushnje nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi.

-Nuk janë ndërtuar gjurmë auditimi për proceset kryesore të punës. Gjurmë auditimi ka vetëm Drejtoria Ekonomike.

Titulli i gjetjes	Mos zbatim i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit
Situata	<p>Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Bashkia Lushnje nuk ka hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike. Një problematikë tjetër e evidentuar është mungesa e programeve të trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës. Plani vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit nuk është i shoqëruar me buxhet të planifikuar për trajnime. -Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. -Titullari nuk merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga Auditimi i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese. -Mungon ndarja e proceseve të punës dhe përcaktimi i detyrave që ka secili punonjës. Drejtoria Juridike nuk bashkëpunon me drejtoritë e tjera si

	<p>Drejtoria e Financës, Drejtoria e Aseteve etj, për të zbatuar detyrat funksionale.</p> <p>-Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm” i cili përcakton se“Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm.</p> <p>-Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin, në këto kushte, evidentohet se Bashkia Lushnje nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime.</p> <p>-Bashkia Lushnje nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo cdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Ruajtja e të dhënave bëhet në mënyrë shkresore dhe elektronike.</p> <p>- Në Bashkinë Lushnje mungojnë rregullat e brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, por është hartuar plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.</p> <p>-Në Bashkinë Lushnje aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të performancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave të përshtatshmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.</p> <p>-Njësia e Auditit të Brendshëm ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara. Bashkia Lushnje nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi.</p> <p>-Nuk janë ndërtuar gjurmë auditimi për proceset kryesore të punës. Gjurmë auditimi ka vetëm Drejtoria Ekonomike.</p>
<p>Kriteri</p>	<p>-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 8, pika 8/a, 8/b; neni 9/3; neni 10; neni 12/3; neni 16; neni 18/1; neni 21/2; neni 27.</p> <p>-Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1.</p> <p>-Udhëzimi nr.16, datë 20.07.2016 ‘Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike’.</p>

	<p>-Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.</p> <p>-Ligji nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.</p> <p>-Vendimi nr. 142, datë 12.3.2014 ‘Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura’, neni 24; neni 35.</p> <p>-Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, neni 62.</p> <p>-Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” neni 4; neni 8.</p>
Ndikimi/Efekti	Mos zbatim i plotë i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, ka sjellë mungesë të kontrollit të brendshëm, duke riskuar përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve financiare publike, si edhe ndikim negativ në performancën e institucionit për kryerjen e veprimtarisë në përputhje me parimet e transparencës dhe ligjshmërisë.
Shkaku	Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor nga personat përgjegjës për MFK.
Rëndësia	E mesme
Rekomandim	<p>-Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme që të njohë punonjësit me aktet ligjore dhe nënligjore lidhur me MFK-në dhe të përcaktojë detyra të qarta mbi zbatimin e tyre.</p> <p>-Titullari i institucionit të ngrëjë një grup pune i cili të nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin e komponentëve të MFK-së dhe të hartojë një plan pune për zbatimin e menjëhershëm të tyre.</p> <p>-Titullari i institucionit të ndjekë me rigorozitet aplikimin dhe zbatimin e të gjithë komponentëve të MFK-së.</p>

1.2. Organizimi i Njesisë së Auditit të Brendshëm.

Në zbatim të pikës 1.2 dhe 1.3 të programit të auditimit, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

- Karta e Auditimit të Njesisë AB të Bashkisë Lushnje;
- Plani Strategjik dhe vjetor, si dhe pasqyrat shoqëruese;
- Programimi i auditimeve për vitin 2022;
- Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmoizimit të Auditit të Brendshëm;
- Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;
- Rekrutimi i punonjësve në Njesisë e Auditit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.
- Vlerësimi i auditimeve.

Auditimi u krye referuar akteve ligjore e nënligjore si më poshtë:

- Ligji Nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar;
- Ligji Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”;
- VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”;
- Manuali i “Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016;
- VKM nr.160, datë 02.03.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike” i ndryshuar;

-Udhëzimi Nr.42, datë 27.10.2020 “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”;

-Urdhëri nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”;

-Normat Tekniko Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Auditimi u fokusua kryesisht në këto çështje:

-Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm/Komitetit të Auditimit, niveli profesional i audituesve, çertifikimi i tyre dhe trajnimet e detyrueshme, bashkëpunimi me Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, niveli i raportimit në këtë drejtori,

-realizimi i treguesve të planifikuar nga DAB,

-sigurimi i cilësisë së auditimit, me qëllim vlerësimin nëse veprimtaria e auditit të brendshëm është në përputhje me kriteret ligjore dhe standardet e auditimit, konkretisht Ligjin Nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, “Manualin e Auditimit të Brendshëm”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100 datë 25.10.2016, Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

Nga auditimi i kryer mbi funksionimin e NJAB të Bashkisë Lushnje, rezultoi se:

➤ **Organizimi dhe funksionimi:** Bazuar në VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e NJAB në sektorin publik” Bashkia Lushnje ka ngritur NJAB.

Për vitin 2022, NJAB ka funksionur si sektor me 3 punonjës, 1 përgjegjës dhe 2 të tjerë janë specialistë të auditit sipas strukturës organizative të përcaktuar nga Titullari i Bashkisë me urdhrin nr.229 datë 07.12.2021 “Për miratimin e strukturës organizative të bashkisë për vitin 2022” miratuar me VKB nr. 99, datë 23.12.2021. Për këtë periudhë kjo zyrë ka organizuar punën audituese me 3 punonjës deri në muajin Maj të vitit 2022. Për periudhën Qershor - Korrik 2022 kjo zyrë ka punuar me 2 punonjës dhe është plotësuar me 3 punonjës në datën 10 Gusht të vitit 2022.

Konkluzion: Për vitin 2022, Njësia e Auditit të Brendshëm ka funksionuar me 3 (auditues), sipas strukturës së miratuar me VKB nr.99, datë 23.12.2021 “Për miratimin e nivelit të pagave dhe numrit të punonjësve të Bashkisë Lushnje, institucioneve në vartësi, njësive administrative për vitin 2022” në përputhje me VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” pika 3, e cila përcakton se: “Njësia e Auditimit të Brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3(tre) punonjës, përfshirë drejtuesin e njësisë. Në strukturën e Njësisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri 1/3 e punonjësve të pa certifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik.” Për një periudhë 2 mujore ky sektor ka funksionuar me 2 auditues.

Detyrat dhe kompetencat e NJAB janë përcaktuar në Projekt-draftin e Rregullores së Brendshme të funksionimit të Administratës së Bashkisë Lushnje, miratuar me vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 36/1 datë 06.04.2021 mbi bazën e së cilës funksionojnë të gjitha strukturat e Bashkisë.

Struktura e NJAB, niveli i arsimit, çertifikimi, përvoja dhe trajnimet e audituesve paraqiten në tabelën si mëposhtë:

Nr	Periudha 2022	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi në pune	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime të vijueshme
1	S. G.	Përgjegjës	Ekonomi Finance	32	12.6	Cert.2013	Jo
2	A.H.	Auditues	Drejtësi	7.6	2.2	Ne proces	Jo
3	E. P.	Auditues	Ekonomik Fin-Kont.	12	0.6	Në proces	Jo

Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes së punonjësve të strukturës së Auditit të Brendshëm rezulton se 1 punonjës (Përgjegjësi) është certifikuar dhe ka ndjekur në mënyrë të vazhdueshme trajnime për kualifikimin profesional, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 11 “Punësimi i Auditit të Brendshëm”, neni 19 “Certifikimi i audituesve të brendshëm” dhe neni 20 “Trajnimi i vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm” dhe 2 punonjës gjatë vitit 2022 kanë qenë në proces auditimi dhe janë certifikuar në muajin korrik të vitit 2023.

➤ **Komiteti i Auditimit të Brendshëm**, si organ i pavarur që duhet të monitorojë, ofrojë këshilla dhe rekomandime objektive për titullarin e njësisë publike lidhur me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe të mbështesë njësinë e auditimit të brendshëm në përmbushjen e përgjegjësiave të saj, nuk është krijuar nga Bashkia Lushnje.

Ministri i Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e organit që bashkërendon, harmonizon dhe monitoron veprimtarinë e auditimit të brendshëm në sektorin publik, me shkresën nr.13893.,prot, datë 22.07.2019 “Mbi krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, ka ofruar asistencë në lidhje me krijimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Lushnje nëpërmjet propozimit të disa hapave konkretë.

Referuar ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 12, pika b, përcakton se *Titullari i Njësisë Publike është përgjegjës për vendimmarrjen e krijimit të Komitetit të Auditimit.*

Nga auditimi rezulton se nuk ka Urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore, në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm” i cili përcakton se: *“Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm:*

a) duke siguruar pavarësinë e audituesit të brendshëm;

b) duke vlerësuar dhe dhënë mendime për planin strategjik dhe vjetor;

c) duke vlerësuar përshtatshmërinë e burimeve të auditimit;

ç) duke siguruar një monitorim të zbatimit të planit dhe rezultateve të auditimit;

d) duke monitoruar zbatimin e rekomandimeve të dhëna;

dh) duke këshilluar për çështjet lidhur me risqet, sistemet e kontrollit të brendshëm e të auditimit.

2. Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në ato njësi publike ku krijohet, e shtrin autoritetin për të gjitha njësitë e varësisë.

3. Mënyra e funksionimit, kompetencat dhe përbërja e Komitetit të Auditimit të Brendshëm rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave.

Konstatim: Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është krijuar, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 13 të ligjit 114/2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”.

➤ **Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik**

NJAB në mbështetje të Urdhrit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” ka hartuar “Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” në Bashkinë Lushnje, e cila është miratuar nga titullari me shkresën nr. 9719, datë 11.11.2019 dhe përditësuar me urdhër nr. 257, datë 02.10.2023.

➤ **Planet Strategjike dhe Vjetore**

Në mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik janë hartuar dhe miratuar planet strategjike sipas viteve:

Për vitin 2022 me shkresën nr.7715, datë 15.10.2021 është miratuar plani strategjik për vitet 2022 - 2024 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2022.

Këto plane janë dërguar zyrtarisht (por edhe me postë elektronike) në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në përputhje me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, me shkresën nr 7715 prot,datë 15.10.2021.

Njësia e AB në Bashkinë Lushnje, mbulon me auditim 15 subjekte (Bashkia Lushnje, 10 Njesi Administrative, Qendra e Kulturës dhe Klub Sporti, Ndërmarrja e Pasurisë Publike, Qendra e Arsimit, sha dhe Klubi i Futbollit Lushnja 1930). NjAB në hartimin e këtyre planeve është fokusuar në prioritetin e risqeve të identifikuara dhe ka marrë në konsideratë respektimin e frekuencës së kryerjes së auditimeve.

Konstatohet se duke konsideruar nivelin e riskut nuk është audituar Bashkia dhe drejtori të veçanta të saj, si Drejtoria Ligjore, Drejtoria e Taksave, Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Prokurimeve, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Shërbimeve, Drejtoria e urbanistikës, të ndihmës sociale, etj.

Konstatim: NjAB në hartimin e planeve është fokusuar në prioritetin e risqeve të identifikuara, por nuk ka marrë në konsideratë auditimin e aktivitete që kryen Bashkia Lushnje dhe drejtorive të veçanta të saj duke konsideruar nivelin e riskut, si Drejtoria Ligjore, Drejtoria e Taksave, Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Prokurimeve, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Shërbimeve, etj, ku sipas përcaktimit të bërë në pikën 3.1.3 të Manualit të Auditimit citohet se “Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit ndërsa për sistemet që vlerësohen me një nivel risku më të ulët mund të planifikohen për t’u audituar më rrallë, por jo më shumë se 5 vjet”.

➤ Realizimi i Planeve Vjetore

- **Për vitin 2022** janë parashikuar gjithsej 10 auditime në Bashki, institucione në vartësi si njësi shpenzuese më vehte dhe në njësitë administrative (ish komunat), ku sipas llojit janë 6 (gjashtë) të përputhshmërisë dhe 4 (katër) të kombinuar. Plani i angazhimeve në fillim të vitit përputhet me realizimin e auditimeve në fakt si për nga numri, objekti dhe lloji, duke u realizuar në masën 100%. Nuk ka patur ndryshime. Realizimi e auditimeve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
	Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga te realizuarat, sipas llojit				
			Përputh	Financë	Kombinuar	Performancë	Tjera
Viti 2022	10	10	6		4		

Raportimi Për veprimtarinë e NJAB Në Bashkinë Lushnje për periudhën objekt auditimi, është raportuar në mënyrë sistematike. Janë hartuar dhe dërguar në NJQHAB të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë raportet periodike vjetore të shoqëruara këto me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmbyllës për veprimtarinë e NJAB, përkatësisht: Me shkresën nr. 665/1prot, datë 07.02.2023, është dërguar Raporti Vjetor i Veprimtarisë së NJAB, Bashkia Lushnje për vitin 2022. Të dhënat për realizimet e angazhimeve nga AB për auditimet e kryera paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Nr	Subjektet e Audituar	Realizimi i angazhimeve të auditimit									
		Auditime të realizuara sipas llojit të tyre							Statusi i Angazhimit		
		Gjithsej	Shërbime të Sigurisë nga të cilat:					Shërbime Këshillimi	Me kërkesë titullari	Përfunduar	Në proces
			Përputhshmërisë	Performancë	Financiare	IT	Kombinuar				
1	Analiza e detyrimeve te prapambetura	1	1						1		
2	Njësia Administrative Bubullimë	1	1						1		
3	Njësia Administrative Kolonjë	1	1						1		
4	Njësia administrative Karbunarë	1	1						1		
5	Njësia administrative Ballagat	1	1						1		
6	Vlerësimi i rekomandimeve	1	1						1		
7	Qendra e Kulturës&KlubSporti	1				1			1		
8	Nderm.Mirëmbajtjes Pasurisë Publike	1				1			1		
9	Sh.A.Klubi i Futbollit Lushnje	1				1			1		
10	Qendra e Arsimit	1				1			1		
TOTALI		10	6			4			10		

Referuar sa më lart, konstatojmë se nga NJAB nuk janë kryer auditime financiare, performance dhe IT, me qëllim dhënien e rekomandimeve për këshillimin, përmirësimin dhe parandalimin e veprimeve të cilat sjellin devijime nga kuadri ligjor.

➤ **Gjetje-Rekomandimet**

Një aspekt mjaft i rëndësishëm i aktivitetit auditues është dhënia e rekomandimeve në përfundim të auditimeve, ku:

Për vitin 2022 Nga auditimet janë evidentuar 72 gjetje, për të cilat janë dhënë 72 rekomandime, nga të cilat 6 rekomandime për përmirësimin e sistemit, 55 rekomandime të karakterit organizativ, 7 rekomandime për arkëtime dhe 4 rekomandime të tjera, të cilat në mënyrë të përmblodhur paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime te shprehura ne numër				Rekomandime te shprehura ne vlerë (shpërbllim demi)			
		Gjithsej	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar	Gjithsej	Zbatuar	Ne proces	Pa zbatuar
	Viti 2022	72	47	21	4				
TOTALI		72	47	21	4				

Të dhënat e gjetjeve sipas fushave të auditimit dhe subjekteve të auditimit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	SUBJEKTI AUDITUAR	GJETJET SIPAS FUSHËS OSE SISTEMEVE NE NUMER									
		Sistemi i prokurimeve, blerjeve & investimeve	Sistemi i pagesave, shpërbllime, trajtime, komisione.	Fondet e sig. Shoq, sig.shendetesore, përkuqjdesje shoqërore	Sistemet e tatimeve, taksave, doganave	Sistemet e administrimit pronës, pasurisë	Sistemet e privatizimit, shitjes, qiradhënies	Sistemet e koncesioneve, ankandeve	Sistemet e legalizimeve,uUrbanistikës kthim pronash	Sistemet e kreditimit, subvencioneve	Të tjera
1	Analiza e detyrimeve te prapambetura									5	5
2	Njësia Administrative Bubullimë				3						3
3	Njësia Administrative Kolonjë				5						5
4	Njësia administrative Karbunarë				6						6
5	Njësia administrative Ballagat				4						4
6	Vlerësimi zbatimit të rekomandimeve										0

7	Qendra e Kulturës&KlubSporti	3	3							5	11
8	Nderm.Mirëmbajtjes Pasurisë Publike	3	6		1					5	15
9	Sh.A.Klubi i Futbollit Lushnje	2	2		1					1	6
10	Qendra e Arsimit	8	4			2				3	17
	TOTALI	16	15	0	20	2	0	0	0	19	72

Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve për periudhën audituese është bërë sipas përcaktimeve të manualit të Auditit të Brendshëm dhe udhëzimit nr. 42, datë 27.10.2020 “ Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”.

NJAB për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna gjatë vitit 2022 ka realizuar programin e auditimit nr.2066, datë 07.03.2023. Raporti i auditimit mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna gjatë vitit 2022 i është dërguar DHAB në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 2915, datë 04.04.2023. Rekomandimet sipas llojit dhe statusit të realizimit në subjektet e audituara, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Subjekti Audituar	Rek. të dhëna në vitin 2022	STATUSI I REKOMANDIMEVE					REKOMANDIMET SIPAS LLOJIT				
			Rekomandim i dhënë	Rekomandim i pranuar	Rekomandim i zbatuar	Në proces zbatimi	Rekomandim i pazbatuar	Rekomandime të përmirësimit e sistemeve	Rekomandime të përmirësimit e kuadrit ligjor	Rekomandime të karakterit organizativ	Rekomandime për arkëtim	Rekomandime të tjera
1	Analiza e detyrimeve të prapambetura	5	5	5		5				3	2	
2	Njësia Administrative Bubullimë	3	3	3	1	1	1			1	1	1
3	Njësia Administrative Kolonjë	5	5	5	3	1	1			3		1
4	Njësia administrative Karbunarë	6	6	6	2	3	1			5	1	1
5	Njësia administrative Ballagat	4	4	4	2	1	1			2	1	1
6	Vlerësimi i rekomandimeve											
7	Qendra e Kulturës&KlubSporti	11	11	11	8	3		2		9		
8	Nderm.Mirëmbajtjes Pasurisë Publike	15	15	15	12	3		2		12	1	
9	Sh.A.Klubi i Futbollit Lushnje	6	6	6	5	1				6		
10	Qendra e Arsimit	17	17	17	14	3		2		14	1	
	TOTALI	72	72	72	47	21	4	6		55	7	4

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve, rezulton se nga 72 masa të rekomanduara, janë pranuar 72 rekomandime, nga këto 47 rekomandime janë zbatuar, 21 rekomandime janë proces zbatimi dhe 4 rekomandime nuk janë zbatuar.

Nga auditimi rezulton se Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka marrë në shqyrtim dhe ka mbikëqyrur procesin e monitorimit e ndjekjes së rekomandimeve të dhëna nga struktura e auditimit të brendshëm. Grupi i auditimit nuk ka analizuar arsyet e mosrealizimit të rekomandimeve të mëparshme. Referuar Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kapitulli IV, pika 4.1.13.3 përcaktohet se: *Një njësi e mirë menaxhuar vendos procedura për t’u siguruar se çdo rekomandim i bërë nga njësia e AB, zbatohet ashtu siç duhet. Njësia e Auditimit të Brendshëm në bashkëpunim me menaxhimin cakton një punonjës me përvojë që të evidentojë të gjitha rekomandimet e bëra nga auditimi i brendshëm dhe të komunikojë, monitorojë dhe informojë për progresin që është bërë për zbatimin e tyre. Kjo do të ndihmojë që të sigurohet se përmirësimi i kontrolleve të brendshme është përgjegjësi e menaxhimit të njësisë publike dhe jo rol i Njësisë së Auditimit të Brendshëm”.*

1.3.Vlerësim mbi veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm.

➤ Vlerësimi i procedurave dhe standardeve të kryerjes së auditimit të brendshëm.
Nga auditimi i detajuar i dosjeve të auditimeve të kryera në subjektet:

Për vitin 2022 dosjet:

- 1.Ndërmarrja e Pasurisë Publike
- 2.Klubi i futbollit Lushnje
- 3.Qendra e Kulturës
- 4.Ndërm.Mirëmbajtjes Pasurisë Publike
- 5.Njësia Administrative Kolonjë
- 6.Qendra e Arsimit

Në lidhje me respektimin e kërkesave të manualit në hartimin e materialeve të auditimit për:

- a-Letrat e punës së auditimit në fazën përgatitore të programit;
- b-Letrat e punës në fazën e ekzaminimit të dokumentacionit të subjektit, hartimit të Projekt Raportit dhe Raportit Final nga audituesit;
- c- Bazueshmërinë ligjore të gjetjeve, argumentimin e konkluzioneve të nxjerra nga audituesit në përputhje me standartet e auditimit, rezultoi se:

Nuk janë respektuar kërkesat e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 11, neni 12, shkronja “d”, neni 19 dhe neni 20, të MAB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” i dryshuar me Urdhrin e Ministrit të MFE nr.4 datë 10.01.2020 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në MAB miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”, Kapitulli II 2.4.1 “Auditimi i përputhshmërisë” dhe 2.4.2 “Auditimi financiar”; Kapitulli III, pika 3.5;Kapitulli IV pika 4.1.1 “planifikimi i një angazhimi auditimi”, pikës 4.1.11 dhe 4.1.12; kapitulli VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese” pika 6.1“Niveli i dokumentimit”;

Në të gjitha dosjet e auditimit mungon “Memo e planifikimit”, pra projektdrafti i programit të auditimit në fazën përgatitore të hartimit të programit të angazhimit, në të cilën duhet të përfshihet:

- Madhësia dhe kompleksiteti i njësisë, prate kuptuarit dhe përshkrimi i mjedisit (universit) të auditimit, duke plotësuar edhe ;
- Përcaktimi i objektivave në bazë të rezultateve të vlerësimit të riskut.
- Eksperienca dhe numri i audituesve;
- Përgjegjësitë individuale të çdo audituesi;
- Kohëzgjatja(ose afatet kohore);
- Buxheti dhe afati kohor për angazhimin e auditimit;
- Masat për sigurimin e cilësisë;
- Në fund të procesit të auditimit mungojnë letrat e punës për secilin auditues të cilat duhet të përfshijnë rregjistrimin e punës së audituesit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemit.
- Nuk dokumentohet procesi i ndarjes së detyrave/sistemeve për tu vlerësuar, sipas drejtimeve të auditimit për secilin anëtar të grupit të punës në kundërshtim me pikën 4.1.1.2 të MAB, dokument ky i nevojshëm për vlerësimin e punës për secilin auditues.
- Në lidhje me vlerësimin e brendshëm të cilësisë, që kryhet nga vetë NjAB konstatohet se anekset “Monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë” dhe “vetëvlerësimin periodik”nuk janë plotësuar sipas përcaktimeve në pikën 7.1.1 në Kapitullin VII të MAB, të cilat nuk mbulojnë në të gjitha fazat e auditimit si dhe i mungon komponenti i tretë “Reagimet e subjektit të audituar”. Procedura e vlerësimit të brendshëm për çdo program angazhimi nuk kryhej, pasi nuk dokumentohej në asnjë nga dosjet e shqyrtuara, duke mos realizuar sigurimi i brendshëm të cilësisë së veprimtarisë audituese. Në programin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, nuk ka të përcaktuar Indikatorët e matjes së performancës, gjë që ka kushtëzuar hartimin e raporteve specifike të vlerësimit të performancës dhe si rrjedhim adresimin e rekomandimeve për

përmirësim, duke munguar raportimi tek Titullari për këtë procedurë. Procesi i vetëvlerësimit periodik sipas MAB përfshin:

-Mbikëqyrjen e angazhimeve të auditimit të brendshëm

-Përfundimin e listës së kontrolleve të përshkruara;

-Përpilimin e feedback-ut nga subjekti i audituar dhe palët e tjera të interesuara përmes intervistave dhe sondazheve;

-Përzgjedhjen e dokumenteve të punës për t'u rishikuar nga auditues të brendshëm që nuk kanë qenë përfshirë në atë angazhim auditimi;

- Mungon Memorandumi drejtuar Titullarit të Bashkisë mbi gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet, si dhe i mungon dhënia e opinionit mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit dhe cilat sisteme janë vlerësuar me risk.

- Në verifikimin e kryera në lidhje me zbatimin e rekomandimeve nuk është dhënë asnjë opinion apo analizë mbi arsyet e mos realizimit të rekomandimeve të mëparshme si dhe mungon konkluzioni nga audituesit për masat që duhet të marrë menaxhimi i subjektit të audituar për realizimin e tyre.

- Nuk është kryer ndjekja plan veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga NJAB, brenda 30 ditëve nga lënia e Raportit Përfundimtar.

- Nuk është plotësuar formulari 5 "Planifikimi i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB", sipas Manualit të Auditimit.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit në dispozicion u konstatua se:

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në nenin 13 të Ligjit nr. 114/2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*";

-Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik, nuk është hartuar në përputhje me formatin e paraqitur në Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 "*Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016*";

-Për vitin 2022, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete që kryen Bashkia Lushnje, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Drejtoria Ligjore, Drejtoria e Taksave, Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Urbanistikës, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Shërbimeve, auditime të teknologjisë së informacionit etj.

-"*Programi për sigurimin e brendshëm të cilësisë të drejtorisë së auditimit të brendshëm*", nuk ka të përcaktuara mjetet që do të përdoren për monitorim të vazhdueshëm dhe vetëvlerësim periodik, të cilat duhet të mbulojnë të gjitha fazat e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, me qëllim analizimin e nivelit të zbatimit të indikatorëve të performancës. Programit të miratuar i mungon komponenti "*Reagimet e subjektit të audituar*" në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm Kapitulli VII, pika 7.1.1;

- Nuk dokumentohet procesi i ndarjes së detyrave/sistemeve për tu vlerësuar, sipas drejtimeve të auditimit për secilin anëtar të grupit të punës në kundërshtim me pikën 4.1.1.2 të MAB, dokument ky i nevojshëm për vlerësimin e punës për secilin auditues.

-Audituesit e brendshëm nuk janë trajnuar në fushat e planifikuara në Planin Strategjik të Auditimit, miratuar me shkresën nr. 7715, datë 15.10.2021 dhe trajnime mbi menaxhimin e riskut, element ky i rëndësishëm në veprimtarinë e një institucioni bazuar në ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut;

- NJAB në periudhën objekt auditimi ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara;
- Raportet e Auditimit nuk kanë në përmbledhjen ekzekutive të përfshirë një përshkrim të shkurtër të subjektit sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapitulli IV, pika 4.1.12;
- Dosjet e auditimit nuk përmbajnë “Dokumentet e mbledhura përpara fillimit të angazhimit të auditimit” sipas kërkesave të MAB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të MF “Për miratimin e Manualit të AB në sektorin publik” i ndryshuar me Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020 kapitulli VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese” pika 2;
- Mungon Memorandumi drejtuar Titullarit të Bashkisë mbi gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet, si dhe i mungon dhënia e opinionit mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit dhe cilat sisteme janë vlerësuar me risk.

Titulli i Gjetjes	Mungesë dokumentacioni, gjurmimi në dosjet e audituara si dhe cënim i cilësisë dhe selektim në planifikimin e auditimeve
Situata	<p>-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit.</p> <p>-Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik, nuk është hartuar në përputhje me formatin e paraqitur në Manualit të Auditimit të Brendshëm.</p> <p>-Për vitin 2022, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete që kryen Bashkia Lushnje, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Drejtoria Ligjore, Drejtoria e Taksave, Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Urbanistikës, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Shërbimeve, auditime të teknologjisë së informacionit etj.</p> <p>-“Programi për sigurimin e brendshëm të cilësisë të drejtorisë së auditimit të brendshëm”, nuk ka të përcaktuara mjetet që do të përdoren për monitorim të vazhdueshëm dhe vetëvlerësim periodik, të cilat duhet të mbulojnë të gjitha fazat e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, me qëllim analizimin e nivelit të zbatimit të indikatorëve të performancës. Programit të miratuar i mungon komponenti “Reagimet e subjektit të audituar”.</p> <p>-Nuk dokumentohet procesi i ndarjes së detyrave/sistemeve për tu vlerësuar, sipas drejtimeve të auditimit për secilin anëtar të grupit të punës, dokument ky i nevojshëm për vlerësimin e punës për secilin auditues.</p> <p>-Audituesit e brendshëm nuk janë trajnuar në fushat e planifikuara në Planin Strategjik të Auditimit, miratuar me shkresën nr. 7715, datë 15.10.2021 dhe trajnime mbi menaxhimin e riskut.</p> <p>-NJAB në periudhën objekt auditimi ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara;</p> <p>-Raportet e Auditimit nuk kanë në përmbledhjen ekzekutive të përfshirë një përshkrim të shkurtër të subjektit sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm.</p> <p>-Dosjet e auditimit nuk përmbajnë “Dokumentet e mbledhura përpara fillimit të angazhimit të auditimit” sipas kërkesave të MAB.</p>

	-Mungon Memorandumi drejtuar Titullarit të Bashkisë mbi gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet, si dhënia e opinionit mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit dhe cilat sisteme janë vlerësuar me risk.
Kriteri	neni 13 i Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Urdhri nr.4, datë 10.01.2020 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”; Manuali i Auditimit të Brendshëm Kapitulli VII, pika 7.1.1; pika 4.1.1.2 të MAB, kapitulli IV, pika 4.1.12; Urdhri nr. 100, datë 25.10.2016 të MF “Për miratimin e Manualit të AB në sektorin publik” i ndryshuar me Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020 kapitulli VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese” pika 2;
Ndikimi/Efekti	Kryerja e auditimeve pa risk dhe që nuk ndjekin procedurat audituese nuk sjellin përmirësim të punës së institucionit.
Shkaku	Mungesa e kontrollit të cilësisë së auditimeve të kryera dhe mosplanifikim i riskut të auditimeve.
Rëndësia	E Lartë
Rekomandim	-Njësia e Auditimit të Brendshëm, të marrë masa për verifikimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e përfunduara, për të ndjekur në vijimësi ecurinë e zbatimit të tyre si dhe për të informuar Titullarin e Institucionit mbi rezultatet e auditimeve, mbi masat e marra nga subjekti i audituar si dhe shkallën e realizimit të tyre. -Njësia e Auditimit të Brendshëm, gjatë veprimtarisë audituese të marrë masa të kryejë auditime në drejtori që paraqesin risk të lartë dhe që nuk janë audituar në këtë Bashki, si edhe të plotësojë dosjen e auditimit sipas kërkesave të përcaktuara në Manualin e Auditimit, me qëllim kryerjen e misionit të auditimit që i shërben përmirësimit të vazhdueshëm të veprimtarisë së institucionit.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.9701/1, datë 24.11.2023 në lidhje me organizimin dhe funksionimin e strukturës së auditit të brendshëm, janë paraqitur objeksionet si mëposhtë:

Pretendimet e subjektit: -Pretendohet se “Memo e planifikimit” megjithëse nuk është hartuar përfshihet në përcaktimin e objektivave, në programin e angazhimit, testet e auditimit, etj.

-Karta e auditimit është hartuar në datën 11.11.2019 dhe më 02.10.2023, sipas Manualit të Auditimit.

-Letrat e punës janë në dosjet e secilit auditues.

Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve është kryer si me angazhim më vehte me nr.2066, datë 07.03.2023.

Qëndrimi i audituesit: Në lidhje me pretendimin se memo e planifikimit është përfshirë në dokumente të tjera të auditimit, sqarojmë se nuk qëndron pasi ky dokument është pjesë e dokumenteve të dosjes së auditimit para kryerjes së auditimit.

Sa i takon kartës së auditimit edhe ky pretendim nuk qëndron pasi grupi auditimit ka audituar vitin 2022 dhe jo 2019 dhe 2023.

Në lidhje me letrat e punës, sqarojmë se ky pretendim nuk qëndron pasi nga ana juaj nuk janë paraqitur dokumente justifikues.

Merret në konsideratë ndjekja dhe zbatimi i rekomandimeve.

2.2. Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit për vitin 2022.

2.1. Programimi i PBA dhe programimi i buxhetit;

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.

2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve;

2.5. Celja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënie me qira të asteve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të paarkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Për auditimin e pikës 2 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Dokumenti i hartimit të PBA 2022-2024 dhe miratimi i tij dhe gjithë korrespondenca me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

2. Dokumenti i programimit buxhetit vjetor për vitin 2022 të miratuara me VKB, fondet e transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MFE dhe korespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë këtyre viteve buxhetore.

3. Akt-rakordimet periodike me Degën e Thesarit Lushnje shpenzimet dhe të ardhurat.

4. Shkresat përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve si fatura të palikujduara dhe vendime gjyqësore.

6. Dokumentet e hartuara periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2022.

8. Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme ne programet “excel”si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditaret, shpenzimet të ardhurat etj.).

➤ Auditimi i procedurave të ndjekura për hartimin, e PBA dhe programimit të buxheteve vjetore

• Përgatitja e Programeve Buxhetore Afatmesme 2022-2024

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2022-2024 rezultoi se:

- Për realizimin e fazave të përgatitjes ka dalë Urdhri i Titullarit nr.196 datë 31.01.2022 mbi bazën e të cilit është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) i përbërë prej 11 punonjësish dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP). Programi Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 dhe buxheti i vitit 2022, si dhe pjesa e buxhetit për fondet e trashëguara janë miratuar në Këshillin Bashkiak.

- Është përgatitur dhe dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe i buxhetit vjetor, i cili është miratuar me VKB nr.101 datë 23.12.2021 dhe konfirmuar nga Prefektura me shkresën nr.prot 1549/1, datë 30.12.2021 në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 33/1.

- Janë miratuar në Këshillin Bashkiak tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA me VKB nr.15 datë 25.02.2021 dhe konfirmuar nga Prefektura me shkresën nr.prot. 351/1, datë 31.03.2021 në

përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 33/6.

- Kryetari i Bashkisë ka miratuar udhezimin e brendshëm nr.33, datë 01.04.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024” në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 35/1, i cili u është shpërndarë njesivë shpenzuese të Bashkisë.

- Programi Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 është miratuar me VKB nr.59, datë 27.07.2021, konfirmuar nga Prefektura me shkresën nr.prot 817/1, datë 02.08.2021. Nga auditimi i dokumentacionit të praktikës së përgatitjes dhe hartimit të PBA rezultoi se, në përgjithësi ishin respektuar kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 7, datë 26.02.2021 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024" dhe të Udhëzimit plotësues të MFE nr.20, datë 09.07.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024” .

- Në këtë programim është përfshirë Instrumenti të planifikimit financiar, shoqëruar me relacionin shpjegues, dhe përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzime të viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashigimi me destinacion (kontratat në vazhdim), angazhimet (detyrimet e prapambetura sipas llojit), tavanet, llogarija e konomike, vlerësimi i burimeve (të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme. (kostot direkte dhe të ardhurat e pritshme).

- Në dokumentin e PBA janë përcaktuar drejtimet e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, duke u bazuar në analizën e zërave të buxhetit në tre vitet e fundit dhe tendencat nga viti në vit për tre vitet që përfshin PBA-ja 2022-2023-2024.

- Janë përcaktuar fushat prioritare në shpenzimet për investime për funksionet më të rëndësishme si në infrastrukturë, në funksionin e arsimit, në bujqësi për të thithur projekte investimi me financim nga FZSHH. Këshilli Bashkiak ka miratuar draftin e parë të programit buxhetor afatmesëm, dhe ka marrë rekomandimet e Ministrisë së Financave;

- Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të “Buxhetimit me pjesëmarrje”, ku për të cilat ishin mbajtur relacionet dhe protokollat përkatëse.

- Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur të hartimit të PBA 2022-2024 dhe buxheteve vjetore, rezulton se janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga Njësitë Administrative dhe nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Lushnje në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse, si dhe kërkesa nga sektorë të ndryshëm, që mbulojnë këto programe.

- Në fazën përfundimtare të PBA, duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, si dhe duke respektuar tavanet e përcaktuara në fazat e para të përgatitjes, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor tre vjetor sipas programeve si për shpenzimet korrente, investime dhe të ardhurat. Kërkesat buxhetore për PBA janë dërguar në MFE me shkresën nr.prot.911/1, datë 31.05.2021.

➤ Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor 2022

Për vitin 2022, buxheti është miratuar me Vendim të KB nr. 101, datë .23.12.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 1549/1 date 30.12.2021, i paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2022	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
1	Plani i të ardhurave viti ushtrimor+Të trashëguara	659,504	
2	Të ardhura nga Transferata e Pakushtëzuar+Të trashëguara	417,311	
3	Të ardhura nga Transferata e Pakushtëzuar Sektoriale	268,378	
4	Paga (600)		546,039

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2022	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
5	Sigurime shoqërore (601)		94,798
6	Shpenzime operative (602)		467,969
7	Transferta (604 - 609) Fondi Rezervë		10,000
8	Inv. (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushez+tr.Specifike		226,387
Totali i buxhetit		1,345,193	1,345,193

Me Vendim të KB nr.27, datë 31.03.2022 është miratuar edhe pjesa e buxhetit për fondet e trashëguara nga viti paraardhës, i cili është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lushnje me shkresën nr.362/1, datë 06.04.2022, konkretisht këto fonde të trashëguar paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Të Ardhurat	Shpenzimet
1	Diferencë nga transfertat e pakushtëzuar	15,366	
2	Grant i pashperndare(detyrimet e prapambetura)	0	
3	Të ardhurta të trashëguara		
4	Të çelura të përdorura		
5	Grant i trashëguar		
6	Transferte e pakushtëzuar sektoriale e përdorur		
8	Paga (600)		0
9	Sigurime shoqërore (601)		0
10	Shpenzime operative (602)		15,366
11	Transferta (604 - 609) Fondi Rezervë		
12	Inv. (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushez+tr.Specifike		
13	Investime ne proces		
Totali i buxhetit		15,366	15,366

Sipas tabelës së mësipërme buxheti i vitit 2022 është miratuar i balancuar dhe pa deficiente, ku të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën 1,345,193 mijë lekë dhe me trashëgimet e fondeve në vlerën 15,366 mijë lekë.

➤ *Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive:*

PBA 2022-2024 me planin buxhetor 2022, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

	Emërtimi	Plan fillestar 2022	Sipas PBA 2022-2024	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga te ardhur e grant i pakush e spec)	640,837	634,956	-5,881
2	Shpenz (602.shp Op.+604 nd.ek.609) (nga ardhura e grant i pakushtez e specif)	477,696	470,072	-7,897
3	Investime Bashkia (nga te ardhura e grant i pakushtez)	226,387	226,387	0
4	Investime nga FZHS			
	Total I planit fillestar	1,345,193	1,331,415	-13,778
	Shtesat nga Pushteti Qendror			
5	Investime grant i kushtëzuar			
6	Shpenzime për pagat (600+601)			
7	Shpenzime (602.604.609)			
8	Grant i kushtëzuar (230-231) FZHR			
0	Gjithsej	1,345,193	1,331,415	-13,778

Referuar tabelës së mësipërme, nga krahasimi i planit fillestar të buxhetit 2022 me vitin e parë të planit buxhetor afatmesëm 2022-2024, rezulton se ka diferencë prej - 5,881 mijë lekë mbi tavanin e përcaktuar në PBA. Diferenca prej - 5,881 mijë lekë e rezultuar nga krahasimi i planit fillestar me vitin e parë PBA (2022) i përket shpenzimeve në llogarive të 600 dhe 601, që është vlera e shtuar nga akordimi i fondit të transfertes sektoriale (transferta specifike) në fillim të vitit për financimin e shtesës së pagave për funksionet e kaluara në varësi në Bashkisë. Këto fonde janë planifikuar në mënyrë të përafërt, pasi nuk dihej transfertat.

➤ *Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.*

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet, që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Lushnje dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve.

- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura nga subjekti Bashkia Lushnje dhe auditimi i tyre, konstatohet se buxheti vjetor gjatë vitit ka pësuar ndryshime, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjerë, sipas nevojave të Bashkisë Lushnje.

Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit. Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB. Ndryshimet buxhetore gjatë vitit ushtrimor 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

në lekë

Periudha buxhetore	Buxheti Fillestar		Ndryshime gjate viteve		Pakësuar/shtuar artikulli (me emër)			
	Nr./datë	Vlera	Nr./datë	Vlera	Shtesa art.	shuma	Paksime art.	Shuma
Viti 2022	Nr.101 dt 23.12.2021	1,345,193	VKB 44 26/05/2022	24,000	231, investime	24000	231, investime	24,000
	Trashëguara	15,366	VKB 63 28/7/2022	14,948	231, investime	14948	600 paga	11,000
		3,217	VKM.158, DT.13.02.2022,VKB 82 DT 28/09/22 (shtesa pagash)	3,217	600+601 pg sig	3217	231, investime	3,948
			VKB 84 DT 28/09/2022	7,500	231, investime	3500	602 opera	3,500
					602 operative	4000	231 inv	4,000
		960	Shkres MF nr.19239/1 dt 31.10.2022 VKB nr 96 dt 8.11.2022 per TVSh	960	231, investime	960		
		22,695	Akt-normativ 17 -01.12.2022	22,695	(602)fat palikujd	22695		
		3400	Nr.150 dt.09.01.2023	3,400	606 nd.financiare	3400	602 shpenz op	3,400
			Nr.83 dt.05.01.2023	5,010	606 nd.financiare	5010	600 paga	5,010
			VKB Gjëlberimin	3,188	600 pg+601	3188	602 shpenz op	3,188
	Buxhet me ndryshim	1,390,831						

Nga sa më sipër konstatojmë se, për vitin 2022 kanë ndodhur 2 ndryshime me VKB dhe 3 ndryshime me akte normative dhe VKM në vlerën 30,842,760 lekë.

➤ ***Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.***

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Lushnje, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.

Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Lushnje, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv 2022, të miratuar me Vendim të KB, ose të diktuar nga transfertat e deleguara nga pushteti qendror, si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limit nga të ardhurat e realizuara nga

auditimi i shkresave, evidencave të celjeve, shpërndarjes së fondeve gjatë vitit, të akt-rakordimeve periodike me degën e Thesarit Lushnje u konstatua se, si në planifikim dhe në realizim të buxhetit është respektuar disiplina buxhetore.

Planifikimi dhe realizimi i fondeve buxhetore të vitit 2022 sipas zërave të shpenzimeve dhe sipas njësive shpenzuese paraqitet në tabelën e mëposhtme:

në 000/lekë

Emertimi	600.0		601.0		602.0		603.604.		606.0		230-231		Totali	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Bshkia Lushnje	196,823	188,716	34,601	30,593	188,201	96,966	12,360	3,600	659,537	655,671	162,890	45,241	1,254,412	1,020,787
Nd Pasurise Publike	83,877	80,031	14,855	13,326	218,851	182,964	0	0	3,656	3,620	74,715	39,410	395,954	319,351
Qendra e Arsimit	239,346	228,440	34,817	34,788	33,350	28,186	0	0	10,958	10,958	10,000	912	328,471	303,284
Q Kulture & K futbollit	29,154	27,985	4,668	4,667	15,033	13,943	40,000	40,000	960	960	1000	961	90,815	88,516
Shuma	549,200	525,172	88,942	83,374	455,435	322,060	52,360	43,600	675,111	671,208	248,605	86,524	2,069,652	1,731,939

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit, referuar akt-rakordimet me thesarin për Bashkinë dhe ndermarjet paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Nr.	Emërtimi	2022		
		Plan	Fakt	Real.%
1	Paga 600	549,199,500	525,172,474	96
2	Sigurime shoqërore 601	88,941,770	83,374,026	94
3	Shpenz.operative 602+ F.Rezerve	455,435,480	322,059,729	71
4	Shp. transfere tek individ 604 (bursa e ndihm ek.familje)	4,760,000	400,000	8
	Subvencion per sportin dhe transport publik (603)	47,600,000	43,199,989	91
5	Shpenzime për ndihm ek. dhe invaliditetin 606	675,110,930	671,208,480	99
6	Shpenzime për investime 230-231	248,604,555	86,523,913	35
7	Shp. nga ardhura jashte limit (donacion investim+ Taks kombetare)	-	7,972,768	
	TOTALI	2,069,652,235	1,739,911,380	85
8	Mjete ne ruajtje (466) ngurtësimi I 5% garanci punim	-	11,964,018	
	Totali		1,751,875,398	

Referuar të dhënave të pasqyrave të mësipërme, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit për aparatit e Bashkisë paraqitet:

- **Për vitin 2022** janë realizuar 1,739,911 mijë lekë nga 2,069,652 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 85%.

Kjo tregon se treguesit e buxhetit planifikohen, sipas nevojave që ka Bashkia Lushnje. Në këtë masë realizim ka ndikuar realizimi në masë të konsiderueshme në zërat e buxhetit:

- Shpenzimet operative llog.602 janë realizuar në masën 71%
- Shpenzimet për transferta tek individet llog.604 janë realizuar në masën 8%
- Shpenzimet për investime llog.231 janë realizuar në masën 35%. Realizimin në këtë masë ka ardhur si rezultat i kryerjes së procedurave të porkurimit me vonesë dhe si rrjedhojë dhe lidhja e kontratave është bërë me vonesë, duke mos u realizuar si investimet dhe financimi i tyre brenda vitit buxhetor.

- Miratimi i realizimit faktik të buxhetit

Në fund të periudhës ushtrimore nga Bashkia Lushnje është miratuar buxheti vjetor, ku për vitin 2022 është miratuar me vendim të KB nr.101, datë.23.12.2021.

- Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe i kontigjencës

Fondi rezervë për vitin 2022 është në total në shumën 10,000 mijë lekë, i cili është miratuar që nga buxheti fillestar i vitit buxhetor me VKB nr.101, datë.23.12.2021 dhe konfirmuar nga Prefekti I Qarkut Feier por nuk është përdorur e gjithë shuma.

Fondit Rezervë është përdorur në vlerën 1,240,000 lekë konkretisht:

- Me V.K.B nr.33, datë 31.03.2022 për aktivitetin shfaqja e filmit “Bolero në vilen e pleqve “ në vlerën 400,000 lekë.

- Me V.K.B nr.32, datë 31.03.2022 për aktivitetin “Integrimi i pakices kombëtare Rome dhe ruajtja e identitetit kulturor “ në vlerën 150,000 lekë.
- Me V.K.B nr.40, datë 26.04.2022 për shpërblimin e nxënësit J. T. në vlerën 50,000 lekë.
- Me V.K.B nr.90, datë 25.10.2022 për shpërblimin e nxenesve ekselente, lista emerore me 8-nxënës për rezultate të larta (30,000 lekë secili) në vlerën 240,000 lekë
- Me V.K.B nr.91, datë 25.10.2022 për aktivitetin shfaqja e komedisë “Çehovi i jep lamtumirën Tolstoit “ në vlerën 400,000 lekë.

➤ Raportet e Monitorimit.

Për vitin 2022, janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre, në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 6. Për vitin 2022 është dërguar “Raport monitorimi Buxhetit Janar-Prill” me shkresën nr. prot.4799, date.30.05.2022, “Raport monitorimi Buxhetit Janar-Gusht” me shkresën nr.8607 prot, date.30.09.2022, “Raport monitorimi Buxhetit Janar-Dhjetor” me shkresën nr.1749 prot, date 27.02.2023.

Raportet e monitorimit janë hartuar në përputhje me kërkesat e Shtojcës 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe Shtojcës 5 "Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore". Raportet e monitorimit janë të plota me të gjitha anekset sipas kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 48 dhe Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore", pikat 10, 12, 28, 29, 48.

➤ Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli realizimit të të ardhurave

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor) gjë e cila ndodh, por që nuk mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikojë procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës, kjo për të shmangur në maksimum rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore.

➤ Evidentimi, raportimi, ndjekja dhe likuidimi i faturave të palikujduara

Me fondet e vitit buxhetor 2022, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikujduara të viteve të mëparshme, duke bërë pagesat pjesë-pjesë të detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara Bashkia, sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve. Nga auditimi i dokumentacionit të miratimit të buxhetit vjetor 2022 rezultoi se, është bërë planifikimi i fondeve të veçuara për financimin e detyrimeve të prapambetura në përputhje me kërkesat Udhëzimit të MFE nr.09, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të e buxhetit”. Situata e planifikimit të detyrimeve të papaguara nga viti paraardhës në buxhet respektivisht paraqitet si vijon:

Periudha	Detyrimet në fund të periudhës 2021	Vlera e detyrimeve të planifikuara	VKB nr. /datë	Llog 602	Llog. 230-231
Viti 2022	98,540,609	62,721,827	VKB nr.101,datë.23.12.21	48,957,387	13,764,440

Burimi: Nga të dhënat e subjekti sipas pasqyrave.

Diferenca ndërmjet detyrimeve në fund të periudhës dhe detyrimeve të planifikuara në shumën prej 35,818,782 lekë i përket një pjesë të faturave të mbartura të pa likujduara për mungesë dokumentacioni dhe një pjesë e vlerës i përket faturave të parashikuara për likuidim në vitin në vaxhdim.

Detyrimet e palikujduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës “Detyrimet e prapambetura”, sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore 2021-2022 të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

Detyrimet e prapambetura deri në fund të periudhës 31.12.2022:

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit I mbartur 31.12.2021 (lekë)	Detyrimi I krijuar në periudhën 01/01/2022 - 31.12.2022 (lekë)	Total detyrime (lekë)	Shlyerja e detyrimeve 2022 (lekë)	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2022 (lekë)
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
Sherbime	5,636,854	6,370,669.55	12,007,521	5,027,519.55	6,980,001
Mirembajtje	33,601,900	42,338,160	75,940,060	67,727,103	8,212,957
Investime	22,839,955	13,764,440	36,604,395	23,214,440	13,389,955
Mallra	419,068	9,015,120	9,434,188	2,288,648	7,145,540
Te tjera	35,952,506		35,952,506	35,952,505.5	
Shpronësime	90,329		90,329		90,329
Totali	98,540,609	71,488,390	170,028,998	134,210,216	35,818,782

Burimi: Nga të dhënat e subjekti sipas pasqyrave

Referuar shkresës nr.279/1 prot, datë 26.01.2022 “Mbi raportimin e detyrimeve të prapambetura” të Bashkisë Lushnje dërguar në MFE dhe publikimit në faqen e MFE detyrimet paraqiten në fund të vitit 2021 në shumën 98,540,609 lekë. Referuar shkresës nr.prot. 1749 datë 27.02.2023 “Mbi publikimin e detyrimeve të prapambetura” në fund të vitit 2022 detyrimet paraqiten në shumën 35,818,782 lekë. Gjatë vitit 2022 janë krijuar 71,488,390 lekë dhe janë likujduar në vlerën 134,210,216 lekë. Detyrimet e prapambetura të detajuara paraqiten në Aneks:

Konkluzion: Nga të dhënat e pasqyrës konstatohet se, në fund të periudhës ushtrimore 2022 Bashkia Lushnje ka gjendje të detyrimeve të prapambetura në shumën 35,818,782 lekë, ku vlera prej 14,826,175 lekë i përket Aparatit të Bashkisë dhe vlera prej 20,279,807 lekë i përket Ndermarrjes së Pasurise Publike. Pjesa më e madhe e detyrimeve të Aparatit të Bashkisë ka rezultuar për shkak të mungesës së dokumentacionit bazë ose justifikues. Këto detyrime janë krijuar në vite të hershme nga veprimtaria ekonomike e ish-Komunave dhe kryesisht janë detyrime për projekt-studime, mbikqyrje e kolaudime si dhe garanci punimesh të pakthyera për investime të kryera. Ndërsa detyrimet e Ndermarrjes së Pasurive Publike nga 83,714,434 lekë gjendje, që kanë qenë në fund të vitit 2021, pas likujdimeve të kryera gjatë vitit 2022 vlera e detyrimeve ka mbetur 20,279,807 lekë, gjë që ka ndikuar në uljen e detyrimeve në masë të konsiderueshme.

Detyrimet e prapambetura për vitin 2022 të paraqitura në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.1749 prot datë 27.02.2023 jepen në tabelën si më poshtë:

N.R	Emërtim	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër	0		
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve			
II	Detyrime (a+b+c)	35,818,782		0.35%

a	Shpenzime korrente	22,428,827		
a,1	Mallra dhe shërbime	22,428,827		
a,2	Paga dhe sigurime			
a,3	Të tjera			
b	Shenzime kapitale	13,389,955		
b,1	Insitucione buxhetore	13,389,955		
b,2	Subjekte private			
c	Vendime gjyqësore	0		
c,1	Marrëdhënie pune			
c,2	Mallra dhe shërbime			
c,3	Investime			
c,4	Të tjera			
III	Totali (I+II)	35,818,782	1,390,829,000	2.58%

Analiza e vlerës së e detyrimeve të krijuara gjatë vitit 2022 dhe raportuar në MFE paraqitet më poshtë:

a. Me financim nga Bashkia Lushnje

- Fatura të pa likujduara, për mungesë dokumentacioni, nga ish komunat 35,818,782 lekë

b. Me financim nga Ministrinë e linjës

-Nuk ka asnjë faturë të raportur nga ministrinë e linjës

Krijimi dhe akumulimi i detyrimeve të papaguara në fund të vitit ushtrimor është në papajtueshmëri me Udhëzimin e MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91.

Vështirësia Financiare

Nga auditimi është konstatuar se detyrimet e papaguara (të akumuluar) në fund të vitit 2022 paraqiten në vlerën 35,818,782 lekë. Pësha specifike e stokut të detyrimeve të konstatuara të Bashkisë ndaj palëve të treta është 2.58 % kundrejt fondeve të miratuara. Kjo situatë tregon se, Bashkia Lushnje nuk mund të konsiderohet në vështirësi financiare në fund të vitit ushtrimor 2022, pasi raporti i detyrimeve ndaj fondeve vjetore të miratuara për shpenzime është nën nivelin prej 25 %, sipas nenit 56 “Vështirësia financiare” të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

➤ Çelja dhe ekzekutimi i fondeve për investime, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Me miratimin e buxhetit vjetor janë miratuar dhe projektet për investime. Investimet kryesisht janë me burim financimi nga transfertat dhe pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta të Bashkisë Lushnje. - Për vitin 2022 janë planifikuar fonde për investime në shumën 236,847 mijë lekë me burim financimi nga grant i pakushtëzuar, transfertat sektoriale dhe të ardhurat e veta, të cilat janë realizuar në vlerën 94,489 mijë lekë, ose në masën 39.9%. Gjatë vitit ka pasur ndryshime si shtesa dhe pakësime, të cilat janë shqyrtuar nga GMS, i cili ka vendosur miratimin e tyre dhe më pas janë miratuar me VKB për secilin rast. Këto projekte me të dhënat analitike për datën dhe vlerën e kontratës, si dhe likuidimet e tyre paraqiten në tabelën e mëposhtme:

në lekë

Burimi financimit	Objekti i kontratës	Fond Planifikim/2022	Kontrata me subjektin			Subjekti kontraktua	Paguat Viti 2022	Mbetja 31.12.2022	Komente
			Datë lidhjes se kontratës	Afati	Vlerë kontrate me TVSH				
Te ardh	Rivitalizim i Rrugëve të Fshatit Krutje	13,764,440	08.01.2021	45	31,929,336	B. Shpk	13,764,440	-	Perfunduar
Grand	Sist asf i seg rrugor "Taulla Sinani-Esma Dervishi"	10,000,000	12.09.2022	75	18,491,131	R.2008	-	10,000,000	Lidhur kont
Grand	Sist asfa rrug Shpresa+rrug Repartit Zhame sektor	7,000,000	07.07.2022	58	12,852,592	E. shpk	6,999,996	4	Lidhur kont
Grand	Sist asfa i rruges "Jakov Xoxa" e vazhdi pas unazes	8,000,000	31.08.2022	56	12,000,025	Sh. 07	7,999,984	16	Lidhur kon
Grand	Nderhyrj infrast rrug "V Gogu" e "Hysen Dervishi"	11,000,000	11.11.2022	42	11,425,000	K M K	-	11,000,000	Lidh kontr
Grand	Rk rrug Cekeve e Pajolli ne fshatin Kashtebardhe	12,892,000	13.12.2022	70	12,892,450	B. Shpk	-	12,892,000	Lidh kontr
Grand	Nderh ne infratr e rrug "Unaze e ish depos duhan"	9,000,000	12.09.2022	175	25,301,537	Z.	8,477,515	522,485	Lidh kontr
Grand	Ndertim i tregut ne lagjen "Xhvedet Nepravishta"	12,000,000	08.07.2022	113	28,371,643	N.Shpk	-	12,000,000	Lidh kontr
Grand	Rehab miremb infras Kujd Shend Paresor Toshkez	3,029,321	16.12.2021	90	3,029,000	N.	3,029,000	321	Perf
Grand	Mbikq e kolaud "Rehab dhe mirembajtje e infrastres Kujdesit Shendesor Paresor Toshkez"	137,347	25.11.2021	90	119,312	E./M Shpk	119,312	18,035	Perf
Grand	Blerje makine teknologjike	4,000,000	-	-	-	-	-	4,000,000	pa realizua
Grand	Blerje Konteniere	3,600,000	17.02.2022	-	3,466,836	Z. Shpk	3,466,836	133,164	
Grand +Te ardh	Rikon i Kompleksit Sportiv "Roza Haxhiu Lushnje	24,000,000	xxx	xxx	-	-	-	24,000,000	
Grand+ministri	Rehabilitim I Palestres Shkolla "Foto Puka"	4,477,793	28.12.2022	62	26,065,008	Z.	-	4,477,793	
Grand+ministri	Rik shkoll 9-vjec "Skende Liboh+shtes anes Lushn"	10,470,168	29.12.2022	144	55,141,751	Z.	-	10,470,168	
Gr+te ar+06	Investime Ndermarria Pasurise Publike	74,714,000	xxx	-	-	-	44,720,000	29,994,000	Investi NPP
Grand	Rikonstruksione ne Kopeshte,Qendra Arsimit	9,000,000	-	-	-	-	-	9,000,000	Invs nga QA
gr+te ardh	Invest.tjera (Sup.projek dhe kolaud &nga vitet blerje komp te tj)Bashki +Njesi varese	19,763,000	xxx	-	-	-	5,912,000	13,851,000	Kola+suprv tj
			236,848,069					94,489,083	142,358,986
Shuma		236,848,069			241,085,620		94,489		
AKMC, M. Mbroj	"Rehabi i kanalit ujera larta lagj Kongr i Lushnjes"	11,719,000	07.12.2023	107	11,719,878		-	-	
	Shuma ne situacion e dhjetorit	248,567,069			252,805,498		94,489,083	142,358,986	

- Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e investimeve në nivel projekti paraqiten si më poshtë:

Nga auditimi i procedurave të ndjekura për planifikimin, realizimin dhe financimin e investimeve me fondet e veta rezulton se Bashkia Lushnje ka programuar 17 projekte investimesh, ku në 2 raste janë investime në proces nga viti 2021 dhe në 15 raste janë investime të reja. Janë realizuar procedurat e prokurimit dhe finalizuar me kontratë 15 projekte me vlerë 206,007,972 lekë, nga të cilat nuk janë realizuar plotësisht punimet, pasi janë lidhur me vonesë gjatë 6-mujorit dytë të vitit ushtrimor 2022, si rezultat i kryerjes së procedurave të prokurimit me vonesë. Gjithashtu dhe financimi i tyre është kryer pjesërisht, duke realizuar fondet për investime në masën 39.9%. Ndërsa për 1 projekt me financim nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile me objekt: "Për rehabilitimin e kanalit ujërave të larta lagja Kongresi i Lushnjes" për parandalimin e përmbytjeve, nuk janë planifikuar fonde për arsye se fondet janë alokuar nga Ministria e Mbrojtjes gjatë vitit 2022. Për këtë investim është lidhur kontrata me vonesë, pasi ka dështuar dhe është anuluar procedura e prokurimit, duke tejkaluar afatet e realizimit të saj. Për këtë arsye për këtë projekt dhe realizimi i fondeve është 0 lekë.

- Nga auditimi i procedurave të ndjekura për realizimin dhe financimin e 17 projekteve të investimeve Bashkia Lushnje me financim nga fondet e veta, rezultoi se janë ndjekur hapat: Për çdo procedure prokurimi, urdhri është regjistruar në kohë dhe ka vulën/ datën e depozitimit të tyre në Degën e Thesarit Lushnje .Kontratat janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në SIFQ nga Dega e Thesarit Lushnje dhe të shtrira në kohë sipas financimit brenda vitit buxhetor koherent.Kontrata është regjistruar e plotë me qëllim pagesën e saj në afate mujore, pra nuk janë regjistruar kontrata të copëtuara, ndërsa pagesa është kryer sipas limitit mujor.Për çdo rast të depozitimit të kontratave në Degën e Thesarit është hartuar shkresë përcjellëse, ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit .

➤ Burimet e financimit të buxhetit vjetor

Realizimi i buxhetit për vitin 2022 sipas burimit të financimit paraqitet në tabelën e mëposhtme.

000/lekë

Nr	Emertimi	Viti 022		Real.%
		Plan	Fakt	
1	Paga 600	549,199,500	525,172,474	
	grant I kushtezuar	15,173,000	14,797,934	97.5
	grant I pakushtezuar + tarsnsferta sektoriale	383,212,340	375,801,999	98.1
	te ardhura	150,814,160	134,572,541	89.2
2	Sigurime shoqërore 601	88,941,770	83,374,026	93.7
	grant I kushtezuar	1,700,000	1,643,543	96.7
	grant I pakushtezuar + tarsnsferta specifike	79,235,220	76,519,909	96.6
	te ardhura	8,006,550	5,210,574	65.1
3	Shpenz operative 602+ F.rezerve	455,435,480	322,059,729	70.7
	grant I kushtezuar	835,000	674,000	80.7
	grant I pakushtezuar + tarsnsferta specifike	117,812,820	85,374,333	72.5
	te ardhura	336,787,660	236,011,396	70.1
4	Shpenzime 604 +603	52,360,000	43,599,989	83.3
	grant I kushtezuar	0	-	0.0
	grant I pakushtezuar + tarsnsferta specifike	10,760,000	2,000,000	18.6
	te ardhura	41,600,000	41,599,989	100.0
5	Shpz 606	675,110,930	671,208,480	99.4
	grant I kushtezuar	644,847,370	643,707,540	99.8
	grant I pakushtezuar + tarsnsferta specifike	23,361,260	20,714,040	88.7
	te ardhura	6,902,300	6,786,900	98.3
6	Investime 230-231	248,604,555	86,523,913	34.8
	grant I kushtezuar	11,757,550	-	0.0
	grant I pakushtezuar + tarsnsferta specifike	149,160,570	63,770,830	42.8
	te ardhura	87,686,435	22,753,083	25.9
	Totali Bashkia Lushnje	2,069,652,235	1,731,938,612	83.7
	Shpenz nga te ardhura jashte limitit		7,972,768	
	Shuma totale		1,739,911,380	
	Mjete ne ruajtje		11,964,018	
	Shuma totale		1,751,875,398	

Referuar tabelës së mësipërme rezulton se nga të ardhurat e veta kjo bashki përballon në fakt:

- Shpenzimet në artikullin 600 “paga e shpërblime” për vitin 2022 në masën 7.3%
- Shpenzimet në artikullin 601 “kontributin për sigurime shoqërore e shëndetësore” për vitin 2022 në masën 0.4%.
- Shpenzimet në artikullin 602 “shpenzime operative për mallra e shërbime” për vitin 2022 në masën 16.3%.
- Shpenzimet në artikullin 230-231 “investime” për vitin 2022 në masën 4.24 %.

Duke u nisur nga burimi i financimit për vitin 2022 shpenzimet buxhetore janë përballuar nga të ardhurat e veta në shumën 454,907 mijë lekë ose në masën 26.1 %, nga transfertat e pakushtezuar dhe transfertat specifike në shumën 624,181 mijë lekë ose në masën 35.9%, nga transfertat e kushtezuar në shumën 660,823 mijë lekë ose në masën 38% .

Titulli i Gjetjes	Mbi programimin, realizimin dhe zbatimin e buxhetit për periudhën objekt auditimi.
Situata	Nga auditimi i programimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2022 u konstatua se: a. Realizimi i buxhetit për vitin 2022 është 1,739,911 mijë lekë nga 2,069,652 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 85%. Në mosrealizim kanë ndikuar realizimi në nivele jo të kënaqshme të zërit 602 “Shpenzime operative” në masën 71%, i cili tregon për planifikim me rezervë të tij. Me realizim në nivel të ulët paraqitet dhe zëri 230-231 “Shpenzime për investime” në masën 35%, i cili ka ardhur nga morealizimi I 1 projekti të

	<p>financuar nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe nga realizimi me vonesë I procedurave të prokurimit të 15 projekteve të reja të financuar nga Bashkia dhe si rrjedhojë dhe lidhjes me vonesë e kontratave për to, duke mos i financuar brenda vitit buxhetor.</p> <p>b. Detyrimet e papaguara në fund të vitit 2022 paraqiten në shumën 35,818,782 lekë, ku vlera prej 14,826,175 lekë i përket Aparatit të Bashkisë dhe vlera prej 20,279,807 lekë i përket Ndermarrjes së Pasurise Publike. Detyrimet e papaguara janë në masën 2.58 % të shpenzimeve të planifikuara, të cilat janë ulur krahasuar me fundvitin 2021, që ishin në shumë të konsiderueshme prej 98,540,609 lekë. Detyrimet e papaguara rakordojnë me gjendjet e llog. të klasë 4 të bilancit të vitit 2022, si dhe me raportimin në MFE të vitit 2022.</p> <p>c. Gjithashtu konstatohet se financimi i buxhetit vjetor 2022 është bërë në masën më të madhe prej 73.9% nga Buxheti i Shtetit (transferta e pakushtëzuar dhe transferta e kushtëzuar e transferta specifike) dhe 26.1% nga të ardhurat e veta, pasi të ardhurat e mbledhura nga taksat dhe tarifatat vendore janë nivel të ulët në krahasim me të ardhurat që siguron njësi vendore nga burimet të tjera.</p>
Kriteri	Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 43 paragrafi 4,47,48,52; ligji nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40/h,42; Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Kreu “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 82-91; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 12 pika 3.
Ndikimi/Efekti	Realizim jo të kënaqshëm të shpenzimeve në disa zëra buxheti, realizim jo shumë të mirë të të ardhurave si dhe raportim jo i plotë e detyrimeve të papaguara.
Shkaku	Mos programimi i buxhetit mbi bazë prioritetesh dhe nevojash dhe moslikujdimi detyrimeve sjell rritjen e borxhit që ka Bashkia ndaj të tretëve.
Rëndësia	I mesëm
Rekomandim	Strukturat drejtuese të Bashkisë Lushnje, nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe në bashkëpunim me Menaxhimerët e Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme në mënyrë që, programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent të jenë sa më të argumentuara, si dhe të kujdesen për realizimin e projekteve të investimeve të planifikuara, sipas prioriteteve strategjike, duke eliminuar vonesat në procedurat e prokurimit, në lidhjen e kontratave, në rritjen e bashkëpunimit me operatorët ekonomik për përfundimin dhe dorëzimin e punimeve në afat, sigurimin e mbërritjes së faturave në institucion dhe likujdimin e tyre, duke eliminuar limitimin e likujdimeve për anagazhime të marra. Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta. Për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar Drejtoria

	e Financës dhe Buxhetit të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material të plotë për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të pa likuiduara të prapambetura, të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave.
--	---

2.6 Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Evidentimi i detyrimeve tatimore të paarkëtuara progressive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Për auditimin e pikës 2.6 u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Vendimet e Këshillit Bashkiak Lushnje për miratimin e paketave fiskale të vitit 2022. Pasqyrat financiare në lidhje me arkëtimet, kontabilizimin dhe pasqyrimin e të ardhurave nga subjektet, familjarët, taksat e tokës, etj.
- Dokumentacioni i Drejtorisë të Ardhurave Vendore në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave të tatim-paguesve, database në Exel i mbajtjes së sistemit të taksave, dosje fizike të mbajtura për subjektet tatimpagues.
- Relacione periodike të punës së kryer për periudhën objekt auditimi nga specialistët e pranifaturimit dhe specialistët e kontrollit në terren
- Relacione periodike të punës së kryer për periudhën objekt auditimi nga inspektorët e borxhit shoqëruar me evidenca dhe korrespondencat zyrtare për ndjekjen e debitorëve.
- Kontrata, aktmarrëveshje, procesverbale dhe relacione në lidhje me të ardhurat. Evidencat e debitorëve për bizneset dhe familjarët, si për taksat ashtu edhe për tarifatat vendore, të mbajtura nga Drejtoria e Të Ardhurave Vendore.
- Miratimet e buxheteve në lidhje me planifikimin e të ardhurave për vitin 2022.
- Akt-rakordimet me degën e Thesarit dhe raportimet mbi realizimi faktik i të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara.
- Dokumentacioni në lidhje me agjentët tatimorë, rakordimet me ta, me thesarin, etj.
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Të Ardhurave Vendore.
- Korrespondenca me Institucione të ndryshme për të ardhurat që i takojnë Bashkisë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, konstatohet se rregullshmëria e veprimeve të kryera nga Drejtoria e të ardhurave vendore, për vjeljen e taksave, tatimeve dhe të ardhurave të tjera, paraqitet si më poshtë:

➤ Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore

Për vitin 2022 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr.229 datë 07.12.2021 “Për miratimin e strukturës organizative të bashkisë për vitin 2022”, ku përfshihet edhe Drejtoria e Të Ardhurave Vendore, si pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar dhe Ardhurave, e cila përbëhet nga 17 punonjës, 1 drejtor, 3 përgjegjësa dhe nga 13 specialistë.

• Të dhëna mbi numrin e subjekteve, regjistrimet dhe mbylljet

Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Bashkia Lushnje në lidhje me numrin e subjekteve aktiv, regjistrimeve të reja dhe atyre që kanë kërkuar mbyllje aktiviteti, rezulton se:

Për periudhën objekt auditimi, gjendja dhe ndryshimet mbi statusin e subjekteve paraqitet: **në vitin 2022** janë **3513** subjekte biznesi, nga të cilat 2294 subjekte të biznesit të vogël dhe 967 subjekte të biznesit të madh dhe 252 janë ambulantë. Bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Lushnje në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Njësia	Gjendja e Subjekteve AKTIVE 01.01.2022		Regjistrime te reja gjate vitit QKB/DPT 2022		Pezullim Aktiviteti gjate vitit QKB 2022		Ç' regjistrime gjate vitit QKB/DPT 2022		Gjendja e Subjekteve AKTIVE 31.12.2022	
RAJONI 1	222	90	51	2	16	2	6	0	251	90
RAJONI 2	392	196	86	7	10	7	14	3	454	193
RAJONI 3	357	132	51	6	32	3	15	5	361	130
RAJONI 4	246	160	38	7	8	4	7	6	269	157
RAJONI 5	84	94	19	8	6	4	4	2	93	96
HYSGJOKAJ	32	5	4	0	1	1	1	0	34	4
BALLAGAT	17	3	1	0	0	1	2	0	16	2
GOLEM	74	50	13	1	12	0	0	0	75	51
KARBUNARE	46	11	8	1	2	0	0	1	52	11
BUBULLIME	86	24	13	0	4	0	7	0	88	24
ALLKAJ	53	11	7	0	3	0	4	0	53	11
DUSHK	143	68	9	1	6	2	6	2	140	65
KRUTJE	160	44	14	0	9	2	9	0	156	42
FIERSHEGAN	122	27	12	2	4	1	3	0	127	28
KOLONJE	125	63	16	1	8	0	8	1	125	63
TOTALI	2159	978	342	36	121	27	86	20	2294	967
AMBULANTË	261		0		3		6		252	

➤ Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve

Për vitin 2022, paketa e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Lushnje është miratuar me VKB nr. 100, datë 23.12.2021 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Lushnjes dhe penalitetet për kundravajtjet administrative për vitin 2022”. Referuar planit vjetor të miratuar dhe bazuar në akt-rakordimet me Degën e Thesarit Lushnje, parashikimi dhe realizimi i të ardhurave vendore për Bashkinë Lushnje për 2022 paraqitet i detajuar në Aneks:

Për vitin 2022 realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Lushnje paraqitet në masën 71.59 %, nga 610,900 mijë lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 437,372 mijë lekë. Në këtë realizim kanë ndikuar taksa e tokës bujqësore, taksa e ndërtesës, taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, pagesat e debive të viteve të kaluara etj. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasuritë e paluajtshme , të cilat kanë një nivel arkëtimi shumë të ulët.

Referuar tabelës së mësipërme konstatohet se për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet shumë mbi planin, kështu :

a. Taksat dhe tarifat e paraqitura me realizim mbi planin si:

- **Taksa mbi truallin** është realizuar 19,774 mijë lekë nga 18,000 mijë lekë e planifikuar ose në masën 109.86%,

- **Taksa mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier** është realizuar 356 mijë lekë nga 180 mijë lekë e planifikuar ose në masën 197.62%,

- **Tarifa për leje transporti** është realizuar 6,747 mijë lekë nga 5,030 mijë lekë e planifikuar ose në masën 134.13%,

- **Taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura** është realizuar 44,335 mijë lekë nga 36,000 mijë lekë e planifikuar ose në masën 123.15%,

- **Tatimi mbi të ardhurat personale** është realizuar 26,476 mijë lekë nga 12,000 mijë lekë e planifikuar ose në masën 220.64%,

b. Taksat dhe tarifat e paraqitura me realizim të planit si:

- **Taksa mbi ndërtesën** është realizuar 68,589 mijë lekë nga 97,000 mijë lekë e planifikuar ose në masën 70.17 %,

- **Taksa vendore mbi biznesin e vogël** është realizuar 30 mijë lekë nga 400 mijë lekë e planifikuar ose në masën 8%,

- **Taksa mbi token bujqësore** është realizuar 45,904 mijë lekë nga 100,000 mijë lekë e planifikuar ose në masën 45.9%,
- **Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja** është realizuar 46,754 mijë lekë nga 70,300 mijë lekë e planifikuar ose në masën 66.51%,
- **Taksa vendore e tabelës** është realizuar 9,536 mijë lekë nga 1,000 mijë lekë e planifikuar ose në masën 95.36%,
- **Taksë mbi veprimtarinë e Bizn. Vogël (Tatim i thjeshtuar mbi fitimin)** nuk është planifikuar por është realizuar 862 mijë lekë,
- **Taksa e kalimit të drejt së pronësisë të pas. paluajt** është realizuar 6,840 mijë lekë nga 10,000 mijë lekë e planifikuar ose në masën 68.4%,
- **Renta Minerare** është realizuar 6,886 mijë lekë nga 6,900 mijë lekë e planifikuar ose në masën 99.8%,
- **Tarifë (për qëllime biznesi) për zënie dhe përdorimin e hapësirave publike** është realizuar 1,336 mijë lekë nga 1,500 mijë lekë e planifikuar ose në masën 89.09%,
- **Tarifë për parkim (për zënie dhe përdorimin e hapësirave publike për parkim)** është realizuar 6,230 mijë lekë nga 8,000 mijë lekë e planifikuar ose në masën 77.87%,
- **Tarifa pastrimi, higjens dhe ndriçimi** është realizuar 91,015 mijë lekë nga 110,000 mijë lekë e planifikuar ose në masën 82.74%,
- **Tarifë për lëshime vërtetime** është realizuar 634 mijë lekë nga 4,000 mijë lekë e planifikuar ose në masën 15.86%,

Referuar tabelës së mësipërme konstatohet se, për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet më shumë mbi planin, fakt që tregon se planifikimi i të ardhurave në disa zëra të ardhurash nuk është mbi baza reale si dhe në disa zëra të tjerë të ardhurash nuk është bërë punë e mjaftueshme për arkëtimin e tyre, gjë që ka sjellë ndikim negativ në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, duke mospasqyruar saktë burimin e të ardhurave.

➤ Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor;

- Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa me datë 31.12.2022 .

Në realizimin në nivel të ulët të të ardhurave kanë ndikuar **niveli i lartë i debitorëve**. Në bazë të përpunimit të të dhënave të regjistrimit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Lushnje rezultoi se, ka nivel të lartë **debitorësh** në numër dhe në vlerë, duke përfshirë biznesin, individët, familjarët, (për taksën e ndërtesës, tabelës, trualli, reklame, zënie hapësire publike, tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarifa e qirasë për objekte, toka, pyje, etj), i cili nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, kështu në fund të **vitit 2021** vlera debitorëve është **1,487,784,334 lekë** dhe në fund të **vitit 2022** vlera debitorëve është **1,643,276,112 lekë**. Informacion më i detajuar lidhur me debitorët progresiv paraqitet në Aneks.

Nr	LLOJII DEBITOREVE	Periodha (12 VJECARE) 31.12.2011 deri me 31.12.2022						
		Lloji i Detyrimeve		Shuma e Detyrimeve Progresiv 2021 Sipas KLSH	Sistemime shtese ne gjendjen e vitit 2021	Shtesa	Pakesime	Shuma e Detyrimeve Progresiv 2022
1	Biznes i Vogël	Taksa e Tarifa vendore	Tarife pastrimi, ndricimi, gjelbrimi, Takse ndertese, Takse Trualli, Takse table, Tarife zenie hapesire publike, Tarife Parkimi	78,523,835	78,523,835	11,883,469	15,362,967	75,042,997

2	Biznes i Madh	Taksa e Tarifa vendore	Tarife pastrimi, ndricimi, gjelbrimi, Takse ndertese, Takse Trualli, Takse tabele, Tarife zenie hapësire publike, Tarife Parkimi	292,526,365	292,526,365	55,758,284	13,420,702	334,863,947
3	Taksapaguesit Familjare	Taksa e Tarifa Vendore	Takse Toke Bujqesore, Takse Ndertese, Takse e Truallit, Tarife Pastrimi	1,116,734,473	1,116,734,134	158,433,571	41,798,536.97	1,233,369,168.03
TOTALI				1,487,784,673	1,487,784,334	226,075,324	70,582,206	1,643,276,112

Referuar tabelës së mësipërme, vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në Bashkinë Lushnje paraqitet:

V lera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2022 është 155,493,118 lekë nga të cilat:

- Detyrimet nga taksat dhe tarifat për Biznesin i mdh e i vogël në shumën 38,858,083 lekë;

- Detyrimet nga taksat dhe tarifat për taksapaguesit familjare në shumën 116,635,035 lekë;

Në uljen e debitorëve kanë ndikuar pagesat e kryera për detyrimet debitorë të viteve para vitit 2021 në vlerën 95,221,008 lekë, e cila ka sjellë që **vlera debitorë për vitin 2022 të jetë 155,493,118 lekë.**

Për vitin 2022 gjendja e debitorëve progresiv është në vlerën 1,643,276,112 lekë:

- Detyrimet nga taksat dhe tarifat e bizneseve, rezultojnë në vlerën totale **409,906,944 lekë për 1749 biznese** (taksa-tarifa vendore);

- Detyrimet nga taksat dhe tarifat për taksapaguesit familjare në shumën **1,233,369,168 lekë;**

➤ **Masat e marra për uljen e borxhit**

Sektori i Menaxhimit të Borxhit Tatimor në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Lushnje është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara vijnë duke u përshkallëzuar si:

1. Njoftimi dhe kërkesa për të paguar;
2. Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit;
3. Masa e sigurimit të detyrimit tatimor;
4. Vendosje te kufizimit te pasurive ne ASHK
5. Sekuestrimi i pasurisë.
6. Urdhër ekzekutimi per llogarite bankare

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur me hapat, që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë njoftuar të gjithë bizneset debitorë për kalimin e afatit të pagesave të detyrimit për taksat dhe tarifat vendore.

Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet vendore, janë nxjerrë urdhrat përkatës për të ndërmarrë masa të tjera bazuar në përcaktimet e kuadrit ligjor të sipër cituar. Përkatësisht, janë nxjerrë urdhrat që ju janë dërguar bankave të nivelit të dytë për bllokimin e llogarive bankare të 3660 tatimpaguesve debitorë.

Mos arkëtimi i taksave dhe tarifave nga taksapaguesit debitorë, si dhe mos zbatimi i të gjithë masave ndaj tyre janë veprime në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 89,90,91 93 dhe 94, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime neni 181, me VKB nr. 100, datë 23.12.2021 “Për

sistemin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Lushnjes dhe penalitetet për kundravajtjet administrative për vitin 2022”.

Titulli i Gjetjes	Mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave, nivelin e borxhit tatimor të krijuar në fund të vitit ushtrimor dhe masat e marra për uljen e tij.
Situata	Referuar akt-rakordimeve për të ardhurat konstatohet se, për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet më shumë mbi planin, fakt që tregon se planifikimi i të ardhurave në disa zëra të ardhurash nuk është mbi baza reale si dhe në disa zëra të tjerë të ardhurash nuk është bërë punë e mjaftueshme për arkëtimin e tyre, gjë që ka sjellë ndikim negativ në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, duke mospasqyruar saktë burimin e të ardhurave. Vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në fund të vitit 2021 është në vlerën 1,487,784,334 lekë , vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2022 është 155,493,118 lekë dhe gjendja e debitorëve në mënyrë progresive në fund të vitit 2022 është në vlerën 1,643,276,112 lekë e cila përbëhet nga: - Detyrimet nga taksat dhe tarifatat e biznesit të vogël dhe të madh në shumën 409,906,944 lekë ; - Detyrimet nga taksat dhe tarifatat e familjarëve në shumën 1,233,369,168 lekë ;
Kriteri	Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 89,90,91 93 dhe 94, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime neni 181.VKB nr. 100, datë 23.12.2021 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Lushnjes dhe penalitetet për kundravajtjet administrative për vitin 2022”.
Ndikimi/Efekti	Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Lushnje.
Shkaku	Strukturat e Bashkisë Lushnje nuk kanë respektuar përcaktimet e VKB-së për paketën fiskale për arkëtimin e të ardhurave.
Rëndësia	E lartë
Rekomandim	Drejtoria e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Lushnje, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën progresive 1,643,276,112 lekë , ku përveç masave shtërnguese të marra si urdhër bllokimet e llogarive bankare, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme), në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar: -Të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar dhe nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

	<p>- Të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Lushnje, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.</p> <p>- Në dosjet e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.</p>
--	---

➤ **Akt marrëveshjet për pagesën me këste të detyrimeve**

Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Bashkia Lushnje ka lidhur marrëveshje për pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura me disa subjekte debitorë që sqarohen më të detajuara paraqiten në Aneks.

Nga auditimi i zbatimit të kushteve të akt marrëveshjeve rezulton se, nuk kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjes 18 subjekte me vlerë 2,040,318 lekë, të cilat duhet të kishin shlyer këstet deri në dhjetor të vitit 2022. Nga Bashkia Lushnje, Sektori i Menaxhimit të Borxhit Tatimor në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Lushnje nuk janë marrë masa për zgjidhjen e marrëveshjes së pagesës me këste në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 78.

• Arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore për familjarët.

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, në Bashkinë Lushnje dhe Njësitë Administrative taksohen gjithësej **37,397** familje, numër i cili shërben për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë "familjar". Të dhënat për numrin e familjeve që taksohen për çdo NJA, pasqyrohet si më poshtë:

Emërtimi	Sipas Regjistrimit të Gjendjes Civile	
	Nr. Popullsisë	Nr. Familjeve
Qytet	54794	17829
Njësia Admin. Kolonje	8505	2386
Njësia Admin. Bubullimë	7197	2043
Njësia Admin. Krutje	10354	2554
Njësia Admin. Allkaj	6350	1548
Njësia Admin. Fiershegan	9774	2435
Njësia Admin. Karbunar	5664	1455
Njësia Admin. Hysgjokaj	3634	966
Njësia Admin. Ballagat	3825	1024
Njësia Admin. Golem	7856	2043
Njësia Admin. Dushk	12162	3114
SHUMA	130,115	37,397

Burimi: DAV Bashkia Lushnje

Me qëllim vlerësimin nëse nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Lushnje është bërë planifikimi saktë i taksave dhe tarifave për kategorinë “familjar”, u kryqëzua informacioni i administruar nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Lushnje me informacionin e administruar nga Zyra e Gjendjes Civile në Bashkinë Lushnje e NJA.

Nga përlllogaritjet e kryera rezultoi se gjithsej janë përfshirë në taksat dhe tarifave vendore 57680 familje, ku diferenca më e lartë është në Qytetin e Lushnjes .

Nr	Njësi Administrative	2022		
		Taksapagues në regjistrim për vitin 2022	Familje sipas Gj.Civile	Diferenca
		<i>Nr</i>	<i>Nr</i>	<i>Nr</i>
1	Qytet, 5 njësi Administrative	28196	17829	10367
2	Njësia Admin. Kolonje	3932	2386	1546
3	Njësia Admin. Bubullimë	2949	2043	906

4	Njësia Admin. Krutje	3988	2554	1434
5	Njësia Admin. Allkaj	2273	1548	725
6	Njësia Admin. Fiershegan	3512	2435	1077
7	Njësia Admin. Karbunar	2341	1455	886
8	Njësia Admin. Hysgjokaj	1370	966	404
9	Njësia Admin. Ballagat	1354	1024	330
10	Njësia Admin. Golem	3217	2043	1174
11	Njësia Admin. Dushk	4542	3114	1428
	TOTAL	57680	37,397	20,283

Burimi: DAV Bashkia Lushnje dhe Zyra e Gjendjes Civile Lushnje, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga krahasimi i të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore nëpërmjet rregjistrimit të familjarëve rezulton se, janë taksuar 20,283 familje më shumë se numri i familjeve të rregjistrimit aktual të Gjendjes Civile për efekt të taksimit për tokën bujqësore të taksapaguesve, të cilët kanë përfituar tokë bujqësore si Kryefamiljar në 01/08/1991 me ligjin nr. 7501, ku një pjesë nuk janë banorë të Bashkisë Lushnje dhe një pjesë gjatë vitit 2022 kanë rezultuar që nuk jetojnë më, për të cilët Drejtoria e të Ardhurave Vendore nuk ka mundur të kryejë regjistrimin e tyre nga regjistri i taksave dhe tarifave, pasi rezultojnë pronar/perdorues (sipas AMTP).

Debitorët “Familjar”, të cilët nuk kanë likjuar detyrimet për taksat dhe tarifën vendore në Bashkinë Lushnje.

Në tabelat e mëposhtme pasqyrohet ecuria e debitorëve familjarë për tarifën e shërbimit (gjelbërim, pastrim), ndriçimit, taksën e ndërtesës, truallit, tokës bujqësore:

Numri i familjeve debitore sipas NJA, të cilat rezultojnë debitorë në një ose disa taksa/tarifa

Nr	Njësi Administrative	2022			
		Taksapagues debitor në regjistër në fillim të vitit 2022	Taksapagues në regjistër për vitin 2022	Taksapagues Debitor krijuar brenda vitit 2022	Progressive deri në vitin 2022
		Nr	Nr	Nr	Nr
1	Allkaj	1547	2273	1633	1644
2	Bubullime	1714	2949	1802	1810
3	Dushk	3581	4542	3489	3722
4	Fiershegan	3254	3512	3325	3332
5	Golem	1889	3217	1823	1823
6	Hysgjokaj	929	1370	1001	1134
7	Karbunare e Vogel	2129	2341	2125	2126
8	Kolonje	2827	3932	3122	3127
9	Krutje	2660	3988	2921	3157
10	Ballagat	1108	1354	1170	1174
11	Qytet	22728	28196	17357	22362
	Totali	44366	57674	39768	45411

Burimi: DAV Bashkia Lushnje, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Të dhënat për familjet debitore sipas llojit të taksës/tarifës në vlerë paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Lloji i Taksës dhe Tarifës	Debitor deri në fund të vitit	Maturimi	Arkëtimet	Debitorët krijuar brenda vitit	Arkëtuar debitorë për periudhën 2011-2021	Totali Debi
		2021	2022	2022	2022	2011-2021	Progressive
1	Ndërtesë	294,522,353	40,181,173	22,873,981	17,307,191	9,118,392	302,711,152
2	Tarifë Pastrim e largim mbeturina	458,848,899	70,860,789	29,240,220	41,620,569	11,486,490	488,636,371
3	Takse Truallit	16,713,926	3,685,588	1,161,787	2,523,801	576,087	24,583,970
	Totali	770,085,178	114,727,550	53,275,988	61,451,531	21,180,969	815,931,493

Burimi: DAV Bashkia Lushnje, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme rezulton se vlera debitore e kategorisë “Familjar” për taksat dhe tarifën vendore, në krahasim me fillimin e vitit 2022 është rritur me 45,846,315 lekë. Në mënyrë

të përmbledhur, konstatohet se në fund të vitit 2022 në Bashkinë Lushnje dhe NJA, janë gjithësej 45411 taksapagues debitore për vlerën 815,931,493 lekë, nga të cilat 39768 taksapagues për vlerën 61,451,531 lekë janë debitor të krijuar brenda vitit 2022. Nga zyrat e taksave në çdo njësi, taksa familjare është maturuar bashkë me taksën e biznesit, si dhe është maturuar për fshatrat bashkë me taksën e tokës bujqësore.

Bashkia Lushnje ka si Agjent Tatimor për arkëtimin tarifës së pastrimit, taksën e ndërtesës dhe taksën e truallit për kategorinë “Familjar” Sha Ujësjesllës-Kanalizime Lushnje, e cila sipas akt rakordimit me Bashkinë Lushnje për të ardhurat rezulton se **deri në fund të vitit 2022** ka mbetur pa u derdhur Bashkisë **vlera në mënyrë progresive prej 58,253,311.09 lekë** nga vlera e deklaruar prej 58,253,311.09 lekë. Të dhënat për maturimet, derdhjet e kryera për llogari të Bashkisë, si dhe detyrimet e pashlyera ndaj Bashkisë Lushnje, sipas akt-rakordimit me Sha Ujësjesllës Kanalizime Lushnje paraqiten në Aneks.

Akt-rakordimi me Sha Ujësjesllës Kanalizime Lushnje për vitin 2022

NR	MUAJI	TE ARDHURA	LIKUJDIME PER BASHKINE	DEBITORE
	JANAR- DHJETOR 2022	58,253,311.09	-	58,253,311.09
	TOTALI	58,253,311.09	-	58,253,311.09

Nga Sha Ujësjesllës Kanalizime Lushnje ka bashkëpunim me Bashkinë Lushnje për shkëmbimin e të dhënave në lidhje me numrin e kontratave të lidhura me kryefamiljarët. Punonjësit e Drejtorisë Të Ardhurave Vendore çdo muaj përditësojnë kartelat e taksapaguesve në sistemin e Ujësjesllës për taksapaguesit që përjashtohen nga taksat dhe tarifatat sipas ligjit si dhe mbi ndryshime të ndryshme të sipërfaqes së banesave.

- Ne Njësiti Administrative për banesat, të cilat nuk janë të lidhura me rrjetin e Ujësjesllës, taksa e banesës, tarifa e pastrimit dhe taksa e truallit mbledhet pranë Zyres së Taksave në Njësiti Administrative përkatëse nga Bashkia Lushnje.

- Nga punonjësit e taksave nëpër NJA kanë datababaze të të gjithë taksapaguesve të regjistruar në territorin e njesise përkatëse përfshirë këtu edhe taksapaguasit, qe nuk kanë një kontratë aktive me Ujësjesllës Kanalizime Lushnje SH.A.

Për familjet debitore nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore janë dërguar njoftime për detyrimin dhe marrjen e masave shtrënguese ose masat janë kufizuar, pasi nuk ka agjent tatimor për vjeljen ketyre detyrimeve, kjo bëhet nga inspektorët e taksave.

Drejtorija e Taksave Tarifave Vendore është në proces të konsolidimit të rregjistrimit të përditësuar të taksapaguesve familjarë, që identifikon të gjitha familjet, që jetojnë apo janë me leje banimi në territorin e saj, duke krijuar një database për tatimpaguesit me të dhënat e duhura për ngarkesën dhe faturimin me taksa dhe tarifa, detyrim ligjor për tu paguar nga taksapaguesit për njësiti vendore në këmbim të shërbimeve që marrin nga shërbimet e Bashkisë.

Titulli i Gjetjes	Mos arkëtim i taksave nga taksapaguesit familjarë për detyrimet vendore.
Situata	Në Bashkinë Lushnje aktualisht familjet ngarkohen me detyrime për taksën e ndërtesës e truallit dhe tarifatat pastrim-gjelbërim-ndricimit. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, në Bashkinë Lushnje dhe NJA taksohen gjithësej 57680 familje më shumë se numri i familjeve të rregjistrimit aktual të Gjendjes Civile prej 20,283 familje, numër i cili shërben për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë "familjar". Nga familjarët e taksuar konstatohet se në Bashkinë Lushnje dhe NJA në fund të vitit 2021 janë trashëguar 44366 familje me vlerë debitorë prej 770,085,178 lekë dhe në fund të vitit 2022 , janë gjithësej 45411 familje debitore për vlerën

	815,931,493 lekë , nga të cilat 39768 taksapagues për vlerën 61,451,531 lekë janë debitor të krijuar brenda vitit 2022 . Bashkia Lushnje ka si Agjent Tatimor për arkëtimin tarifës së pastrimit dhe taksën e ndërtesës Sha Ujsjellës-Kanalizime Lushnje, e cila sipas aktrakordimit me Bashkinë Lushnje për të ardhurat rezulton se deri në fund të vitit 2022 ka mbetur pa u derdhur Bashkisë vlera në mënyrë progresive prej 58,253,311.09 lekë nga vlera e deklaruar e maturimit prej 58,253,311.09 lekë.
Kriteri	VKB nr.100, datë 23.12.2021, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Lushnjes dhe penaltitetet për kundravajtjet administrative për vitin 2022”, Kreu III neni 16,17, Kreu V “Taksa mbi truallin” neni 24, Kreu XI neni 44 pika 3, me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, neni 12 pika 1, me ligjin nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4 pika 7, me ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 70 dhe 117.
Ndikimi/Efekti	Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Lushnje.
Shkaku	Strukturat e Bashkisë Lushnje nuk kanë respektuar përcaktimet e VKB-së për paketën fiskale duke mos arkëtuar tëradhurat nga takasat dhe tarifatat për kategorinë familjar.
Rëndësia	E lartë
Rekomandim	Bashkia Lushnje nëpërmjet Drejtorisë së Ardhurave Vendore të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksa dhe tarifatat vendore të debitorëve familjarë në vlerën 815,931,493 lekë , si dhe të plotësojë e përditësojë regjistrin për taksapaguesit e kategorisë familjare me të gjitha të dhënat e nevojshme, i cili të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve vendore, që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Lushnje. Gjithashtu të shqyrtohet mundësia e arkëtimit të shumës së të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore të mbledhur nga agjenti tatimor Sha Ujsjellës Kanalizime Lushnje, nëse nuk është e mundur të shikohet mundësia e ndëshkimit me gjobë sipas dispozitave ligjore në fuqi për detyrimin e paderdhur ndaj Bashkisë.

➤ **Planifikimi dhe arkëtimi i taksës së tokës bujqësore.**

Me qëllim vlerësimin nëse nga DAV Bashkia Lushnje është bërë planifikimi saktë i taksës së tokës bujqësore, u kryqëzua informacioni i administruar nga DAV Bashkia Lushnje me informacionin e administruar Sektori i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës mbi sipërfaqen e tokës bujqësore, familjet që kanë në pronësi/përdorim tokë bujqësore dhe kategorinë e bonitetit, sipas NJA paraqiten në Aneks.

Kategoria e tokës	Sip/HA-Qytet	Sip/HA-Nj.Allkaj	Sip/HA-Nj.Ballagat	Sip/HA-Nj.Bubullimë	Sip/HA-Nj.Dushk	Sip/HA-Nj.Fiershegan	Sip/HA-Nj.Golem	Sip/HA-Nj.Hysgjokaj	Sip/HA-Nj.Karbunar	Sip/HA-Nj.Krujtje	Sip/HA-Nj.Kolonje	Cmimi / Ha
Kategoria I	2.76	92.2	0	0	7	0	60	0	1	61	8.7	3920
Kategoria II	313.8	497.9	0	180.3	1568	72	800	9.4	2.3	1063	282.1	3430
Kategoria III	2508	1198.6	0	1787.3	261	1176	100	453.1	128.6	2146	1250	2940
Kategoria IV	625.3	0	0	849.1	687	533	700	683.6	402	382	964.3	2520
Kategoria V	125.9	0	5.9	11.3	448	244	750	50	495	46	233.8	2100

Kategoria VI	0	0	70.5	0	10	196	220	36	782.1	43	0	1680
Kategoria VII-X	0	0	1102.3	0	0	154	70	0	663	35	0	1260
Totali sip. ha sipas planifikim	3575.76	1788.7	1178.7	2828	2981	2375	2700	1232.1	2474	3776	2738.9	17850

Burimi: DAV Bashkia Lushnje dhe agronomët sipas NJA

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, gjithësej tokë bujqësore sipas DAV Bashkia Lushnje janë 27648.16 Ha, sipërfaqe e cila shërben si bazë për planifikimin e arkëtimit nga kjo taksë. Konkretisht planifikimi i taksës së tokës bujqësore nga DAV Bashkia Lushnje, pasqyrohet në tabelën si më poshtë vijon:

Planifikimi i taksës së tokës bujqësore nga DAV Bashkia Lushnje për vitin 2022

Kategoria e tokës	Sip/HA Qytet	Sip/HA-Nj.Allkaj	Sip/HA-Nj.Ballagat	Sip/HA-Nj.Bubullimë	Sip/HA-Nj.Dushk	Sip/HA-Nj.Fiershegan	Sip/H Nj.Golem	Sip/HA Nj.Hysgjokaj	Sip/HA Nj.Karbutar	Sip/H Nj.Krutje	Sip/HA Nj.Kolonje	Cmimi / Ha	Plani/Lek
Kateg I	2.76	92.2	0	0	7	0	60	0	1	61	8.7	3920	912,027
Kateg II	313.8	497.9	0	180.3	1568	72	800	9.4	2.3	1063	282.1	3430	16,425,584
Kateg III	2508	1198.6	0	1787.3	261	1176	100	453.1	128.6	2146	1250	2940	32,365,284
Kateg IV	625.3	0	0	849.1	687	533	700	683.6	402	382	964.3	2520	14,682,276
Kateg V	125.9	0	5.9	11.3	448	244	750	50	495	46	233.8	2100	5,060,790
Kateg VI	0	0	70.5	0	10	196	220	36	782.1	43	0	1680	2,280,768
Kat. VII-X	0	0	1102.3	0	0	154	70	0	663	35	0	1260	2,550,618
Totali	3575.76	1788.7	1178.7	2828	2981	2375	2700	1232.1	2474	3776	2738.9	17850	74277347

Gjithashtu duhet theksuar se regjistri i taksës për tokën bujqësore ka mangësi në numrin e taksapaguesve objekt taksimi, pasi në këtë rregjistrë nuk janë kryer përditësimet për cdo vit, pasi ASHK Lushnje nuk ka dërguar të dhëna mbi transaksionet e kryera në tokën bujqësore (shitje-blerje) me qëllim përditësimin e regjistrit të taksës së tokës bujqësore.

➤ Ndjekja e procedurave për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore.

Në fund të vitit 2022 rezulton se, vlera debitore për taksën e tokës bujqësore është 417,437,675 lekë në NJA të Bashkisë Lushnje, e cila në krahasim me fillimin e vitit 2022 është rritur me 346,648,955 lekë.

Gjatë vitit 2022 janë gjithsej 15047 familje debitore për vlerën 70,788,720 lekë, ku peshën më të madhe të familjeve debitore e ka NJA Krutje, duke vijuar me NJA Dushk .

Arkëtimi i kësaj takse paraqitet me problem në Bashkinë Lushnje, për arsye se familjet, të cilat taksohen për tokën bujqësore në 60 % të tyre janë të identifikuar me të dhënat personale (emër, atësia, mbiemër, Nr. Id, datëlindje) dhe 40 % e taksapaguesve nuk janë të identifikuar me të dhënat personale, me qëllim arkëtimin e kësaj takse. DAV Bashkia Lushnje arkëtimin e kësaj takse e mundëson vetëm kur familjari/personi që ka në përdorim/ pronësi tokë bujqësore, aplikon pranë Bashkisë Lushnje për të marrë një vërtetim/shërbim të caktuar, si dhe duke kryer procedurën e dërgimit të Njoftim detyrimeve me anën e shërbimit postar pranë adresave të deklaruara.

Më poshtë pasqyrohet ecuria e debitorëve të rezultuar për taksën e tokës bujqësore:

NJA.	Debitorë të tokës bujqësore viti 2022				DEBIA PROGRESIVE
	Debitor të trashëguar deri në fillim të vitit 2022	Familje me tokë bujqësore	Familje debitore (Nr)	Familje debitore (vlerë)	
Allkaj	27127807	1317	1055	3629796	30757603
Bubullime	34814764	1941	1143	2174762	36989526
Dushk	34396092	2462	1689	1895675	36291767
Fiershegan	49258206	1688	1445	107961	49366166
Golem	10527449	1989	1162	18435078	28962527
Hysgjokaj	14671051	647	546	1588942	16259993
Karbutare e Vogel	37665932	1201	1096	2221564	39887496
Kolonje	35045952	2226	1436	2920525	37966476

Krutje	33341334	2605	1919	24585632	57926965
Ballagat	10527449	739	651	816282	11343731
Qytet	59272920	3548	2905	12412504	71685424
TOTAL	346648955	20363	15047	70788720	417437675

Burimi: DAV Bashkia Lushnje, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Këto veprime janë në kundërshtim me VKB nr.100, datë 23.12.2021, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkië e Lushnjes dhe penalitetet për kundravajtjet administrative për vitin 2022”, Kreu III “taksa mbi pasurinë e paluajtshme (ndertesat)” neni 16,17, Kreu V “Taksa mbi truallin” neni 24, Kreu IV “Taksa mbi tokën bujqësore”, Kreu XI neni 44 pika 3, me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, neni 12 pika 1, me ligjin nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4 pika 7, me ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 70 dhe 117².

Titulli i Gjetjes	Mos arkëtim i taksës së tokës bujqësore nga familjet fermere
Situata	Nga auditimi konstatohet se,realizimi i taksës bujqësore është në vlerën 45,904 mijë lekë nga 100,000 mijë lekë ose në masën 45.9%, ku 27648.16 Ha, sipërfaqe e shërben si bazë për planifikimin e kësaj takse. Rregjistri i taksës për tokën bujqësore ka mangësi në numrin e taksapaguesve objekt taksimi, pasi në këtë rregjistër nuk janë kryer përditësimet për cdo vit, pasi ASHK Lushnje nuk ka dërguar të dhëna mbi transaksionet e kryera në tokën bujqësore (shitje-blerje) me qëllim përditësimin e regjistrit të taksës së tokës bujqësore. Arkëtimi i kësaj takse paraqitet me problem në Bashkinë Lushnje, për arsye se familjet, të cilat taksohen për tokën bujqësore në 60 % të tyre janë të identifikuar me të dhënat personale (emër, atësia, mbiemër, Nr. Id, datëlindje) dhe 40 % e taksapaguesve nuk janë të identifikuar me të dhënat personale, me qëllim arkëtimin e kësaj takse. DAV Bashkia Lushnje arkëtimin e kësaj takse e mundëson vetëm kur familjari/personi që ka në përdorim/ pronësi tokë bujqësore, aplikon pranë Bashkisë Lushnje për të marrë një vërtetim/shërbim të caktuar, si dhe duke kryer procedurën e dërgimit të Njoftim detyrimeve me anën e shërbimit postar pranë adresave të deklaruara. Debitorët për taksën e tokës bujqësore në fund të vitit 2021 janë në vlerën 346,648,955 lekë, gjatë vitit 2022 janë krijuar 15047 familje debitorë për vlerën 70788720lekë dhe në fund të vitit 2022 debitorët në vlerë progresive janë 417,437,675 lekë.
Kriteri	ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 pika1, Aneksi 1 dhe me VKB nr.nr. 100 datë datë 23.12.2021, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkië e

²Neni 117 “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”

Agjenti i mbajtjes së tatimit, agjenti i taksave apo ai i tarifave detyrohen të paguajnë gjobë, në masën e mëposhtme:
a) Gjobë në masën 0,06 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës, në rast se e ka mbajtur, llogaritur dhe deklaruar tatimin në burim apo tatimin, taksën ose tarifën, por nuk e ka transferuar atë në Buxhetin e Shtetit. Ky dënim aplikohet për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

b) Gjobë në masën 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës në rast se nuk mban tatimin në burim apo tatimin apo nuk mbledh taksën ose tarifën;

c) Gjobë në masën 100 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës nëse mban dhe nuk deklaroi e paguan tatimin në burim apo tatimin, taksën ose tarifën e mbledhur.

	Lushnjes dhe penalitetet për kundravajtjet administrative për vitin 2022” Kreu IV “Taksa mbi tokën bujqësore”.
Ndikimi/Efekti	Nuk është bërë punë e mjaftueshme për arkëtimin e e taksës së tokës nga familjet fermere referuar paketës fiskale duke sjellë mungesë të ardhurash në buxhetin e bashkisë.
Shkaku	Bashkia Lushnje nuk ka të dhëna të plota dhe të përditësuara për familjet fermere në lidhje me statusin e tokës dhe të dhënat personale.
Rëndësia	E lartë
Rekomandim	Bashkia Lushnje, nëpërmjet Drejtorisë së të Ardhurave Vendore të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksën e taksës bujqësore nga debitorët fermerë në vlerën 417,437,675 lekë . Drejtoria e të Ardhurave Vendore nëpërmjet Struktrave drejtuese të vendosi bashkëpunim instucional me ASHK Lushnje për marrje informacioni dhe të marrë masa për të identifikuar numrin e familjeve me të dhënat personale, që kanë në pronësi apo në përdorim tokë bujqësore si dhe sipërfaqen e saktë që ato zotërojnë, me qëllim krijimin e një regjistri me të dhëna të plota dhe të sakta. Ky regjistër më pas të shërbejë si bazë për të bërë, planifikimin e plotë dhe përlllogaritjen e detyrimeve që ju lindin këtyre familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Lushnje.

Përsa më sipër ngarkohen më përgjegjësi: z. Donald Nushi me detyrë Drejtor i të Ardhurave Vendore, z.K. M. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Vlerësimit, Asistencës dhe Shërbimit ndaj Tatimpaguesve, z.A. S. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit dhe Zbatimit dhe z. D. S. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Borxhit.

➤ **Taksa e ndikimit në infrastrukturë**

Në Bashkinë Lushnje struktura, që administron dokumentacionin nga ASHK/Drejtoria Vendore Lushnje dhe përlllogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për subjektet që pajisen me Leje legalizimi është Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bazë të pikës 30 të kreut VI të VKB nr.100, datë 23.12.2021 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkië e Lushnjes dhe penalitetet për kundravajtjet administrative për vitin 2022” .

Nga auditimi i ecurisë së pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet *rezulton se*, në Bashkinë Lushnje ka detyrime të pa paguara për objekte që janë legalizuar që nga viti 2015 deri në 31.12.2020 në vlerën **15,337,417.55 lekë për 529 objekte**. Nga korespondenca zyrtare e Bashkisë Lushnje me ASHK për vitin 2021 janë kryer dhe për vitin 2022 janë kryer 898 legalizime.

- **Në fund të vitit 2021** vlera debitore është në fakt 24,204,328.8 lekë që i përket 685 përfitues të legazimeve

- **Gjatë vitit 2022** janë shtuar debitorë në vlerën 9,787,133 lekë (shtesat 26,183,817 lekë - pagesat 16,396,684 lekë)

- **Në fund të vitit 2022** vlera debitore është në fakt **33,991,461.8 lekë** që i përket 1302 përfitues të legazimeve

Në lekë

Emërtimi	Vlera në fund te vitit 2020, sipas B. Lushnje	Shtesat gjatë 2021	Pgesat gjate 2021	Gjendja debitore në fund të vitit 2021	Nga verifikimi dale të paguara më parë	Vlera e mbetur debitore në fund të vitit 2021

		a	b	c	d=(a+b)-c	e	f=d-e
		15,337,414.3	30,211,559.84	19,990,231	25,558,743.14	1,354,414.34	24,204,328.8
Taksa e ndikimit në infrastrukturë	Vlera në fund te vitit 2021 sipas KLSH	Vlera në fund te vitit 2021, sipas B. Lushnje	Shtesat gjatë 2022	Pgesat gjate 2022	Gjendja debitore në fund të vitit 2022		
	a	b	c	d	e=(b+c)-d		
	40,144,563.3	24,204,328.8	26,183,817	16,396,684	33,991,461.8		

Vlera e debitorëve në fund të **vitit 2021** prej 40,144,563.3 lekë e raportuar në KLSH nga bashkia Lushnje është vlerë e pasaktë për arsye se, është bërë mbledhja e gjendjes debitore progresive në fund të vitit 2020 prej 15,337,415.55 lekë dhe gjendja debitore progresive në fund të vitit 2021 prej 24,807,149.84 lekë, duke dubluar vlerën e debitorëve. **Vlera debitore për taksën e infracstrukturës nga përfituesit e legalizimeve deri në datë 31.12.2022 është 33,991,461.8 lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Lushnje.** Në mënyrë të detajuar debitorët e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet e ndërtimeve informale deri në fund të vitit 2022 paraqiten në Aneks.

Mos arkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë nga përfituesit debitorë të legalizimeve janë veprime ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksavevendore", i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, i ndryshuar me ligjin nr. 95/2018, neni 9, pika 3/c³, me ligjin nr. 98/2020 "për disa ndryshime dhe shtesatë ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksavevendore", i ndryshuar, neni 1, "në nenin 27, pika 3, shkronja "c", me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave përndërtimet pa leje dhe vleravetë zbatueshme për legalizim" pika 5⁴, me VKB nr. 100, datë datë 23.12.2021, "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkië e Lushnjes dhe penalitetet për kundravajtjet administrative për vitin 2022" kreu VII.

Titulli i Gjetjes	Mos arkëtim i taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet e ndërtimeve informale.
Situata	Nga auditimi i dokumentacionit financiar të pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet e ndërtimeve informale rezulton se, në Bashkinë Lushnje vlera debitore për taksën e infracstrukturës nga përfituesit e legalizimeve deri në datë 31.12.2022 është 33,991,461.8 lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Lushnje. Vlera e debitorëve në fund të vitit 2021 prej 40,144,563.3 lekë e raportuar në KLSH nga bashkia Lushnje është vlerë e pasaktë për arsye se, është bërë mbledhja e gjendjes debitore progresive në fund të vitit 2020 prej 15,337,415.55 lekë dhe gjendja debitore progresive në fund të vitit 2021 prej 24,807,149.84 lekë , duke dubluar vlerën e debitorëve. Nga korespondenca zyrtare e Bashkisë Mirditë me ASHK Rajonale Lushnje për periudhen objekt auditimi rezulton se, gjatë vitit 2022 është krijuar gjendje debitore prej 9,787,133 lekë.
	Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksavevendore", i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, me ligjin nr. 95/2018 "për disa ndryshime dhe shtesa

³për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi"

⁴"Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Për zbatimin e kësaj pike, drejtoritë e ALUIZNI-t, të vënë në dispozicion të njësisë të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi"

Kriteri	në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006,“Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c, me ligjin nr. 98/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesatë ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006,“Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 1, “në nenin 27, pika 3, shkronja “c”, me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “ Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave përndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5 dhe me VKB nr. 100, datë 23.12.2021, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Lushnjës dhe penalitetet për kundravajtjet administrative për vitin 2022” kreu VII.
Ndikimi/Efekti	Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Lushnje nga mos arkëtimi i vlerës prej 33,991,461.8 lekë për ndërtimet informale, që legalizohen.
Shkaku	Mos marrje e masave efektive nga Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit të Territorit për të bërë të mundur pagesën e taksës së infrastrukturës nga legalizimet.
Rëndësia	E lartë
Rekomandim	Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Lushnje të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 617 debitorë në vlerën 33,991,461.8 lekë , si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Lushnje të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) Rajonale, Lushnje për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen, si dhe të bëhen marrëveshje për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi: znj. M.H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

➤ **Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve**

Nga auditimit i dokumentacionit të paraqitur Drejtoria e Shërbimeve Publike si struktura e ngarkuara për dhënien e Autorizimit për pikat e tregtimit me pakicë të karburanteve dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqirezulton se, Bashkia Lushnje ka pajisur rast pas rasti me autorizim/licencë subjektet që ushtrojnë aktivitet për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë dhe ka hartuar akt marrëveshje me to lidhur me pagesën e detyrimit për autorizimin. Marrëveshja konsiston në krijimin e mundësisë për subjektet që detyrimin e autorizimit në vlerën prej 1,000,000 lekë për 5 vite ta paguajnë me këste vjetore në vlerën 200,000 lekë. Në territorin e Bashkisë Lushnje për periudhën objekt auditimi subjekte që kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë si dhe detyrimet dhe vlerat debitorë paraqiten në tabelën në Aneks.

Nga verifikimi i tarifës vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në mbledhjen e detyrimeve specifike për këtë kategori biznesi. Nga tabela e mësipërme rezulton se aktiviteti për tregti karburanti dhe tregti gazi ushtrohet nga 78 subjekte me status “aktive” në Qendrën Kombëtare të Biznesit nga të cilët 38 subjekte me aktivitet karburant dhe 10 me aktivitet tregti gazi, gjithashtu 20 subjekte nuk e ushtrojnë më aktivitetin pasi janë me status ç’regjistruar ose pezulluar.

Për vitin 2022 janë konstatuar pa licencën e tregtimit me pakicë të karburantit dhe licencën për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit, 30 subjekte karburante janë të pajisura me licencën përkatëse dhe 38 nuk janë të pajisura, si dhe 5 subjekte tregti gazi janë të pajisura me licencën përkatëse dhe 5 nuk janë të pajisura.

Me shkresën nr.prot.6769, datë 01.08.2022 “Bashkia Lushnjë ka dërguar informacion në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës, si dhe Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial si dhe ka kërkuar marrjen e masave nga ana e tyre për bllokimin e të gjithë karburanteve dhe pikave të tregtimit të gazit të cilat nuk janë të pajisura me Autorizimin përkatës, si dhe Autoritetit Rrugor Shqiptarë për marrjen e masave për të gjithë ata subjekte, të cilët nuk janë të pajisur me autorizimin e hyrje-dalje në autostradë si një dokument i domosdoshëm për pikat e karburantit për pajisjen e tyre me autorizim për tregtim me pakicë të karburanteve. Nga ana e institucioneve të sipërpërmendura nuk është ndërmarrë asnjë masë për moslejimin e ushtrimit të aktivitetit për këto subjekte, në mospërputhje me VKM Nr. 344 datë 19.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970 datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” **pika 15.1** në të cilën përcaktohet: “Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë pa licencë aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë”.

Referuar dosjeve të subjekteve që operojnë në territorin e Bashkisë Lushnje për shitje me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tij konstatohet se, kanë **detyrime të papaguara 39 subjekte në vlerën 29,550,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Lushnje.**

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, nenet 4⁵, 15⁶, 20 pika 2⁷, 11 dhe me VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, kreu II, pika 3.⁸

Titulli i Gjetjes	Mbi pajisjen me autorizim për ushtrimin e aktivitetit të subjekteve që tregtojnë lëndë djegëse.
Situata	Në territorin e Bashkisë Lushnje për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitetet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 78 subjekte me status “aktive” në QKB nga të cilët 68 subjekte me aktivitet

⁵Neni 4 “Ushtrimi i veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre bëhet vetëm nga persona juridikë, pasi të jenë pajisur paraprakisht me lejet dhe autorizimet përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në mungesë të këtyre lejeve dhe autorizimeve, veprimtaria e kryer quhet e paligjshme”

⁶Neni 15⁶ “...Stacionet e shitjes së karburanteve lejohen të ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm pasi të jenë pajisur nga organi kompetent me autorizimin përkatës, sipas këtij ligji...”

⁷neni 20-Autorizimet pika 2 “Autorizimet për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në pikat “ç” dhe “d” të nenit 11, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje”

⁸“Dhënia e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarinë e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga organet e qeverisjes vendore”.

	<p>karburant dhe 10 me aktivitet tregti gazi, gjithashtu 20 subjekte janë me status ç' regjistruar ose pezulluar. Për vitin 2022 janë konstatuar 38 subjekte pa licencën e tregtimit me pakicë të karburantit dhe 5 subjekte tregti gazi. Me shkresën nr.prot.6769, datë 01.08.2022 Bashkia Lushnjë ka dërguar informacion në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës dhe Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial u ka kërkuar marrjen e masave nga ana e tyre për bllokimin e të gjithë karburanteve dhe pikave të tregtimit të gazit, të cilat nuk janë të pajisura me Autorizimin përkatës, si dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar për marrjen e masave për të gjithë ata subjekte, të cilët nuk janë të pajisur me autorizimin e hyrje-dalje në autostradë. Nga ana e institucioneve të sipërpërmendura nuk është ndërmarrë asnjë masë për moslejimin e ushtrimit të aktivitetit për këto subjekte. Referuar dosjeve të subjekteve që operojnë në territorin e Bashkisë Lushnje për shitje me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tij konstatohet se, kanë detyrime të papaguara 39 subjekte në vlerën 29,550,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Lushnje.</p>
Kriteri	<p>Ligji nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, nenet 4,15 dhe 20/2” dhe me VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, kreu II, pika 3, pika 15.1.</p>
Ndikimi/Efekti	<p>Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Lushnje.</p>
Shkaku	<p>Puna jo efektive e Drejtorise së Përgjithshme të Shërbimeve Publike dhe Sociale në identifikimin në kohë të përfundimit të afateve të autorizimeve për ushtrimin e aktivitetit si dhe mos ndjekja e hapave ligjorë për subjektet që vazhdojnë të ushtrorjnë aktivitetet pa autorizim.</p>
Rëndësia	<p>E lartë</p>
Rekomandim	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Publike dhe Sociale të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për tarifën e autorizim/licencën për ushtrimin e aktivitetit të shitjes së hidrokarbureve, të papaguara nga 39 subjektet në vlerën 29,550,000 lekë të paraqitur në aneks. Nga strukturat drejtuese të Bashkisë Lushnje të vazhdohet komunikimi zyrtar institucional me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës dhe me Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial për marrjen e masave nga ana e tyre për bllokimin e të gjithë karburanteve dhe pikave të tregtimit të gazit, të pa licencuara, si dhe me Autoritetin Rrugor Shqiptar për marrjen e masave për subjektet, të cilët nuk janë pajisur me autorizimin e hyrje-daljeve në autostradë.</p>

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi: z. E. K me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Publike dhe Sociale (për periudhën 01.01.2022 deri 03.05.2022 dhe zj.Xh. T me detyrë specialiste për transportin dhe licencat profesionale (për periudhën 15.05.2022)

2.3. Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

- 3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;
- 3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë;
- 3.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.
- 3.4. Auditim mbi administrimin e aseteve procedura e inventarizimit si edhe regjistrimi i tyre në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës.

Për auditimin e pikës 3 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Pasqyrat financiare të vitit 2022 të shoqëruar me formatet 1-9.
2. Dokumente kontabël si: ditaret e bankës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve, etj, centralizatori, bilanci vërtetues.
3. Dokumentacioni i kryerjes së inventareve të aktiveve 2022, libri i aktiveve.
4. Urdhër-shpenzimet dhe dokumentacioni bashkëlidhur për vitin 2022.
6. Akt-rakordimet me Degën e Thesarit Lushnje në mbyllje të vitit buxhetor 2022.
8. Të tjera dokumente mbështetëse (database të ndryshme ne programet “excel”si: përvendimet gjyqësore, përinvestimet, përditaret, shpenzimet te ardhurat etj.).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

- ***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:***

Për vitin 2022 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Lushnje” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5 datë 21.02.2022, VKM Nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”.

- ***Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.***

Konkluzion: Bashkia Lushnje ka 4 njësi shpenzuese të cilat janë Aparati dhe tre institucione të varësisë si: Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Pasurisë Publike, Qendra e Kulturës dhe Klubi i Sportit dhe Qendra e Arsimit që financohen me fondet e bashkisë. Bashkia Lushnje për vitin 2022 nuk ka hartuar Pasqyrat Financiare të Konsoliduara në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu IV “Përbërja, përgatitja dhe rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara” Kreu III pikat 23-27 dhe pika 103.

Titulli i Gjetjes	Mbi hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduara.
Situata	Bashkia Lushnje ka 4 njësi shpenzuese të cilat janë Aparati dhe tre institucione të varësisë si: Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Pasurisë Publike, Qendra e Kulturës dhe Klubi i Sportit dhe Qendra e Arsimit që financohen me fondet e bashkisë. Bashkia Lushnje për vitin 2022 nuk ka hartuar Pasqyrat Financiare të Konsoliduara.
Kriteri	Udhëzimi i MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu IV “Përbërja, përgatitja dhe rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara” Kreu III pikat 23-27 dhe pika 103, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, Kreu X, neni 53 “Pasqyrat financiare dhe konsolidimi”.

Ndikimi/Efekti	Mos hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara
Shkaku	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk ka marrë në dispozicion PF e njësive shpenzuese në varësi të bashkisë, duke mos ndjekur procedurat ligjore për hartimin e PF të konsoliduara.
Rëndësia	E mesme
Rekomandim	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa, që në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 të kërkojë dhe të disponojë PF e njësive të varësisë si: Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Pasurisë Publike, Qendra e Kulturës dhe Klubi i Sportit dhe Qendra e Arsimit. Të kryejë konsolidimin e pasqyrave financiare të Bashkisë. Të kryejë konsolidimin e pasqyrave financiare të Bashkisë, të cilat të japin një pamje të strukturuar të pozicionit financiar dhe transaksioneve financiare me qëllim që, të japin informacion të besueshëm për vendimmarrje për vetë Bashkinë rreth burimeve financiare dhe alokimin e tyre, për mënyrën e financimit të aktiviteteve dhe kërkesave për fonde, për aftësinë e Bashkisë për të financuar aktivitetet dhe për të përmbushur detyrimet dhe angazhimet si dhe vlerësimin e performancës së Bashkisë.

- ***Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare***

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Lushnje për vitin ushtrimor 2022 me shkresë përcjellëse nr.prot.2774 datë 30.03.2023. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari i Bashkisë Lushnje dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Përgjegjësi Financës.

- ***Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.***

Për vitin 2022 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klases 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrate banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- ***Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.***

Për t'u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mosndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditareve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë .***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “Excel”.

- Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

- Azhornimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditaret e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj. Është mbajtur centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditaret në centralizator deri në bilancin vërtetues. Gjithashtu është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumentave bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arketimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

- ***Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.***

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2022 deri më datën 31.12.2022.

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar, përveç rastit të kontratave të investimeve në vlerë të plotë dhe vlerës së faturave të palikujduara për investime në fund të vitit ushtrimor 2022.

Saktësia: Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e rregjistruara dhe ngjarjet janë rregjistruar në mënyrë të përshtatshme.

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë rregjistruar në periudhen e saktë kontabël, përveç disa rasteve të shpenzimeve të kryera për investime, të cilat nuk janë rregjistruar në momentin e celjes së fondeve dhe mbërritjes së faturës.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë rregjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhes

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe fondet e veta ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.

Plotësia: Të gjitha asetet dhe fondet e veta janë rregjistruar, detyrimet janë rregjistruar të gjitha në mbyllje të vitit ushtrimor dhe janë të paraqitura të plota në bilanc.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivët, pasivët dhe fondet e veta janë të përfshira në pasqyrat financiare me shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, si dhe rregullimet që rezultojnë janë të rregjistruara.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare nuk janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara, si dhe janë mbajtur shënimet shpjeguese, të cilat shprehin paqartësitë e ndodhura .

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera në përgjithësi është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasinë e duhur.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financë-Buxhetit. Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, në disa raste janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në celje për vitin 2022 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2022.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2022 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabel ne llogarine e 520 “Disponibilitete në Thesar” dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në me formatin nr.5 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2022”.

Totali i Aktivit për vitin 2022 është në vlerën 3,153,985,267 lekë dhe i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari si më poshtë:

Formati nr.1		Aktivi i Bilancit 2022	Në lekë	
Nr. Reshti	Referenca e Logarive	EMERTIMI	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
1	A	A K T I V E T	3,153,985,267	3,089,771,774
2		I. Aktivët Afatshkurtra	2,005,184,202	1,764,793,037
3		1.Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre	231,056,893	165,454,270
4	531	Mjretemonetare ne Arke		0

5	512,56	Mjretemonetare ne Banke		0
6	520	Disponibilitete ne Thesar	231,056,893	165,454,270
7	50	Letra me vlere		0
8	532	Vlera te tjera	0	0
9	54	Akreditiva dhe paradhenie		0
10	59	Provigjone zhvlersim I letra me vlere (-)		0
11		2. Gjendje Inventari qarkullues	13,778,155	12,468,735
12	31	Materiale	3,123,570	2,496,374
13	32	Inventar I imet	10,654,585	9,972,361
14	33	Prodhim ne proces		0
15	34	Produkte		0
16	35	Mallra		0
17	36	Kafshe ne ritje e majmeri		0
18	37	Gjendjete pa mbritura,oseprane te treteve		0
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		0
20	39	Provigjone per zhvlersimin e inventarit (-)		0
21		3.Llogari te Arketushme	1,760,349,154	1,572,043,858
22	411	Kliente e llogari te ngjashme		
23	423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba		
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti		
27	435	Sigurime Shoqerore		
28	436	Sigurime Shendetore		
29	437,438,	Organizmat e tjere shtetore		
30	44	Institucionet e tjera publike		
31	465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
32	468	Debitoret e ndryshem	1,738,957,622	1,543,520,546
33	4342	Operacione me shtetin (Te drejta)	21,391,532	28,523,312
34	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
35	49	Shuma te parashikuara per zhvlersim(-)		
36		4.Te tjera active afatshkurtra	0	14,826,174
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime per t'u shperndare ne dis aushtrime		
41	486	Shpenzimet e periudhave te ardhshme		14,826,174
42		II.AktivtAfatgjata	1,148,801,065	1,324,978,737
43	20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	0	0
44	201	Prime te emisionit dheRimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kerkime	0	0
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
47	21	2.Aktive Afatgjatamateriale	1,138,801,066	1,308,065,664
48	210	Toka, Troje, Terene	15,786,107	15,786,107
49	211	Pyje, Plantacione	249,000	249,000
50	212	Ndertesa e Konstruksione	298,410,013	307,784,609
51	213	Rruge, rrjete, vepraujore	813,397,729	979,345,226
52	214	Iinstalime teknike, makineri e paisje	1,882,614	1,751,019
53	215	Mjete Transporti	7,478,833	457,500
54	216	Rezerva Shtetore		
55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventare konomik	1,596,769	2,692,203
57	24	Aktive afatgjata te demtuara		
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
59	25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	0	0
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
61	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet		
62		4.Investime	10,000,000	16,913,073
63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale	10,000,000	16,913,073

A. AKTIVE AFATSHKURTRA.

Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 231,056,893 lekë, të cilat rakordon me rubrikën VI “Teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” në Formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOË) sipas metodës direkte”

- **Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar”**, sipas bilancit në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 231,056,893 lekë, gjëndje të cilat rakordojnë me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit, ku lëvizjet e këtyre disponibiliteteve paraqiten në formatin nr.5 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2022”.

Në klasën 3 “Gjendja e inventarit qarkullues” të aktiveve qarkulluese paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 12,468,735 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 13,778,155 lekë, ku diferenca e tyre në vlerën prej 1,309,420 lekë rakordon me gjëndjen e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”. Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:

- **Gjendja e llogarisë 31 “Materiale”** paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,496,374 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 3,123,570 lekë, me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 627,196 lekë, e cila përfaqëson shtim të gjendjes së mallrave në magazinë në fund të vitit 2022.

- **Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imet ”** paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 9,972,361 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 10,654,585 lekë me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 682,224 lekë, e cila përfaqëson rritje të inventarit të imët për vitin 2022.

Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,572,043,858 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,738,957,622 lekë, ku kemi paksim, duke e krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat i kryerjes së pagesave ndaj kreditorëve të ndryshëm në lidhje me investimet dhe shërbimet e ndryshme.

Konkluzion: Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, ku në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,543,520,546 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 1,738,957,622 lekë, gjendje e cila në fakt sipas analizës është në vlerën 1,723,418,647 lekë, pasi në këtë vlerë është përfshirë në mënyrë të gabuar gjendja e llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 15,538,975 lekë në pasiv të bilancit, e cila duhej të ishte pjesë gjendjes llogarive kundërparti të saj në aktiv të bilancit si llog. 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” ose llog. 4342 “Të tjera operacione me Shtetin (të drejta)”.

Vlera e debitorëve në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 ka pësuar rritje prej 195,437,076 lekë. Në vlerën e lartë të gjendjes së llogarisë së debitorëve ka ndikuar dhe gjendja e debitorëve të taksave në vlerën 1,643,277,452 lekë, që zënë 95% të vlerës debitorë. Pjesa tjetër janë detyrimet e lindura nga rekomandimet “shpërblim dëmi” të lëna nga KLSH në vite, për të cilat nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve, duke kaluar afatet e kërkitimit. Analiza e gjendjes së llog. “Debitorë të ndryshëm” dhe lëvizjet e pësuar në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Gjendja e llogarise 468“Debitorë të ndryshëm” me date 31.12.2022

Nr .	Përshkrimidetyrimit	Gjendja 31.12.2021	Shtesa	Pakësuar	Gjendja 31.12.2022
1	Detyrime të krijuara para viteve 2004 dhe deri në vitet 2007 kryesisht për tarifa e taksa për leje ndertimi, gjoba për prokurimet, për qiramarrje, taksë reklame dhe moszbatim kontrate	11,499,597			11,499,597

2	Detyrime të krijuara në vitin 2008 për pagesa të pa drejta për paga, dieta, për shp. pritje përcjellje, mos ndalje tatimi, mos zbatim kontratash dhe diferenca të paarkëtuara në lidhje me lejet e ndertimit të dhëna.	4,931,395			4,931,395
3	Detyrime të krijuara në vitin 2009 për pagesa të pa drejta për paga, dieta, mos ndalje tatimi, mos zbatim kontratash dhe diferenca të paarkëtuara në lidhje me lejet e ndertimit të dhëna.	2,687,389			2,687,389
4	Detyrime të krijuara në vitin 2010-2011 për diferenca leje ndertimi, diferenca ne prokurime, moskryerje punimesh sipas kontratave, mos arkëtim taksash vendore	26,618,634			26,618,634
5	Detyrime të krijuara në vitin 2012-2014 për diferenca leje ndertimi, diferenca ne prokurime, moskryerje punimesh sipas kontratave, mos arkëtim taksash vendore	2,700,524			2,700,524
6	Detyrime të krijuara në vitin 2014-2015 për punime të pakryera dhe mospagesa për tarifa pastrimi	4,327,578			4,327,578
7	Detyrime të krijuara në vitin 2018-2020 për punime të pakryera dhe mospagesa për tarifa pastrimi	1,118,993		854,568	264,425
8	Detyrime të krijuara në vitin 2019-2022 për gjoba të IMTV	-			25,260,891
9	Detyrime të krijuara sipas Njësive Administrative	1,850,762	-	-	1,850,762
10	Detyrimet nga debitorë nga taksat dhe tarifat vendore	1,487,785,674	226,073,983	70,582,205	1,643,277,452
	T O T L I	1,543,520,546	226,073,983	71,436,773	1,723,418,647

Titulli i Gjetjes	Mbi kontabilizimet e gabuara në llog.468 “Debitorë të ndryshëm”
Situata	<p>Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, ku në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,543,520,546 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 1,738,957,622 lekë, gjendje e cila në fakt sipas analizës është në vlerën 1,723,418,647 lekë, pasi në këtë vlerë është përfshirë në mënyrë të gabuar sipas kërkesës së degës së Thesarit Lushnje gjendja e llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 15,538,975 lekë në pasiv të bilancit, e cila duhej” të ishte pjesë gjendjes llogarive kundërpanti të saj në aktiv të bilancit si llog. 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” ose llog. 4342 “Të tjera operacione me Shtetin (të drejta)”.</p> <p>Vlera e debitorëve në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 ka pësuar rritje prej 195,437,076 lekë. Në vlerën e lartë të gjendjes së llogarisë së debitorëve ka ndikuar dhe gjendja e debitorëve të taksave në vlerën 1,643,277,452 lekë, që zënë 95% te vlerës debitorë. Pjesa tjetër janë detyrimet e lindura nga rekomandimet “shpërblim dëmi” të lëna nga KLSH në vite, për të cilat nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve, duke kaluar afatet e kërimit.</p>
Kriteri	Udhëzimi i MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 42, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” pika 3.3 “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) nënpika 8 “Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin”.
Ndikimi/Efekti	Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk tregon gjendjen reale.
Shkaku	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka kontabilizuar gabim duke përfshirë në gjendjen e debitorëve dhe gjendjen e furnitorëve.
Rëndësia	E lartë

Rekomandim	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa që në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 të bëjë kontabilizimin e saktë të të drejtave të arkëtueshme nga të tretët në llog.468 “Debitorë të ndryshëm” dhe gjendjen e llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” të kontabilizojë në llogarinë kundërparti në aktiv të bilancit si llog. 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” ose llog. 4342 “Të tjera operacione me Shtetin (të drejta)”.
-------------------	--

- **Gjendja e llogarisë 4342** “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në shumën 21,391,532 lekë, e cila përfaqëson detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2022, që trashëgohen në vitin 2023. Kjo gjendje në analizë përfshin gjëndjet e llogarive në pasivin e bilancit: llog.42 “Furnitore e llogari të lidhura me to” në vlerën 3,789,574 leke, “Detyrime ndaj personelit” për vlerën 12,677,830 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 655,360 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 3,754,401 lekë, llog.436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 514,367 lekë .

Klasa 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” e cila përbëhet nga :

- **Gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”** në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 0 lekë, gjendje e cila përfaqëson shpenzimet e periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura” ndaj të tretëve ose të përfshihen në gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta) në aktiv të bilancit e cila përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara. Në fakt gjendja e kësaj llogarije duhet të ishte në vlerën 15,538,975 lekë si kundërparti e gjendjes së llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm” dhe në mënyrë të gabuar është përfshirë në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” sipas kërkesës së degës së Thesarit Lushnje. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 42, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” pika 3.3 “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) nënpika 8 “Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin”.

- **Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”** në aktiv të bilancit paraqitet e njëjtë si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 0 lekë, pasi këto aktive janë shpërndarë sipas aktiveve të kapitalizuar kuj i përkasin si vlerë e shtuar.

Në formatin nr. 2 (Aktiv i bilancit) “Aktivet afatgjata materiale” paraqiten me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,308,065,664 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 1,138,801,066 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 4,002,516,734 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 4,054,948,123 lekë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

- **Gjendja e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene”** paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 15,786,107 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 15,786,107 lekë pra nuk ka llogaritje të amortizimit. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 është në të njëjtën vlerë prej 15,786,107 lekë. Analiza e gjendjes së llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Inventari kontabël i llogarisë 210 "Toka Troje Terrene" me datë 31.12.2022

Nr	Emertimi	Sasia	Vlera fund 2022
1	Fushe volejbolli	1	1,000
2	Fushe volejbolli	1	500
3	Siperfaqe trualli te zyrat e ish shpim-kerkiimit (te Rajoni)	606	1,800,000
4	Siperfaqe trualli tek ish sheshi I naftes	6460	13,000,000
5	Terrene Lulishte	3700 m2	699,987
6	Terrene gjelberimi	2000 m2	284,620
Gjendja 31.12.2022			15,786,107

- **Gjendja e llogarisë 211 "Pyje, Plantacione"** paraqitet në vlerë neto si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 249,000 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 249,000 lekë. Analiza e gjendjes së llog. 211 "Pyje, Plantacione" paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emertimi	Sasia	Vlera fund 2022
1	Pyje,kullota,plantacione (Fiershegan)		249,000
Gjendja 31.12.2022			249,000

- **Gjendja e llogarisë 212 "Ndërtesa Konstruksione"** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 307,784,609 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 298,410,013 lekë, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 405,366,917 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 411,698,111 lekë. Gjatë vitit 2022 janë krijuar aktive shtesë në vlerën 6,331,194 lekë. Nga analiza e kësaj gjendje rezulton se janë pjesë e gjendjes aktivet e Ndërmarrjeve Komunale 1 dhe 2 në vlerën 11,450,836 lekë, aktive këto të cilat duhet ti kalojnë këtyre ndërmarrjeve. Analiza e gjendjes së kësaj llogarije dhe ndryshimet per vitin 2022 paraqiten në Aneks.

Nr.	EMËRTIMI	Ne fund te vitit 2021	Ne fund te vitit 2022	Nr.	EMËRTIMI	Ne fund te vitit 2021	Shtesa	Ne fund te vitit 2022	
I. Ndërmarrja Komunale I				VI Biblioteka					
1	Zyrat e Ndermarjes	111.089	111.089	1	Biblioteka	694.315		694.315	
2	Magazina	562.392	562.392	SHUMA		694.315		694.315	
3	Oficina	97.595	97.595	VII Muzeu historik					
4	Kendi I Kuq	77.040	77.040	1	Rikonst Muzeu historik	25.866.795		25.866.795	
5	Magazina e vogel	67.990	67.990	SHUMA		25.866.795		25.866.795	
6	Dyqan Qymyri	151.202	151.202	VIII Qendra Shend Karbunare					
7	Muri rrethues	428.773	428.773	1	Rikonst Q.Sh.Karbunare	1.930.296		1.930.296	
8	Zdrukthetaria	10.000	10.000	SHUMA		1.930.296		1.930.296	
SHUMA		1.506.081	1.506.081	IX Zyrat e gjendjes civile					
II. Ndërmarrja Komunale II				1	Rik i zyrate te Gj.Civile	1.980.600		1.980.600	
1	Zyrat kati pare	45.468	45.468	SHUMA		1.980.600		1.980.600	
2	Zyrat mbi vend strehim	140.000	140.000	X Shkollat+tjera...					
3	Magazina qender	40.000	40.000	1	Ristaur Ndertes "Kongresi i Lushnjes"	10.396.139		10.396.139	
4	Vend roje	5.022	5.022	Op.Tekn.Rikons.Shk Hysen Xheka" Lushnje		155.324		155.324	
5	Zdrukthetaria	5.364	5.364	Treg i gjese se gjall Bubull.(opon+sup+kola)		371.395		371.395	
6	Muri rrethues	200.000	200.000	SHUMA		10.922.858		10.922.858	
7	Reparti I pllakave	14.000	14.000	Op. Tekn. Tregu Fruta Perime			40.000	40.000	
8	Banjo te stacioni	45.000	45.000	Op.tekn.Rehabilit i Perroit Lushnje,Bash.. Lu			242.229	242.229	
9	Banjo te posta e vjeter	54.000	54.000	Oponen: Rik shkoll Sk. Libohova; shtese anesor			94.220	94.220	
10	Banjo te Konoteatri	1.328.992	1.328.992	Oponenc "Rehabil palestere shkolla Foto Puka"			51.561	51.561	
11	Vend roje te vorrezat e deshmoreve	10.000	10.000	Ekspetize thelluar Shkoll 9-vjecare Irakli Bozo			100.000	100.000	
12	Vend roje te vorrezat publike	2.000	2.000	Rehab e mirembaj infr Kujdesi shend Toshkez			1.137.665,00	1.137.665,00	
13	Ndertes e prodhimit qivureve	40.000	40.000	Rehabi e mirembaj infr Kujdesi shend Toshkez			2.654.551,00	2.654.551,00	
14	Vend strehimi (Te Komunalja)	8.014.909	8.014.909	Rehab e mirembaj infr Kujdesi shend Toshkez			1.891.656,02	1.891.656,02	
SHUMA		9.944.755	9.944.755	Mbikq:Rehab mirem infr Kujdes shend Toshk			119.312,00	119.312,00	
III. Bashkia				SHUMA 2022			6.331.194	6.331.194	

1	Godina e Bashkise	11.429.354	11.429.354		TOTALI I	147,431,771	6.331.194	153,762,965
1,1	Rikonstr.fasades godines Bashkise	2.548.104	2.548.104		Njesite Administrative			-
2	Ndertes e Bankes se Kursimeve	11.465.440	11.465.440	1	Allkaj	18,614,146		18,614,146
3	Ndertes 2 Kat.zyra e ish shpim-kerkim	15.936.067	15.936.067	2	Ballagat	12,778,390		12,778,390
4	Zyrat e ish sheshit naftes	15.936.067	-	3	Bubullime	9,617,233		9,617,233
a	Vendroja	24.000	24.000	4	Dushk	24,817,938		24,817,938
b	Menca	290.000	290.000	5	Fiershegan	40,210,645		40,210,645
c	Oficina	50.000	50.000	6	Golem	12,892,241		12,892,241
d	Reparti i ndihmës	3.700.000	3.700.000	7	Hysgjokaj	4,428,703		4,428,703
e	Godina 2 kat.e ish baze bujqes.	32.000.000	32.000.000	8	Karbunare	2,000,000		2,000,000
	SHUMA	77.442.965	77.442.965	9	Kolonje	43,099,738		43,099,738
IV.	Sport Klub Lushnja			10	Krutje	73,619,321		73,619,321
1	Pishina dhe dhomat e zhveshjes	239.000			TOTALI II	242,078,355		242,078,355
2	Rikon.i ambienteve te brend.te stadiumit	5.951.928						
	SHUMA	6.190.928			Zjarrfikeset	15,856,791		15,856,791
V	Kultura				TOTALI III	15,856,791		15,856,791
1	Kinoteatri	10.952.178						
	SHUMA	10.952.178			GJITHSEJ I+II+III	405,366,917	6.331.194	411,698,111

- **Gjendja e llogarisë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore"** paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 979,345,226 lekë dhenë mbyllje të vitit 2022 në 813,397,729 lekë, ku diferenca prej 165,947,497 lekë është amortizimi i llogaritur për vitin 2022. Ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 3,531,941,194 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 3,569,343,129 lekë. Gjatë vitit 2022 janë bërë shtesat me pagesë brenda sistemit në vlerën 37,401,935 lekë, që përfaqësojnë investime të kryera për rikunstuksion rrugësh qytetit dhe në fshatra. Analiza e gjendjes së llog. 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" paraqitet në Aneks.

- **Gjendja e llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"** në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,751,019 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,882,614 lekë, ku diferenca është amortizimi i perlllogaritur i vitit ushtrimor për këtë grupaktivesh. Ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 22,507,199 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 23,109,446 lekë për të cilat ka inventar fizik. Në këtë grupaktivesh ka shtesa për vitin 2022 në vlerën 4,162,835 lekë, pakësime në vlerën prej **645,108** lekë, e cila përbëhet nga nxjerrjet jashtë përdorimit të këtyre aktiveve të miratuar me VKB nr.46, datë 26.01.2023.

- **Gjendja e llogarisë 215 "Mjete Transporti"** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 457,500lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 7,478,833lekë, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 10,617,323lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 19,409,577lekë. Shtesat gjatë vitit 2022 përfaqësojnë dhurim i një mjeti zjarfikës pa pagesë nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në vlerën 9,417,354 lekë për nevojat e Bashkise. Ndërsa pakësimet janë në vlerën 625,100 lekë e cila përbëhet nga:

- Vlera prej 225,100 lekë (kosto historike) përfaqëson vlerën e zhdëmtuar të një mjeti nga operatori ekonomik "G. F." shpk fitues i sipërmarrjes së shërbimit të gjelbërimit në vitet e kaluara, i cili ka paguar shumën 112,550 lekë të përcaktuar nga komisioni i vlerësimit për vlerën e mbetur dhe urdhëruar për zhdëmtim në këtë vlerë me Urdhrin e Titullarit nr.290, datë 16.11.2022. Kjo vlerë zhdëmtimi paguar në R. Bank në datë 21.11.2022.

- Vlera prej 400,000 lekë që përfaqëson Autoveturën e transferuar në Ndërmarrjen e Pasurisë Publike. Analiza dhe lëvizjet e aktiveve në gjendjen e llogarisë 215 "Mjete Transporti" paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Inventari kontabël i llogarisë 215 "Mjete transporti "me datë 31.12.2022

	Mjetet e Bashkise.....	viti blerje	Gjendja në 31.12.2021	Shtesa	Pakësime	Gjendja në 31.12.2022
1	Autovetura 6567B	2003	1,490,000			1,490,000
2	Dungfung	2000	225,100		225,100	-

3	Motocikleta 446	2008	392,500			392,500
4	Motocikleta 447	2009	398,500			398,500
5	Autovetura AA029BG	2009	400,000		400,000	-
6	Autoveture DMAA384 EL	1970	400,000			400,000
7	Autoveture 7024	2000	1,388,000			1,388,000
8	Veture Renault e perd	2005	310,000			310,000
9	Veture Citroen e perd	2005	350,000			350,000
	Shuma		5,354,100		625,100	4,729,000
	Zjarrfikesja					-
1	Pol.08-66 Skoda RT IFE 2F		650,000			650,000
2	Pol.08-66 Denisa		840,000			840,000
3	LU 75-58 B Autobot/Scania		3,677,646			3,677,646
4	F955NRG Volvo		95,577			95,577
5	Zjarrfikesja e pjesa e sjelle nga AKMC				9,417,354	9,417,354
	Shuma Zjarrfikesja		5,263,223		9,417,354	-
	Gjithsej me 31.12.2022		10,617,323		9,417,354	625,100
						19,409,577

- **Gjendja e llogarisë 218 “Inventar Ekonomik”** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,692,203 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,596,770 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 15,048,994 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 15,352,753 lekë. Në këto gjendje përfshihet shtesa me pagesë në vlerën prej 4,162,835lekë. Pakësimet janë në vlerën 144,883 lekë, që përfaqësojnë aktivet e inventarit ekonomik të nxjerrë jashtë përdorimi për llogari të vitit 2022, sipas VKB nr.46, datë 26.01.2023.

- Gjendja e llog. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 10,000,000 lekë, e cila përfaqëson vlerën pjesore të paguar për investimin me objekt: “Sistemim-asfaltim i segmentit rrugor Taulla Sinani-Esma Dervishi”.

- **Gjendja e aktiveve afatgjata** në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet për vitin 2022 paraqiten në Formatin nr.7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” të PF si më poshtë:

Nr. Ref	EMERTIMI	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
		Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
Llog											
b	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
20	I. AAGJ/JO MATERIAL	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
202	Studime dhe kerkime	0		0		0		0	0	0	0
203	Konc.patent,lice ngjash			0					0	0	0
21	II. AAGJ/ MATERIALE	4,002,516,734	2,694,451,071	1,308,065,663	57,904,874	221,808,539	5,473,485	112,550	4,054,948,123	2,916,147,058	1,138,801,066
210	Toka,troje,Terene	15,786,107		15,786,107					15,786,107	0	15,786,107
211	Pyje,Kullota Plantacion	249,000		249,000					249,000	0	249,000
212	Ndertime e Konstruksio	405,366,917	97,582,308	307,784,609	6,331,194	15,705,790	0	0	411,698,111	113,288,098	298,410,013
213	Rruge,rrjete,vepra ujqore	3,531,941,194	2,552,595,968	979,345,226	37,401,935	203,349,432	0	0	3,569,343,129	2,755,945,400	813,397,729
214	Instal tekn,pajjes pun	22,507,199	20,756,180	1,751,019	4,754,391	470,654	4,152,144	0	23,109,446	21,226,832	1,882,614
215	Mjete transporti	10,617,323	10,159,823	457,500	9,417,354	1,883,471	625,100	112,550	19,409,577	11,930,744	7,478,833
216	Rezerva shtetore	0	0	0		0	0	0	0	0	0
217	Kafsh pun e prodhimi	0	0	0		0	0	0	0	0	0
218	Inventar ekonomik	16,048,994	13,356,791	2,692,203	0	399,192	696,241	0	15,352,753	13,755,984	1,596,770
24	Aktiv Qend.Trup demtu			0			0		0	0	0
28	Caktime			0					0	0	0
	TOTALI (I+II)	4,002,516,734	2,694,451,071	1,308,065,663	57,904,874	221,808,539	5,473,485	112,550	4,054,948,123	2,916,147,058	1,138,801,066

Amortizimi i AQ materiale dhe jo materiale paraqitet në bilanc në vlerën 2,916,147,058 lekë, e cila kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9.

Konkluzion: Nga verifikimi i përlllogaritjeve të amortizimit të AAGJ, rezulton se amortizimi është llogaritur për grup aktivesh ne total dhe jo aktiv për aktiv, duke mos përlllogaritur saktësisht amortizimin, pasi aktive të ndryshme kanë vlerë të ndryshme amortizimi të akumuluar sepse kanë kohë (vite) të ndryshme përdorimi. Në mungesë të regjistrit të aktiveve me të dhënat si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme, që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur për çdo aktiv u bë e pamundur sondazhi i përlllogaritjes së amortizimit për aktive të veçanta në llogari të ndryshme si dhe përlllogaritja e saktë e amortizimit të aktiveve për të bërë diferencën. Kështu në rastin e përlllogaritjes së aktiveve artikulli “kompjuter” është përlllogaritur gabim norma e amortizimit në masën 20% dhe jo 25% sic i takon këtij grupaktivesh. Kjo ka ndodhur se norma e amortizimit për grup aktivet e llog. 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” gjendje në të cilën bëjnë pjesë edhe kompjuterat është në masën 20% dhe përlllogaritja e amortizimit është bërë në grup dhe jo i vecuar për kompjuterat. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” pika 36.

Inventarizimi i aktiveve për vitin 2022 Bashkia Lushnje

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:

Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2022 për Bashkinë Lushnje dhe Njësite Administrative ne varesi.

Nga Titullari kanë dalë urdhrat nr.280-280/10 të datës 09.11.2022 për ngritjen e komisioneve të vecanta, ku secili përbëhej prej 5 vetësh për kryerjen e procesit të inventarizimit për vitin 2022 dhe vlerësimit të aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra në përdorim dhe në magazinë, në Bashki së bashku me rajonet, në zyrat e Gjendjes Civile, në Sektorin e PMNZH-së si dhe në 10 Njësitë Administrative Allkaj, Ballagat, Bubullime, Dushk, Fiershegan, Golem, Hysgjokaj, Karbunare, Kolonje dhe Krutje etj.

Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventareve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive si për Bashkinë Lushnje dhe për Njësinë Administrative ne varesi. Fletët e inventareve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda muajit dhjetor 2022 dhe rezultojnë pa diferenca. Është mbajtur relacion permbledhes të vlerësimit me nr.prot.752, datë 26.01.2023, “Mbi kryerjen e inventarizimit dhe gjendjen e aktiveve (vlerave materiale)”, ku sqarohen se të gjitha aktivet u kontrolluan në vendet e ndodhura si dhe janë verifikuar kushtet e ruajtjes dhe mirëmbajtjes së tyre. Komisionet e ngritura e inventarizimit kanë konstatuar dhe listuar aktivet që nuk janë në gjëndje të mirë fizike dhe kanë vlerësuar e argumentuar teknikisht se ato nuk kryejnë funksionin e caktuar pasi janë të konumuar, si dhe riparimi i tyre është i pamundur, duke i vlerësuar për nxjerrje jashtë përdorimi. Me secilin person materialisht përgjegjes sipas drejtorive dhe njërive që kishin në përdorim këto vlera është hartuar proces-verbal i veçantë nga komisionet të konfirmuar nga anëtarët e komisionit dhe personat përgjegjës,ku dhe janë përshkruar gjëndjet e e aktiveve që kanë humbur vlerën e përdorimit.

Me VKB nr. 46, date 26.01.2023 është bërë miratimi i vlerës se aktiveve të vlerësuara për jashtë përdorimit në shumën 839,009.20 lekë, të përbërë nga:

- Llog.327 “Objekte inventari” në vlerën 49,018 lekë

- Llog.214 “Instalime teknike, makineri, pajisje” në vlerën 645,108.20 lekë

- Llog.218 “Inventar Ekonomik” në vlerën 144,883 lekë.

Me urdhrin e titullarit nr. 68, datë 24.02.2023 “Per ngritjen e komisionit per dhenien ne perdorim/tjetersimin e aktiveve dhe/ose nxjerrjen jashte perdorimit te aktiveve” është ngritur komisioni nga 5 persona për azgjesimin e këtyre aktiveve. Komisioni ka mbajtur relacionin përkaës të bashkëlidhur me dokumentacionin shoqërues që fakton realizimin e këtij procesi.

Konkluzion: Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) për vitin 2022 në vlerën **4,054,948,123** lekë, në të cilën janë përfshirë shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktiv. Në **inventarët kontabël të aktiveve materiale** gjendje në fund të vitit 2022 në llogaritë: **210 “Toka, Troje, Terrene”** është në vlerën 15,786,107 lekë; **211 “Pyje, Plantacione”** në vlerën 249,000 lekë, **212 “Ndërtesa Konstruksione”** në vlerën 411,698,111 lekë; **213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”** në vlerën 3,569,343,129 lekë; **214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”** në vlerën 23,109,446 leke janë azhornuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit, sipas amërtesave të projekteve të investimeve, pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale per çdo aktiv. Për këto aktive nuk është kryer inventar fizik për të verifikuar statusin e tyre, nëse ekzistojnë apo jo dhe marrjen e masave për ndjekjen e procedurave ligjore për sistemimin e tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III, Seksioni 3.1 “Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, **pika 31** e cila përcakton: **30. Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementëve të tjerë, konform kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabile për llogari të vitit kontabël që mbyllet**, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2, Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël).

Për vitin 2022 nga auditimi i procedurës së mbajtjes dhe kontabilizimit të aktiveve rezultoi se çdo aktiv ishte i regjistruar dhe i kontabilizuar sipas dispozitave ligjore, por mungon kartela kontabël për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur, pra në formë analitike në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 30.

Titulli i Gjetjes	Mbi pasaktësinë e rregjistrimit të AAGJM dhe jo materiale, moskryerjen e inventarit fizik për një pjesë të tyre si dhe pasaktësinë e perlllogaritjes së amortizimit për to.
Situata	Nga verifikimi i përlllogaritjeve të amortizimit të AAGJ, rezulton se amortizimi është llogaritur për grup aktivesh ne total dhe jo aktiv për aktiv, duke mos përlllogaritur saktësisht amortizimin, pasi aktive të ndryshme kanë vlerë të ndryshme amortizimi të akumuluar sepse kanë kohë (vite) të ndryshme përdorimi. Në mungesë të rregjistrimit të aktiveve me të dhënat u bë e pamundur sondazhi i përlllogaritjes së amortizimit për aktive të veçanta në llogari të ndryshme si dhe përlllogaritja e saktë e amortizimit të aktiveve për të bërë diferencën. Kështu në rastin e përlllogaritjes së aktiveve artikulli “kompjuter” është përlllogaritur gabim norma e amortizimit në masën 20% dhe jo 25% sic i takon këtij grupaktivesh. Kjo ka ndodhur se norma e

	amortizimit për grup aktivet e llog. 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” gjendje në të cilën bëjnë pjesë edhe kompjuterat është në masën 20% dhe përlllogaritja e amortizimit është bërë në grup dhe jo i vecuar për kompjuterat. Në inventarët kontabël të aktiveve materiale gjendje në fund të vitit 2022 në llogaritë: 210 “Toka, Troje, Terrene” është në vlerën 15,786,107 lekë; 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 249,000 lekë, 212 “Ndërtesa Konstruksione” në vlerën 411,698,111 lekë; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 3,569,343,129 lekë; 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 23,109,446 lekë, janë azhornuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit, sipas emërtesave të projekteve të investimeve, pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv. Për këto aktive nuk është kryer inventar fizik për të verifikuar statusin e tyre, nëse ekzistojnë apo jo dhe marrjen e masave për ndjekjen e procedurave ligjore për sistemimin e tyre.
Kriteri	UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85 . Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e informacionit të plotë për AAGJM në lidhje me vlerën fillestare shitesat, pakësimet, amortizimin e akumuluar dhe vlera e mbetur (neto) aktiv për aktiv me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në sigurinë e arsyeshme dhe besueshmërinë e evidencës kontabël për përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.
Shkaku	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk janë marrë masat e nevojshme për mbajtjen e regjistrit historik të AAGJM, kryerjen e procedurave të plota të inventarizimit si dhe llogaritjen e amortizimit aktiv për aktiv mbi bazë historiku të krijimit të tij.
Rëndësia	E lartë
Rekomandim	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa të hartojë një regjistër të plotë historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vend-ndodhjen, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Mbi bazën e tij të llogarisë amortizimin aktiv për aktiv si dhe të realizojë inventar fizik për të gjithë AAGJ, për verifikim e tyre dhe ekzistencës fizike.

Analiza e Llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël:

në lekë

Nr. Reshti	Nr Rubrike	PERMBAJTJA	Periudha Raportuse 2022	Periudha Paraardhese 2021
65	B	PASIVET(DETYRIMET)	1,782,678,077	1,618,808,544
66		I.PasivetAfatshkurtra	1,782,678,077	1,618,808,544
67		1. LlogaritePagushme	1,782,678,077	1,618,808,544
68	401-408	Furnitore e llogaritelidhura me to	3,789,574	10,531,213
69	42	Detyrimendajpersonelit	12,677,830	12,791,511
70	16,17,18	Hua Afatshkurtra		

71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrimendajshtetit per tatimtaksa	655,360	846,252
73	432	Tatime, mbledhur per llogaripushtetitlokal		
74	433	Detyrime, shtetifatkëqesinatyrore		
75	435	SigurimeShoqerore	3,754,401	3,830,076
76	436	SigurimeShendetsore	514,367	524,260
77	437,438,	Organizmatetjereshteterore		
78	44	Institucionetjerpulike		
79	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesiveekonomike		
80	464	Det.pertupaguar per bl.letrave me vlere		
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	22,328,923	31,938,511
82	467	Kreditoretendryshem	15,538,975	14,826,175
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime)	1,723,418,647	1,543,520,546
84	49	Shuma te parashikuara per zhvleresim(-)		
85		2.Te tjerapasiveafatshkurtra	0	0
86	419	Kreditore, Parapagime		
87	475	Teardhura per t'uregjistruarvitetpasardhese		
88	478	Diferencakontvertimipasive		
89	480	Teardhura per tuklasifikuaroserregulluar		
90	487	Teardhuratearketuara para nxjerrjes se titullit		
91		II.PasivetAfat Gjata	0	0
92	Klase 4	Llogaritepagushme		
93	16.17,18	HuateAfatgjata		
94		Provizjonetafatgjata		
95	Klasa 4	Tetjera		
96	C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	1,371,307,190	1,470,963,230
97	D	FONDI I KONSOLIDUAR :	1,371,307,189	1,470,963,230
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	1,152,579,220	1,320,534,399
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati I VeprimtariseUshtrimore	208,727,970	133,515,759
101	111	Rezerva		
102	115	Nga Fondet e vetateinvestimeve	10,000,000	16,913,073
	15	Shuma te parashikuara per rreziqe e Zhvleresime		
103	105	Teprica e GrantevekapitaleTeBrendshme		
104	106	Teprica e GrantevekapitaleTeHuaja		
105	107	Vlera e mjeetevetecaktuara ne perdorim	0	0
106	109	RezervangaRivlersimi I AktiveveAfatgjata		
107		TeTjera		
108	E	TOTALI I PASIVEVE (B+C)	3,153,985,266	3,089,771,774

Pasivet afatshkurtra. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 3,153,985,266 lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

- **Gjendja e llogarisë 401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”** përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara. Gjendja e kësaj llogarije në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 10,531,213 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 3,789,574lekë, vlerë e cila ka ardhur në ulje.Sipas analizës së gjëndjes së kësaj llogarie rezultojnë borxh i krijuar në dhjetor të vitit 2022, ku në mënyrë të detajuar paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Analiza e llogarisë 401-404“Furnitorë e llogari të lidhura me to”

Emertimi	Datat e faturave	Shuma (llog 602)
A.Sh.a	04.01. 23(dhjetor22)	79,099
Furnizuesi I Sherbimit Universal	28.12.2022	12,801
Furnizuesi i Sherbimit Universal	23.12.2022	340
Furnizuesi I Sherbimit Universal	31.12.2022	233,956
POSTA SHQIPTARE SHA	9.01.2023	326,790
G. CENTER GKG SHPK2023	9.01.2023	59,700
G. CENTER GKG SHPK2023	9.01.2023	274,620
POSTA SHQIPTARE SHA	9.01.2023	1,155,619
T.-BR shpk	31.12.2023	399,999.07

Shperblimet e Keshilli bashkiak	Pagesa Dhjetor	585,000
Shperblimet e Kryetareve të fshatrave	Pagesa Dhjetor	579,650
Qera mosha III	Dhjetor	82,000
SHUMA		3,789,574

- **Gjendja e llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit”** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën 12,677,830 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor për pagat që do të paguhen në Janar të vitit 2023.

- **Gjendja e llogarisë 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën kontabël 655,360 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2022 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2023.

- **Gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore”** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën 3,754,401 lekë, të llogaritura për tu paguar në muajin pasardhës e analizuar si vijon.

- **Gjendja e llogarisë 436 “Sigurime shëndetësore”** në fund të vitit 2022 është në vlerën kontabël 514,367 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”** paraqitet si në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,723,418,647 lekë, vlera të cilat rakordojnë me gjendjet e llogarisë kundërpartit 468 “Debitorë të ndryshëm” në aktiv të bilancit.

- **Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”** përfshin garancitë e ngurtësuarra për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarije paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 22,328,923 lekë. Për këtë gjendje të llog 466 është bërë rakordimi në degën e Thesarit Lushnje, ku në mënyrë analitike paraqitet në Aneks.

- **Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”** përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara, për shkak të vonesave të krijuara në kryerjen e procedurave të prokurimit, në lidhjen e kontratave apo në mbërritjen me vonesë të faturave dhe si rezultat i bllokimit të transaksioneve financiare nga MFE në ditët e fundit të dhjetorit të vitit ushtrimor. Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 14,826,175 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 15,537,975 lekë me një diferencë në rritje prej 712,800 lekë në krahasim me vitin 2021, vlerë kjo e një fature. Këto detyrime janë kryesisht detyrimet të cilat kanë mangësi në dokumentacion të trashëguara dhe nga ish komunat. Analiza e kësaj llogarije paraqitet në Aneks:

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2022, të cilat në total janë në vlerën 1,454,696,864 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Lushnje paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike 70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet” paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën **284,089,304** lekë, i cili kuadron me Aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë analitike **7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 782,823 lekë e cila përfshin taksën mbi Biznesin e vogël, e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

b. Gjendja e llogarisë **7020 “Tatim mbi pasurinë e palujtshme”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 114,493,772 lekë e cila përfshin taksën mbi ndërtesën dhe truallin, e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

c. Gjendja e llogarisë **7035 “Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 64,429,744 lekë e cila përfshin taksa e pastrimit, gjelbërimit, ndricimit, zënie hapësire publike, qirate për truallin, etj.

- Gjendja e llogarisë **71 “Të ardhurat jo tatimore”** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 124,211,369 lekë, i cila kuadron me Aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë **7109 “Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndermarrjet dhe pronesia”** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 9,730,417 lekë, e cila përfshin taksën e ndikimit në infrastrukturë, taksën e tokës, qiratë nga kullotat dhe nga pyjet i cili kuadron me Aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

b. Gjendja e llogarisë **711 “Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare”** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 114,480,952 lekë, e cila përfshin tarifën e parkimit, kamatvonesa, tarifa transporti, licenca etj. Kjo vlerë me Aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”** është në vlerën prej 21,391,532 lekë.

Analiza e shpenzimeve në vitin 2022, të cilat në total janë në vlerën 1,245,968,894 lekë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë **600 ‘Paga, shpërblime e të tjera personeli’** për vitin 2022, paraqitet në bilanc në vlerën 188,715,814 lekë dhe sipas aktrakordimit me thesarin është në vlerën 230,555,705 lekë diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë **601 ‘Kontribute për sigurime’** për vitin 2022, paraqitet në bilanc në vlerën 38,327,711 lekë dhe sipas aktrakordimit me thesarin është në vlerën 30,592,526 lekë, diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë **602 “Blerje mallra e shërbime”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 132,356,204 lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është në vlerën 96,966,309 lekë, diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime korente te brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 17,185,890 lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është në vlerën 17,230,403 lekë, diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime per Buxhetet familjare e Individe”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 640,484,930 lekë, e cila rakordon me aktrakordimin me Thesarin.

Per vitin 2022 totali i të ardhurave në vlerë është 1,454,696,864 lekë dhe totali shpenzimeve është 1,245,968,894 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 208,727,970 rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”.

Gjithashtu gjendja e llogarisë **63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”** është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2022 është në vlerën - 1,309,420 lekë .

Analizë e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare” të PF të vitit 2022 paraqitet në Aneks.

Formati nr.6 “Investimet dhe burimet e financimit”

- Zeri "Burimet për investime" Formatin 6, i plotësuar për shumën 22,071,904 lekë në analizë tregon burimet e investimit, vlera prej 19,567,624 lekë fonde të akorduara për investime, vlera prej 9,417,354 lekë investime të dhuruara nga donatore vendas.

- Zëri “Shpenzime për Aktive Afatgjata materiale” formati 6 e plotësuar për shumën 128,972,030 lekë në analizë rakordon me pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata” kolona 4 formati 7/b.

Nga testi kontrollit për vitet 2022 në lidhje me veprimet me arkë dhe me bankë:

Rregullariteti i veprimeve me arkë nga ku rezultoi se:

Veprimet me arkë kryhen vetëm për rastet e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore në njësinë administrative dhe pagesat e kopshteve dhe çerdheve. Gjendja e arkës nuk e kalon limitet e arkës. Për të gjitha arkëtimet ditore bëheshin derdhjet në bankë në llogarinë likuiduese të institucionit. Nga auditimi u konstatua se dokumentet ishin plotësuar konform nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe kreut III pika 34 dhe 35 geramat a, b dhe c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3 të ligjit nr.290, datë 14.06.1993 “Për limitin e arkës”.

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

➤ Pagesat e kryera jashtë afatit 30 ditë të paraqitjes së faturës.

Konkluzion: Nga testet e transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi se janë kryer pagesa në vitin 2022 me urdhër-shpenzime në 33 raste faturash me vlerë 41,109,901.55 lekë, mbi afatin 30 ditë të faturave për shpenzime mallra e shërbime/ investime të mbërritura në Bashkinë Lushnje, ku në pjesën më të madhe të rasteve janë krijuar nga vetë institucioni për mbërritje me vonesë e faturave apo realizim me vonesë i punimeve. Likuidimi me vonesë i faturave në tejkallim të afatit ligjor prej 30 ditësh është në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52⁹, me ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 44 “Kontrolli i shpenzimeve”. Rastet më konkretisht paraqiten në tabelat e Aneksit.

⁹në të cilën përcaktohet se: “Nëpunësit zbatues të njësisë shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik.”

Titulli i Gjetjes	Mbi pagesat nëpërmjet bankës mbi afatin 30 ditor të faturave të mbërritura
Situata	Nga testet e transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi se janë kryer pagesa në vitin 2022 me urdhër-shpenzime në 33 raste faturash me vlerë 41,109,902 lekë, <u>mbi afatin 30 ditor të faturave</u> për shpenzime mallra e shërbime/ investime të mbërritura në Bashkinë Lushnje, ku në pjesën më të madhe të rasteve janë krijuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mbërritje me vonesë të faturave.
Kriteri	Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52, me ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 44 “Kontrolli i shpenzimeve”.
Ndikimi/Efekti	Mos likuidim në kohë i shpenzimeve sjell akumulim të borxhit të institucionit për fatura të pa likuiduara.
Shkaku	Likuidim me vonesë i faturave në tejkallim të afatit ligjor prej 30 ditor i pjesës më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh.
Rëndësia	I mesëm
Rekomandim	Bashkia Lushnje të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (<i>përfundimtar kufizimet e MFE</i>), për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim mos krijim borxhi për fatura të pa likuiduara dhe krijimin e vështirësisë në aftësinë paguese.

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi znj. J. H. me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe të hartuesit të pasqyrave financiare

3.4.Auditim mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe rregjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Për auditimin e pikës 3 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Inventarët e aseteve të kaluara me VKM Bashkisë dhe ish-Komunave sot NJA nga Pushteti Qendror.
2. Kontratat e lidhura me subjekte fizik/juridik, të administruara nga Bashkia për dhënien me qira të aseteve pronë ose në përdorim të Bashkisë, si dhe dabaza me të dhënat e tyre.
3. Pagesat e kryera për vitin 2022 për detyrimet kontraktore nga qiradhënësit.
4. Listat e aseteve të kaluara në pronësi të bashkisë së bashku me certifikata e hipotekore si dhe lista e aseteve për të cilat janë përgatitur dokumentet tekniko-ligjore të depozituar në ASHK për paisjen e Bashkisë me certifikatë hipotekore pronësie për këto asete.

- Asetet e kaluara nga pushteti qendror pranë Bashkisë Lushnje paraqiten sipas VKM-ve
Në Bashkinë Lushnje (Bashkia Qendër) është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Lushnje, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet VKM Nr.175, date 06.03.2012 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Lushnje, të Qarkut të Fierit”, e ndryshuar me:

- VKM Nr. 639, datë 01.10.2014” Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Shëndetësisë te Bashkia Lushnje, të një pjese të godinës Nr. 4(ish-Reparti Infektiv), pranë Spitalit “ Ihsan

Cabej”, Lushnje, Bashkisë Lushnje i ka kaluar në pronësi 500 m² në Zonën Kadastrale 8571, për rikonstruksionin dhe ngritjen e Qendrës Ditore për Njëzëzit me Aftësi të Kufizuara.

- VKM Nr. 815, datë 26.11.2014, në bazë të së cilës është bërë ndryshimi i destinacionit të sipërfaqes 1 300 (një mijë e treqind) m², truall, pjesë e pronës me numër rendor 175 e me numër pasurie 13/4.
- VKM Nr. 422 datë 13.5.2015, në bazë të së cilës janë shtuar pronat me nr. Rendor 4271 dhe nr. 4272, gjithsej 2 (dy) prona).
- VKM Nr. 372 datë 06.05.2020, në bazë të së cilës është bërë ndryshimi për një shtesë të VKM Nr.175 date 06.03.2012 në të cilën është shtuar prona me Nr. Pasurie 4,fleta 56, e llojit Arë, me sipërfaqe 43 915 m² Zona Kadastrale 8572 ,shtesë e cila kalon ne pronësi të Bashkisë Lushnje ,për t’u përdorur për zgjerimin e tregut të fruta perimeve.

Lista e Inventarit përfundon me numrin rendor 4 272 (katër mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy).

- Në **Njësinë Administrative Dushk** është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim të Komunës Dushk, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet VKM Nr.257, datë 12.3.2009 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Dushk, të Qarkut të Fierit”. Lista e inventarit përfundon me numrin rendor 164 (njëqind e gjashtëdhjetë e katër).

- Në **Njësinë Administrative Allkaj** është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim të Komunës Allkaj, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet VKM Nr. Nr. 855, datë 4.12.2012 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Allkaj, të Qarkut të Fierit”. Lista e inventarit përfundon me numrin rendor 227 (dyqind e njëzet e shtatë).

- Në **Njësinë Administrative Bubullimë** është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim të Komunës Bubullimë, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet VKM Nr. 734, datë 01.07.2009 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bubullimë, të Qarkut të Fierit”. Lista e inventarit përfundon me numrin rendor 237 (dyqind e tridhjetë e shtatë).

- Në **Njësinë Administrative Ballagat** është miratuar lista në fazën paraprake e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet VKM Nr.333, date 21.5.2004 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Ballagat”. Lista e inventarit përfundon me numrin rendor 102 (njëqind e dy).

- Në **Njësinë Administrative Fiershegan** është miratuar lista në fazën paraprake e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet **VKM Nr .330**, date 21.5.2004 “ Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Fiershegan”, e ndryshuar me **VKM Nr.458**, datë 26.07.2018”Për transferimin në pronësi të bashkive të pronave të paluajtshme shtetërore, qe përdoren për kryerjen e veprimtarive sportive

- a) Prona Nr. Rendor 2,Zk Indeks Harte 106-A,Pasuria Nr. 289/1 emertimi Fushë Sporti,fshati Fier Shegan me siperfaqe trualli 6412 m².
- b) Prona Nr. Rendor 1,Zk Indeks Harte 89-D,Pasuria Nr. 240/6 emertimi Fushë Sporti,fshati Fier Barbullinjë me siperfaqe trualli 7260 m².

Lista e inventarit përfundon me numrin rendor 184 (njëqind e tetëdhjetë e katër).

- Në **Njësinë Administrative Golem** është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim të Komunës Golem, sipas

lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet VKM Nr.818, datë 29.11.2007 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Golem, të Qarkut të Fierit” e ndryshuar me VKM Nr.731, datë 1.7.2009 (në bazë të së cilës nga prona nr.rendor 243, sipërfaqja 1018 (një mijë e tetëmbëdhjetë) m² t’i kalojë në pronësi ish- komunës Golem të qarkut të Fierit, si truall dhe sipërfaqe funksionale e ndërtesës, ku ushtron veprimtarinë administrative). Lista e inventarit përfundon me numrin rendor 256 (dyqind e pesëdhjetë e gjashtë).

- Në **Njësinë Administrative Hysgjokaj** është miratuar lista në fazën paraprake e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim të Komunës Hysgjokaj, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet VKM Nr. **573, datë 23.8.2006** “Për Miratimin e Listës Paraprake të Pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Hysgjokaj, të Qarkut të Fierit”. Lista e inventarit përfundon me numrin rendor 129 (njëqind e njezet e nentë).

- Në **Njësinë Administrative Karbunarë** është miratuar lista paraprake e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim të Komunës Karbunarë, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet VKM Nr. **Nr.416, datë 8.6.2011**“Për Miratimin e Listës Paraprake të Pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Karbunarë, të Qarkut të Fierit”. Lista e inventarit përfundon me numrin rendor 146 (njëqind e dyzet e gjashtë).

- Në **Njësinë Administrative Krutje** është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim të Komunës Bubullimë, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet VKM **Nr.9, datë 4.1.2012** “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Krutje, të Qarkut të Fierit”. Lista e inventarit përfundon me numrin rendor 317 (treqind e shtatëmbëdhjetë).

- Në **Njësinë Administrative Kolonjë** është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim të Komunës Kolonjë, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet VKM **Nr.947, datë 2.9.2009** “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Kolonjë, të Qarkut të Fierit”, e ndryshuar me VKM Nr. 84, datë 30.01.2013, në bazë të së cilës në listën e pronave që i bashkëlidhen VKM Nr. 947, datë 02.09.2009 shtohen pronat me numrat rendorë 319-373 (treqind e nëntëmbëdhjetë deri në treqind e shtatëdhjetë e tre), sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet VKM Nr. 84, datë 30.01.2013). Lista e inventarit përfundon me numrin rendor 373 (treqind e shtatëdhjetë e tre).

- **Pyjet dhe Kullotat**, në bazë të **VKM nr. 433 datë 8.6.2016** “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive”, sipërfaqet pyjore dhe kullosore, sipas listës së inventarit, që transferohen në pronësi të Bashkisë Lushnje janë sipas shtojcës nr. 23, e cila përmban listën e inventarit që fillon me nr. rendor 1 (një) deri 55 (pesëdhjetë e pesë).

- *Asetet e rregjistruara si pronë e Bashkisë pranë ASHK-Drejtoria Vendore Lushnje*

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se janë rregjistruar 58 prona , të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme:

NR.	Emërtimi I pronës	NR.	Emërtimi I pronës
1	13/4 ish-zyrat e Ndërmarrjes së Rrugeve dhe Transportit (Ndërmarrja e Pasurise Publike sot), ne lagjen “Gafurr Muco”.	30	169/50, Karrierë Allprenaj

2	13/7 trotuari te ish-zyrat e Ndërmarrjes së Rrugëve dhe Transportit	31	169/12, Karrierë Allprenaj
3	16/51-3 Qendra kulturore e femijeve lagja " Kongresi"	32	169/44, Karrierë Allprenaj
4	11/95 Shkolla 4-Dëshmorët lagja " Kadri Qystri"	33	169/9, Karrierë Allprenaj
5	14/150 Agro Treg.(Ish Baza e Bujqësisë) lagja " Gafurr Muco".	34	169/7, Karrierë Allprenaj
6	18/17 Muzeu Historik, lagja " Kongresi"	35	169/45, Karrierë Allprenaj
7	24/160- Qendrës Ditore për Njëzëzit me Aftësi të Kufizuara.	36	169/8, Karrierë Allprenaj
8	276/1- Qendra Shendetesore,fshati Shegas	37	115/1, Pyll Mazhaj
9	334/53-Tregu Bubullime	38	169/52, Karrierë Allprenaj
10	18/1, ZK. 8572, lagjia 18 Tetori, Tregu fruta perime	39	475, Pyll Ardenicë
11	18/2- Shtesë të Tregut Fruta Perime	40	146/9, Pyll Kolonjë
12	25/123-Godinë Zjarrfikësja lagjia Xhevdet Nepravishta	41	436, ZK. 8571, Lagjia "Kadri Qystri", Varrezat e Qytetit
13	16/51-10,Godina e Bashkise,Kati perdhe	42	2/73, Truall lagjia Loni Dhamo
14	16/51-11, Godina e Bashkise,Kati pare	43	14/56, Truall, lagjia Gafurr Muco
15	16/51-12, Godina e Bashkise,Kati dyte.	44	14/57, Truall, lagjia Gafurr Muco
16	309/49, Qendra Shendëtesore, Lifaj I Vjetër	45	2/37, Truall+ndërtesë, Kopësht, fshati Dushk I Madh
17	Arshiva Rajonale, ZK. 8571, lagjia Kongresi Lushnjes,	46	2/41 Zona, truall+ ndërtesë, Terren Sport Fush Sporti, fsh Dushk i Madh
18	4/59, Shkolla 8-VJECARE Kongresi Lushnjes	47	2/83, truall+ ndërtesë, Shkolla e Vjetër, Arsim Parauniversi fshDushk i Madh
19	5/114 Ndertesa 3-Kate,Zyrat e Ujesjellesit Lushnje	48	2/34, truall+ ndërtesë,i Çerdhe fshati Dushk i Madh
20	167/53, Qendra shendetesore Toshkez	49	3/81, Truall+ Ndërtesë, Qender Shendets, Paresor fsh Dushk i Madh
21	3/216, Qendra Shendetesore fshati Plug	50	1/17, truall+ ndërtesë , Maternitet, Sherb Spitalor, fsh Dushk i Madh
22	505/3,Are Dushk Peqin	51	2/49, t truall+ ndërtesë, Vendstrehim fshati Dushk i Madh
23	505/2, Are Dushk Peqin	52	1/500, truall + ndërtesë ,Vendstrehim, fshati Dushk i Madh
24	505/1, Are Dushk Peqin	53	276/1, Truall+ Ndërtesë, Ambulanca, fshati Shegas
25	506/1, Are Dushk Peqin	54	101/2, truall+ ndërtesë, Rezervat e Shtetit lagja " Kadri Qystri"
26	505/4, Are Dushk Peqin	55	2/14, truall+ ndërtesë, Qendra Shendetesore fshati Kolonjë;
27	505/6, Are Dushk Peqin	56	158/94, truall, Fushe Sporti, fshati Gorre
28	18/4, Shesh, lagjia Kongresi Lushnjes	57	3/57, truall+ ndërtesë,i Ish-Filiali i Bankes Kursimeve, fsh Kolonjë
29	30/10, Truall Bishqethëm	58	2/126, Truall, Zyrat e Komunës Kolonjë

Lista e pasurive, për të cilat janë përgatitur dokumentet tekniko-ligjore dhe janë bërë kërkesë për rregjistrim pranë ASHK-Drejtoria Vendore, që janë në proces për nxjerrjen e certifikatës së pronësisë, të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme:

NR.	Emërtimi I pasurisë	NR.	Emërtimi I pasurisë
1	pasurisë nr. 4/26, ZK. 8571, e llojit truall, lagjia "Çlirimi".	28	pasurisë 309, ZK. 1813, fshati Gorre, Nj. Adm. Kolonjë.
2	pasurisë nr. 9/80, ZK. 8572, e llojit truall+ndërtesë, lagjia "Skënder Libohova".	29	pasurisë 305, ZK. 1813, fshati Gorre, Nj. Adm. Kolonjë.
3	pasurisë nr. 9/93, ZK. 8571, e llojit truall_ ndërtesë, lagjia "Skënder Libohova".	30	pasurisë 305/1, ZK. 1813, fshati Gorre, Nj. Adm. Kolonjë.
4	pasurisë nr. 11/15, ZK. 8571, e llojit truall, lagjia "Kadri Qystri".	31	pasurisë 313, ZK. 1813, fshati Gorre, Nj. Adm. Kolonjë.
5	pasurisë nr. 16/5, ZK. 8571, e llojit truall + ndërtesë, lagjia "Kongresi Lushnjes".	32	pasurisë 310, ZK. 1813, fshati Gorre, Nj. Adm. Kolonjë.
6	pasurisë nr. 16/51-10, ZK. 8571, lagjia "Kongresi Lushnjes".	33	pasurisë 314, ZK. 1813, fshati Gorre, Nj. Adm. Kolonjë.
7	pasurisë nr. 9/160, ZK. 8572, lagjia "Skënder Libohova"	34	pasurisë 312, ZK. 1813, fshati Gorre, Nj. Adm. Kolonjë.
8	pasurisë nr. 22/146, ZK. 8572, e llojit truall+ndërtesë, lagjia "18 Tetori".	35	pasurisë nr. 312/1, ZK. 1813, fshati Gorre, Nj. Adm. Kolonjë.
9	pasurisë nr. 23, ZK. 1428, fshati Çukas i Ri, Njësia Administrative Allkaj.	36	pasurisë nr. 191/2, ZK. 2966, fshati Pirrë, Nj. Adm. Bubullimë
10	pasurisë nr. 19/1, truall i ndërtesës së zyrave te ish-Komun Golem, lagj "Çlirimi".	37	pasurisë nr. 330/54, ZK. 1295, fshat Bubullimë, Nj.A. Bubullimë
11	pasurisë nr. 12/57, ZK. 8571, lagjia "Kadri Qystri".	38	pasurisë nr. 12/7, ZK. 3508,fsh Stan Karbunarë, Nj.A. Karbunarë
12	pasurisë nr. 12/55, ZK. 8571, lagjia "Kadri Qystri".	39	pasurisë nr. 75/32, ZK. 2207, fshati Kolonjë, Nj. Adm. Kolonjë
13	pasurisë nr. 12/56, ZK. 8571, lagjia "Kadri Qystri".	40	pasurisë nr. 403/18, ZK. 2342, fshati Kurtinë, Nj.A. Hysgjokaj
14	pasurisë nr. 12/58, ZK. 8571, lagjia "Kadri Qystri".	41	pasurisë nr. 319/5, ZK. 3325, fshati Shegas, Nj. Adm. Golem
15	pasurisë nr. 12/59, ZK. 8571, lagjia "Kadri Qystri".	42	pasurisë nr. 43/7, ZK. 1789, fshati Golem I Madh, Nj.A. Golem
16	pasurisë nr. 12/60, ZK. 8571, lagjia "Kadri Qystri".	43	pasurisë nr. 88/4, ZK. 1918, fsh. Hajdaraj, Nj. Adm. Golem
17	pasurisë nr. 12/83, ZK. 8571, lagjia "Kadri Qystri".	44	pasurisë nr. 337/1, ZK. 3325, fshati Shegas, Nj. Adm. Golem
18	pasurisë nr. 18/30 me emërtim Ish kopësht, lagjia Kongresi i Lushnjes	45	pasurisë nr. 294/1/1, ZK. 2287, fsh Krutje e Spërme, Nja Krutje
19	pasurisë nr. 469/7,Shkolla e Mesme Përgjithsme Krutje, NJA Krutje.	46	pasurisë nr. 43/90, ZK. 1789, fshati Golem I Madh, NjA. Golem
20	pasurisë nr. 469/7, Shkolla 9-vjeçare Krutje e Sipërme, Nj. Adm. Krutje	47	pasurisë nr. 43/70, ZK. 1789, fshati Golem I Madh, NjA. Golem
21	pasurisë me nr. 24/55, ZK. 8571, lagjia "Xhevdet Nepravishta".	48	pasurisë nr. 52/10, ZK. 1918, fshati Hajdaraj, Nj. Adm. Golem
22	pasurisë me nr. 24/56, ZK. 8571, lagjia "Xhevdet Nepravishta".	49	pasurisë nr. 517/44, ZK. 1617, fshati Fier I Ri, Nj. Adm. Krutje
23	pasurisë me nr. 24/57, ZK. 8571, lagjia "Xhevdet Nepravishta".	50	pasurisë nr. 125/4, ZK. 2238, fshati Konjat, Nj. Adm. Dushk
24	pasurisë me nr. 24/61, ZK. 8571, lagjia "Xhevdet Nepravishta".	51	pasurisë nr. 473/32, ZK. 1582, fshati Dushk Sektor, NjA. Dushk
25	pasurisë me nr. 7/35, Ish Kopësht, ZK. 8571, lagjia "Kongresi Lushnjes".	52	pasurisë nr. 125/4, ZK. 3590, fshati Thanasaj, Nj.A. Dushk
26	pasurisë nr. 311, ZK. 1813, fshati Gorre, Nj. Adm. Kolonjë.	53	pasurisë nr. 36/67, ZK. 1077, fshati Balaj, Nj. Adm. Hysgjokaj
27	pasurisë 311/1, ZK. 1813, fshati Gorre, Nj. Adm. Kolonjë.	54	pasurisë nr. 22/141-144, Kopshti Gafurr Muco, lagjia 18 TETORI

Konkluzion: Referuar të dhënave të Zyrës së Menaxhimit të Aseteve rezulton se, janë 6462 të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, të transferuara në pronësi ose në përdorim Bashkisë Lushnje dhe 8 e njëjësive Administrative, listat përfundimtare të të cilave janë të miratuara me VKM-ët përkatëse, ndërsa për 4 Njësi Administrative si Ballagat, Karbunarë, Hysgjokaj dhe Fiershegan janë në fazën e miratimit të listave paraprake. Nga këto prona janë hipotekuar 57 prona dhe janë në proces hipotekimi 54 prona të tjera. Për pjesën tjetër të pronave nuk është bërë inventarizimi dhe përditësimi i të dhënave të këtyre pronave, pasi duhet që nëpërmjet verifikimit në terren, dokumentacionit dhe korespondencës zyrtare me institucionet përkatëse për statusin e tyre, duhen identifikuar e propozuar e marrjen masave për ndjekjen e procedurave ligjore për të vepruar me ato prona që janë inekzistente fizikisht, të zaptuara, të kthyer prona apo të privatizuara të cilat duhen në listat e pronave.

Nga Titullari i Bashkisë z. F. T. është nxjerrë Urdhri nr.82 datë 22.06.2021 “Për ngritjen e strukturës së posacme që ka për objekt të veprimtarisë së saj inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në rregjistrimin e pronave dhe rregjistrin publik të pasurive të paluajtshme”, ku janë ngritur:

- **Grupi i parë** i punës i terrenit për verifikimin e gjendjes faktike të pronës dhe matjen faktike të pasurisë nëpërmjet GPS ose metër. Përbëhet nga L. M, M. C, K. D, Dh. Sh, Topograf i NJA de Agronomi i NJA.

- **Grupi i dytë** i punës që do të kryejë verifikimin e gjendjes juridike të pronës nëpërmjet ASHK për informacion të potë për gjendjen e pronësisë, hedhjen e matjeve të terrenit për secilën pasuri nga GPS në DWG sipas ZK përkatëse, përpunim i të dhënave të hedhura në DWG të secilës pasuri sipas ZK, Pasqyrimi i saktë hartografik të pronës shtetërore, ku sipërfaqja, pozicioni, konfigurimi të pasqyrohen sipas gjendjes së konstatuar në terren, plotësimi dhe dërgimi i dosjes përkatëse me listën e pronave shtetërore të përditësuar pranë DVASHK Lushnje. Përbëhet nga: E. K, K. Sh, E. L, S.M dhe E.P.

- **Grupet e punës** cdo të premtë do të raportojnë të Drejtori i Përgjithshëm i Zhvillimit Urban dhe Rural dhe zv/Kryetarja zj. E. S për punët e realizuara gjatë javës. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohet Sektori i Menaxhimit të Tokës Bujqësore dhe Zyra e Aseteve. Ekipi i Punës do të vijojë me procedurat e përditësimit të pasurive sipas listës së inventarit të NJA Fiershegan dhe Ballagat. Procedurat e përditësimit të pasurive-prona shtetërore, sipas listës së inventarit të NJA të mësipërme duhet të përfundojë deri më dtë 31.08.2021.

Nuk është kryer asnjë procedurë për miratimin e listave përfundimtare të pronave të paluajtshme Shtetërore dhe ransferimin e pronave në Bashkinë Lushnje për 4 NJA Ballagat, Karbunarë, Hysgjokaj dhe Fiershegan .

Mos zbatimi i këtij Urdhri për kryerjen e procedurave për inventarizimin dhe miratimin e listave përfundimtare të pronave për 4 NJA Ballagat, Karbunarë, Hysgjokaj dhe Fiershegan, mos inventarizimi dhe përditësimi i listave përfundimtare të pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM Bashkisë dhe NJA-ve dhe më pas miratimi me VKB e paraqitja pranë ASHK në Drejtorinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike me vrejttjet dhe ndryshimet e listave të paraprake të pronave të miratuara, mos rregjistrimi i pjesës më të madhe të këtyre pronave të listuara në ASHK në favor të Bashkisë, si dhe vlerësimi i tyre janë veprime në kundërshtim me VKM nr.500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme Shtetërore dhe ransferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendor” pikën 18,22, me ligjin nr.20/2020 datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV “Përditësimi, invenatrizimi, transferimi dhe rregjistrimi i pronave të paluajtshme publike”nenet 35-44, me Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes

nga njësiti e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”.

Përsa më sipër ngarkohen më përgjegjësi: z.L.M me detyrë specialist topograf në Zyrën e Menaxhimit të Aseteve, M. C me detyrë Përgjegjës në Zyrën e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, z. K. D me detyrë specialist në Zyrën e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, z. DH. Sh me detyrë specialist topograf në Zyrën e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, topografët e NJA: z. A. T -Fiershegan, zj. V. G-Ballagat, agronomët e NJA z. A.M-Fiershegan, zj E. K me detyrë specialiste në Zyrën e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, K. Sh me detyrë specialiste në Zyrën e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës për vitin 2021 dhe specialiste në Zyrën e Menaxhimit të Aseteve për vitin 2022 (larguar dhjetor 2022), zj. E. L me detyrë specialiste në Zyrën e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës për vitin 2021 dhe specialiste në QKF për vitin 2022, zj.S. M me detyrë specialiste Zyrën e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës për vitin 2021 dhe specialiste për ligjshmërinë në Zyrën e Menaxhimit të Aseteve për vitin 2022, zj.E. P ne detyrë specialiste në Zyrën e Menaxhimit të Aseteve (pë periudhen 01.01.2021-07.08.2022 dhe aktualisht specialiste auditi në AB për periudhen gusht 2022 e në vazhdim).

Titulli i Gjetjes	<i>Mbi mangësitë e konstatuara në lidhjen e kontratave të qiardhënies dhe detyrimet kontraktore të papaguara</i>
Situata	Referuar të dhënave të Zyrës së Menaxhimit të Aseteve rezulton se, janë 6462 të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, të transferuara në pronësi ose në përdorim Bashkisë Lushnje dhe 8 e njësive Administrative, listat përfundimtare të të cilave janë të miratuara me VKM-ët përkatëse, ndërsa për 4 Njësi Administrative si Ballagat, Karbunarë, Hysgjokaj dhe Fiershegan janë në fazën e miratimit të listave paraprake. Nga këto prona janë hipotekuar 57 prona dhe janë në proces hipotekimi 54 prona të tjera. Për pjesën tjetër të pronave nuk është bërë inventarizimi dhe perditësimi i të dhënave të këtyre pronave. Nga ish-Titullari i Bashkisë është nxjerrë Urdhri nr.82 datë 22.06.2021 “Për ngritjen e strukturës së posaçme, që ka për objekt të veprimtarisë së saj inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në rregjistrimin e pronave dhe rregjistrin publik të pasurive të paluajtshme”. Nuk janë kryer procedurat për miratimin e listave përfundimtare të pronave të paluajtshme Shtetërore dhe ransferimin e pronave në Bashkinë Lushnje për 4 NJA Ballagat, Karbunarë, Hysgjokaj dhe Fiershegan.
Kriteri	VKM nr.500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme Shtetërore dhe ransferimin e pronave në Njësiti e Qeverisjes Vendor” pikën 18,22, me ligjin nr.20/2020 datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV “Përditësimi, invenatrizimi, transferimi dhe rregjistrimi i pronave të paluajtshme publike”nenet 35-44, me Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësiti e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”.
Ndikimi/Efekti	Mos kryerje procedurave të plota për kalimin e pasurive nëpronësi/përdorim Bashkisë Lushnje për 2 NJA dhe mosrregjistrimi në ASHK të npjesës tjetër të asetëve.

Shkaku	Bashkia Lushnje nuk ka bër punë të mjaftueshme për realizimin e e kalimit të plotë pasurive nga pushteti qendror dhe miratimi me VKM i tyre si dhe rregjistrimin e pronave të bashkisë në ASHK.
Rëndësia	E lartë
Rekomandim	Bashkia Lushnje nëpërmjet strukturave drejtuese dhe përgjegjëse të kryejë procedurat e plota për inventarizimin dhe miratimin e listave përfundimtare të pronave për 4 NJA Ballagat, Karbunarë, Hysgjokaj dhe Fiershegan, duke kryer inventarizimin dhe përditësimin e listave paraprake të pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM Bashkisë dhe NJA-ve dhe më pas miratimi me VKB e paraqitja pranë ASHK në Drejtorinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike me vrejttjet dhe ndryshimet e listave të paraprake të pronave të miratuara. Gjithashtu për pjesën tjetër të pronave të kaluara Bashkisë me VKM në pronësi/përdorim të pa hipotekuar të përgatisë dokumentacionin tekniko-ligjor dhe të ndjekë deri në fund rregjistrimin e tyre në ASHK, Drejtoria Rajonale Lushnje.

- Administrimi dhe menaxhimi i aseteve në pronësi ose në përdorim nga Bashkia.

Bashkia Lushnje me qëllim krijimin e të ardhurave në vite ka lidhur 71 kontrata për dhënien me qira të aseteve, që i kanë kaluar me VKM në pronësi apo në përdorim nga pushteti qendror. Këto kontrata janë lidhur bazuar në legjislacionin përkatës në vijimësi me subjekte të ndryshëm fizik/ juridik që kanë shprehur interes, me afate kohore:

- Me afat 99 vjecar janë lidhur 48 kontrata në vitet 2013 e para tij, për dhënie me qira të parcelave nga fondi tokave bujqësore të pa shpërndarë kryesisht për veprimtari bujqësore e blegtorale e kultivim të ullirit.

- Me afat 40 vjecar është lidhur 1 kontratë për dhënie me qira të parcelave nga fondi tokave bujqësore të pa shpërndarë për veprimtari bujqësore e blegtorale,

- Me afat 30 vjecare janë lidhur 11 kontrata për dhënie me qira të parcelave nga fondi tokave bujqësore të pa shpërndarë për veprimtari bujqësore e blegtorale,

- Me afat 20 vjecar janë lidhur 2 kontrata, për dhënie me qira të pasurisë “truall”

- Me afat 10 vjecar janë lidhur 3 kontrata, për dhënie me qira të parcelave nga fondi pyjor për veprimtari “Agro-pylltari”

- Me afat 5 vjecar është lidhur 1 kontratë për dhënie me qira të parcelave nga fondi pyjor për shfrytëzim të burimeve ujore nëntokësore

- Me afat 1 vjecar janë lidhur 5 kontrata për dhënie me qira të ambienteve te ndertesave për veprimtari tregtare.

Të dhënat e kontratave të lidhura për qiradhënie dhe pagesat e kryera për tarifën e qirasë, si dhe debitorët e krijuar në vitin 2022 paraqiten në Aneks.

Të dhënat e kontratave të lidhura për qiradhënie dhe pagesat e kryera për tarifën e qirasë, si dhe debitorët e krijuar në vitin 2022 paraqiten në Aneks.

Konkluzion: Nga verifikimi i pagesave të kryer nga subjekte qiramarrës të tarifës së qirasë sipas kontratave të lidhura rezulton se në fund të vitit 2022 janë debitorë 7 subjekte në vlerën 6,676,216 lekë. **Në fund të vitit 2021** janë debitorë 7 subjekte në vlerën **6,196,410 lekë**, gjatë vitit 2022 është shtuar vlera debitorë 479,806 lekë, ndërsa **në fund të vitit 2022** janë 7 subjekte në vlerën **6,676,216 lekë**, duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Lushnje.

• Nga audimi i dokumentacionit të paraqitur nga Zyra e Menaxhimit të Aseteve në lidhje me kontratat rezulton se për vitin 2022 janë lidhur 2 kontrata dhe 1 kontratë është rinovuar në 2023 për të cilat u konstatuan se:

1. Kontrata nr.7854/1, datë 06.10.2022 me objekt “Për dhënie me qira të ambientit tek kollonat e muzeut historik të qytetit” nënshkruar midis zj E. S dhe qiramarrësit z.I. T për ambientin me sipërfaqe 22 m² ndërtesë me numër pasurie 18/17, zona kadastrale 8571.

Qëllimi i kontratës është për përdorim “Bar Bufë” me afat 1 vit dhe vlerë mujore 22 m² x240 lekë/22 m² = 5280 lekë/muaj. Shpërndarja e të ardhurave 50% Muzeu dhe 50% Bashkia. Nuk jepet mënyra e pagesës dhe mbi ç’bazë ligjore është bërë kjo ndarje.

Në kontratë nuk përcaktohet ndryshimi i vlerës ose kushteve të saj në varësi të ndryshimeve në legjislacion. Nuk është përcaktuar në kontratë mënyra e dhënies me qira të objektit, duke mospasqyruar gjendjen fizike të objektit në momentin e dhënies me qira.

2. Kontrata nr.3466/1, datë 24.05.2022 me objekt “Për dhënie me qira ambjent ish Zyrat e Gjendjes Civile brenda Bashkisë Lushnje për tu përdorur si lokal për administratën me sip. 34 m²” me afat 1 vit prej datës 20.05.2021. Qëllimi i kontratës është për përdorim “Bar Bufë” me afat 1 vit dhe vlerë mujore 34 m² x200 lekë/m² = 6800 lekë/muaj. Shpërndarja e të ardhurave është përcaktuar 30% Buxheti dhe 70% Bashkia. Nuk jepet mënyra e pagesës dhe mbi ç’bazë ligjore është bërë kjo ndarje. Në kontratë nuk përcaktohet ndryshimi i vlerës ose kushteve të saj në varësi të ndryshimeve në legjislacion. Nuk është përcaktuar në kontratë mënyra e dhënies me qira të objektit, duke mospasqyruar gjendjen fizike të objektit në momentin e dhënies me qira.

3. Kontrata nr.383/1, date 18.05.2023 me objekt “Për dhënie me qira ambjent Qendra shëndetësore Gorre për tu përdorur si Farmaci me sip. 44 m²” me afat 1 vit prej 10.03.2023 – 09.03.2024, Pra kontrata është lidhur 2 muaj më vonë se përfundimi i afatit. Qëllimi i kontratës është për përdorim “Bar Bufë” me afat 1 vit dhe vlerë mujore 44 m² x100 lekë/22 m² = 4400 lekë/muaj. Shpërndarja e të ardhurave është 50% Qendra shendetesore dhe 50% Bashkia. Nuk jepet mënyra e pagesës dhe mbi ç’bazë ligjore është bërë kjo ndarje. Në kontratë nuk përcaktohet ndryshimi i vlerës ose kushteve të saj në varësi të ndryshimeve në legjislacion. Nuk është përcaktuar në kontratë mënyra e dhënies me qira të objektit, duke mospasqyruar gjendjen fizike të objektit në momentin e dhënies me qira.

Kontratat shumë vjeçare nuk janë noterizuar si dhe nuk ka të dhëna nëse janë rregjistruar në ish-ZRPP Lushnje aktualisht ASHK Drejtoria Lushnje. Në asnjë rast të kontratave të qiradhënies si ato të hershmet dhe ato të rejat nuk është parashikuar në kontratë marrja në konsideratë e ndryshimeve ligjore gjatë kohës që shtrihet afati i kontratës sidomos në lidhje me tarifën e qirasë si dhe nuk është kryer monitorimi i kontratave në lidhje me objektin dhe deyrimet e përdoruesit në kundërshtim me nenin e “Të drejtat dhe detyrimet e Pronarit”. Gjithashtu marrja në dorëzim e parcelave si nga fondi pyjor dhe nga fondi i tokave bujqësore të pa ndara nuk është shoqëruar me inventarizimin fizik të gjendjes në terren e shoqëruar me procesverbalin e marrjes në dorëzim. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

- ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar nenet 826-840, ku **neni 826**, i cili përcakton se: *Kontrata e qirasë të pasurisë së paluajtshme që shërben për kultivimin bujqësor për një kohë mbi nëntë vjet, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet në regjistrin publik.*, **neni 826 pika 4**, i cili përcakton se: *“Qiradhënësi me anë inventarit i dorëzon qiramarrësit pasurinë e paluajtshme, si tokën bujqësore, kullotat, ndërtesat e banimit e ato ndihmëse në shërbim të veprimtarisë bujqësore e blegtorale, si dhe sendet e luajtshme në shërbim të kësaj veprimtarie”* **neni 829**, i cili përcakton se: *“Qiradhënësi ka të drejtë që në çdo kohë të ushtrojë kontroll mbi pasurinë e dhënë me qira për të përcaktuar nëse*

qiramarrësi respekton marrëveshjen sipas detyrimeve të vëna në kontratë, sipas natyrës dhe rregullave agroteknike.”

- me kontratat e lidhura kreu “dispozita të veçanta” **pika 4**, “ *Ku qiradhënësi merr përsipër ushtrinë kontrolli periodike mbi gjendjen e fondit të tokës bujqësore, zbatimin e dispozitave të ligjit për mbrojtjen e tokës...Në fund të çdo kontrolli ti dorëzojë procesverbalin me detyrat konkrete dhe të bazuara ligjore.*” neni “Pagesa”ose “Të drejtat dhe detyrimet e përdoruesit” .

- me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4/ 26, neni11/4 dhe neni 12/f dhe UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kap III, pika 30.

- me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfi-teozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar,

- me VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

Titulli i Gjetjes	Mbi mangësitë e konstatuara në lidhjen e kontratave të qiradhënies dhe detyrimet kontraktore të papaguara
Situata	<p>Bashkia Lushnje me qëllim krijimin e të ardhurave në vite ka lidhur 71 kontrata për dhënien me qira të aseteve, që i kanë kaluar me VKM në pronësi apo në përdorim nga pushteti qendror. Këto kontrata janë lidhur me subjekte të ndryshëm fizik/ juridik, kryesisht për veprimtari bujqësore e blegtorale e kultivim të ullirit në parcelat e fondit të tokave bujqësore të pandara, 48 kontrata në vitet 2013 me afat 99 vjecar, 1 me afat 40 vjecar dhe 11 me afat 30vjecar, për dhenie me qira të pasurisë “truall” 2 kontrata me afat 20 vjecar, për veprimtari “Agro-pylltari” 3 kontrata me afat 10 vjecar dhe 1 kontratë me afat 5 vjecar për shfrytëzim të burimeve ujore nëntokësore në parcelat nga fondi pyjor, si dhe 5 kontrata me afat 1 vjecar për dhenie me qira të ambienteve te ndertesave për veprimtari tregtare. Kontratat nuk janë të noterizuar si dhe nuk ka të dhëna nëse janë rregjistruar në ish-ZRPP Lushnje aktualisht ASHK Drejtoria Lushnje. Gjithashtu marrja në dorëzim e parcelave si nga fondi pyjor dhe nga fondi i tokave bujqësore të pa ndara nuk është shoqëruar me inventarizimin fizik të gjendjes në terren e shoqëruar me procesverbalin e marrjes në dorëzim. Në asnjë rast të kontratave të qiradhënies si ato të hershmet dhe ato të rejat nuk është parashikuar në kontratë marrja në konsideratë e ndryshimeve ligjore gjatë kohës që shtrihet afati i kontratës sidomos në lidhje me tarifën e qirasë si dhe nuk është kryer monitorimi i kontratave në lidhje me objektin dhe detyrimet e e përdoruesit. Në fund të vitit 2021 janë debitorë 7 subjekte në vlerën 6,196,410 lekë, gjatë vitit 2022 është shtuar vlera debitore 479,806 lekë, ndërsa në fund të vitit 2022 janë 7 subjekte debitorë në vlerën 6,676,216 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Lushnje.</p>
Kriteri	Ligji nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 826-829-840, me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4/ 26, neni11/4 dhe neni 12/f dhe UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kap III, pika 30, me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira,

	enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, me VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” dhe me kontratat përkëtesë pika 4 “dispozita të veçanta”, neni “Pagesa”ose “Të drejtat dhe detyrimet e përdoruesit”
Ndikimi/Efekti	Mangësi në procedurat e lidhjes së kontratave të qiradhënies si dhe të ardhura të munguara në vlerën 6,676,216 lekë .
Shkaku	Bashkia Lushnje nuk ka ndjekur të gjitha kërkesat e dispozitave ligjore në administrimin dhe menaxhimin e kontratave të qiradhënies si dhe për arkëtimin e detyrimeve kontraktore.
Rëndësia	E lartë
Rekomandim	Bashkia Lushnje nëpërmjet strukturave përgjegjëse për hartimin, menaxhimin dhe monitorimin e kontratave të qiradhënies të aseteve, të marrë masa për monitorimin e kontratave, në lidhje me zbatimin e objektit të kontratës, realizimin e detyrimeve të palës qiramarrëse, në lidhje me dëmtimet e pronës, dhe në të gjitha rastet të nbahen procesverbale dypalëshe. Nëse konstatohen parregullsi në zbatimin e kontratave të ndiqen procedurat administrative dhe ligjore pas shqyrtimit dhe miratimit në Këshill Bashkiak të problematikës. Të verifikohen nëpërmjet korespondencës zyrtare nëse kontratat afatgjatë janë të rregjistruara në ASHK Drejtoria Lushnje, nëse jo të bëhet rregjistrimi i tyre. Të ndiqen të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës debitoare të 7 subjekteve që nuk kanë paguar detyrimet kontraktore të tarifës së qirasë në vlerën 6,676,216 lekë.

Përsa më sipër ngarkon me përgjegjësi: z. B. H me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Prokurimeve Publike, znj. S. M me detyrë specialiste për ligjshmërinë në Zyrën e Menaxhimit të Aseteve, znj. L. M me detyrë specialist topograf në Zyrën e Menaxhimit të Aseteve, znj.K. Sh me detyrë specialist topograf në Zyrën e Menaxhimit të Aseteve (për periudhen 01.01.2022-31.12.2022, larguar për vitin 2023) dhe znj.J.S me detyrë specialist për inventarizimin e Aseteve në Zyrën e Menaxhimit të Aseteve (për periudhen 01.01.2022-31.10.2023, aktualisht specialiste në DAV).

Sqarime dhe shpjegime: *Observacioni i sjellë me shkresën nr.10131/2, datë 14.12.2023, protokolluar në KLSH me nr.prot.866/4 datë 18.12.2023 nga zj.S. M dhe zj. L. M për konstatimin e grupit te KLSH:*

- Në lidhje me punën e kryer për inventarizimin dhe përditësimin e listave praprake të miratuara me VKM për të kaluar në fazën e listave përfundimtare për kalim në pronësi/përdorim të aseteve të për 4 Njësi Administrative si Ballagat, Karbunarë, Hysgjokaj dhe Fiershegan nga shpjegimet e subjektit të audituar rezulton që është kryer punë pjesore vetëm për pronat e NJA Fiershegan, pra konfirmohet se nuk janë kryer procedurat e plota si për NJA Fiershegan dhe aspak për 3 Njësitë Administrative Ballagat, Karbunarë, Hysgjokaj.

- Në lidhje me pagesat e detyrimeve debitoare nga sqarimet e subjektit rezulton se në 1 rast nga 7 rastet e subjekteve debitoare, që ka dhe detyrimin më të madh në vlerën 4,805,500 lekë nga Bashkia Lushnje është bërë padi në Gjykatën Administrative me datë 20.09.2022, procedurë që sapo ka nisur dhe duhet ndjekur deri në fund, ku edhe nga ana jonë kemi kërkuar për ndjekjen e të gjitha

procedurave administrative dhe ligjore për këtë rast dhe 7 rastet e tjera për arkëtimin e detyrimeve kontraktore.

- Në lidhje me noterizimin e kontratave konstatimi ynë bën fjalë për kontrata shumëvjeçare dhe jo për kontratat 1-vjeçare. Ndërsa për shpërndarjen e të ardhurave nuk jemi shprehur në këtë akt-konstatim.

Referuar dokumentacionit dhe shpjegimeve të observacionit konfirmohet se nuk është bërë punë e mjaftueshme për listat përfundimtare dhe dërgimit për miratim në KM për 4 NJA në fazë të miratimit me VKM listave paraprake, rregjistrimin e pronave në ASHK të kaluara me VKM të listave përfundimtare pranë Bashkisë Lushnje si dhe arkëtimin e debitorëve. Duke qenë se observacioni ka karakter justifikues dhe nuk është i argumentuar ligjërisht nuk merret në konsideratë.

2.4. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

4.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrimit të prokurimeve.

4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

4.3. Mbi saktësinë e procedurave të prokurimit si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

4.4. Mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomikë fitues.

Nga auditimi i kryer, për periudhën e aktivitetit të vitit 2022 (si më sipër), rezultoi si më poshtë: Nga Autoriteti Kontraktor (AK) Bashkia Lushnje për periudhën e vitit 2022 objekt auditimi, janë realizuar gjithsej: 14 procedura prokurimi mbi vlerën me blerje të vogla. Nga këto janë 11 procedura prokurimi Investime me fond limit në total në vlerën: 297,947,328 lekë dhe procedura Mallra e Shërbime me fond limit në total në vlerën: 57,883,112 lekë. Këto procedura prokurimi në total janë me Fond limit, në vlerën prej: $(297,947,328 + 57,883,112) = 355,830,440$ lekë me tvsh ose në vlerën 284,664,352 lekë pa tvsh. Për këto procedura prokurimi në përfundim janë lidhur kontratat me operatorët fituese në vlerën totale prej: $(218,460,089$ lekë me tvsh Investime dhe $53,850,798$ lekë me tvsh mallra e shërbime) $= 272,310,887$ lekë me tvsh, ose $217,848,710$ lekë pa tvsh me një diferencë (kursim) në total në vlerën prej: $(284,664,352$ lekë pa tvsh - $217,848,710$ lekë pa tvsh) $= 66,815,642$ lekë pa tvsh ose në masën 23.5% të fondit limit pa tvsh. Në lidhje me 11 procedurat e prokurimeve investime të zhvilluara nga Bashkia Lushnje për vitin 2022 rezulton se: nga Bashkia janë parashikuar për investime me fondet e buxhetit të Bashkisë 9 procedura ndërsa dy procedura prokurim janë parashikuar me fondet e buxhetit të shtetit për emergjencat e konkretisht procedurat e prokurimit: 1. Ndërtimi i murit mbajtës përgjatë pallateve në lagjen “Kongresi i Lushnjes” e formës së prokurimit e Hapur e thjeshtë me vlerë kontrate 4,199,076 lekë me tvsh dhe 2.Rehabilitimi i kanalit të Ujrave të Larta në Lagjen Kongresi i Lushnjes e formës së tender i hapur me vlerë kontrate: 11,719,878 lekë me tvsh.

Në lidhje me Procedurat e prokurimit të zhvilluara nga AK Bashkia Lushnje për vitin 2022 u audituan 8 procedura të investimeve dhe Mallrave dhe shërbimeve të përzgjedhura nisur nga fondi limit më i lartë duke i konsideruar me rrisht më të madh duke mos e konsideruar procedurën e prokurimit: Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimi i mbetjeve urbane në Bashkinë Lushnje të zhvilluar në vitin 2022 me rrisht për arsyet se: ***Për këtë pocedurë prokurimi është shprehur dhe KPP pas shqyrtimit të ankimit dhe se ky shërbim tashmë do të kryhet nga vetë Bashkia e cila***

ka ngritur ndërmarrje për këtë qëllim dhe kjo është arsyeja e blerjes së kontenierëve të mbeturinave sipas pikës 1 të tabelës 2 të mësipërme.

Përsa i përket procedurave të prokurimit të formës Blerjeve me vlera të vogla nga Bashkia Lushnje për vitin 2022 rezultojnë të realizuara 29 procedura prokurimi me Fond Limit në total (sipas regjistrimit të parashikimit të AK) në vlerën prej: 10,585,730 lekë dhe me vlerë kontrate 6,921,834 lekë me një kursim në vlerën prej: (10,585,730 lekë - 6,921,834 lekë) = 3,663,896 lekë. Nga këto 29 procedura prokurimi rezultojnë 5 procedura të drejtpërdrejta. Gjithashtu rezultojnë se 11 procedura i përkasin shërbime për mbikqyrje ndërtimi. Nga këto procedura u përzgjedhën për auditim 6 procedura duke u nisur nga vlera dhe tipologjia.

Auditimi i procedurave të prokurimit u realizua nëpërmjet SPE dhe dokumentacionit fizik sipas dosjeve respektive të Dokumentacionit të prokurimeve të vëna në dispozicion nga AK.

Nga auditimi konstatohet se, në procedurat e prokurimit të zhvilluara nga kjo Bashki pothuaj në të gjitha rastet është konkluduar duke u shpallur fitues operatori ekonomik që ka paraqitur ofertën ekonomike më të ulët dhe se në një rast të ankimit në KPP përsëri nuk është pranuar ankimi. Auditimit ju vendosën në dispozicion materialet dokumentare (Dosjet e Prokurimit) dhe njëkohësisht ju mundësua që të ushtrohej auditim nëpërmjet Sistemit Elektronik të Prokurimit Publik.

Përsa i përket Investimeve prokurimeve (punë) rezulton se, auditimi i marrjes në dorrëzim sipas pikës 4.3 të Programit të Auditimit do të duhej të realizohej nga një inxhinjer i cili nuk u mundësua që të ishte pjesë e grupit të auditimit e për këtë arsye kjo pikë e programit të auditimit ngelet e pa realizuar dhe për tu vlerësuar për auditimin në një kohë të mëvonëshme.

Nga auditimi ka rezultuar se, megjithë faktin e zbatimit të procedurave ligjore në lidhje me zhvillimin e proceseve të prokurimeve që nga faza e planifikimit parashikimit nëpërmjet regjistrimit të parashikimit dhe realizimit të përgatitura sipas afateve ligjore nga AK paraqiten dhe mangasitë e konstatuara si më poshtë:

1.Objekti: “Ndërtimi i tregut në lagjen Xhevdet Nepravishta”.

Kjo procedurë prokurimi, ka filluar me nxjerrjen e Urdhërit të Prokurimit me Nr. 65 datë 15.03.2022 me objekt zhvillimin e procedurës së prokurimit: Ndërtimi i tregut në lagjen Xhevdet Nepravishta” me fond limit prej : 29,283,337 lekë pa TVSH ose 35,140,005 lekë me TVSH në të cilën është përcaktuar dhe Njësia e Prokurimit me përbërjen: E. Dh(Person përgjegjës) Jurist, L. H (Person i fushës) Ekonomiste, L.M (Person i fushës) Inxhinierë Ndërtimi.

Fondi për këtë prokurim është përcaktuar nga të ardhurat e Bashkisë Lushnje të miratuara me Vendimin e Këshillit Bashkiak Lushnje me nr.101, date 23.12.2021 (Nr.9679/2 prot. 24.12.2021)“ Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2022, të programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 (PBA) dhe të kalendarit të programit buxhetor afatmesëm të Bashkisë”. Ky Vendim është miratuar dhe nga Prefekti Qarkut Fier me shkresën nr. 1549/1 prot. datë 30.12.2021.

Në këtë Vendim të Këshillit të Bashkisë Lushnje është përcaktuar vlera e plotë e investimit të objektit prej: 35,140,216 lekë dhe kjo e ndarë për vitin 2022: 12,000,000 lekë dhe për vitin 2023 në vlerën prej 23,140,216 lekë.

Kriteret për kualifikim janë hartuar nga komisioni i ngritur për këtë qëllim me Urdhërin e titullarit të AK (Kryetarit të Bashkisë Lushnje) Nr.53 datë 01.03.2022 (Nr. 1806 prot datë 01.03.2022) me përbërjen: A.M arkitekt, D.B ing. Ndërtimi dhe A. M ing mekanik nga të cilët është mbajtur dhe procesverbali për këtë qëllim por ky procesverbal nuk mban as datë dhe as ndonjë numër protokollimi.

Kjo procedurë prokurimi është filluar më datë 07.04.2022 dhe rezulton se në datën e hapjes kanë paraqitur ofertat e tyre 10 ofertues.

Nga ana e KVO ,të ngritur me Urdhrin e Titullarit të AK nr.66, datë 15.03.2022 me përbërjen si në tabelën e mësipërme, në procedurën e vlerësimit janë skualifikuar 4 ofertues duke kualifikuar 6 të tjerët për më tej. Janë skualifikuar operatorë ekonomik të cilët nuk kanë patur ofertën më të ulët të paraqitur.

Ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

1. Shoqeria “A C” shpk Tirane vlere e ofertës: 41,440,298,4 Lekë pa TVSH
2. Shoqeria “D.C” shpk Tirane vlere sipas formularit të ofertës: 28, 866, 213 Lekë pa TVSH.
3. Shoqeria “M” shpk Fier vlere e ofertës: 23,599,709 Lekë pa TVSH.

Ofertuesit e kualifikuar paraqiten si më poshtë:

1. Shoqeria “2 N ” shpk Tirane, vlere e ofertës: 23, 494, 704 Lekë pa TVSH (i renditur në vendin e parë)
2. Shoqeria “E shpk” , Tirane vlere e ofertës: 29,242, 654,8 Lekë pa TVSH
3. Shoqeria “G” shpk Fier vlere e ofertës: 28,056,283 Lekë pa TVSH.
4. Shoqeria “N” shpk Shkodër vlere e ofertës: 23,658,368,8 Lekë pa TVSH.
5. Shoqeria “SH” shpk Fier vlere e ofertës: 28,906,556 Lekë pa TVSH.
6. Bashkimi i shoqerive “T” shpk Gjirokaster & “6D-P.” shpk Fier vlere e ofertës: 27,534,636 Lekë pa TVSH.

Në përfundim të vlerësimit me ofertuesin e shpallur fitues është ftuar për lidhje kontrate por ky ofertues nuk është paraqitur duke bërë që për këtë qëllim nga AK të vazhdojnë procedurat e prokurimit duke mbajtur bazuar në LPP (Legjislacioni i Prokurimit Publik) Garancinë e ofertës dhe arkëtimin e sajë për llogari të AK nga operatori që refuzoj lidhjen e kontratës me mosparaqitje.

Në këto kushte procedurat kanë vazhduar nga AK duke lidhur kontratë me ofertuesin e rradhës të renditur “N” shpk Shkodër. Me të cilën në përfundim të procedurave të prokurimit është lidhur kontrata me nr. 6154 prot datë 08.07.2022 në të cilën është e përcaktuar dhe nga neni 5 të në DST që afati i punimeve është 113 ditë kalendarike duke nisur nga data e lidhjes së kontratës. Ndërsa në nenin 10 të kontratës është përcaktuar Grafiku i Pagesës duke përcaktuar në :

- 10.1. Vlora përfundimtare e kontratës: 28,371,642.5 lekë me tvsh
Vlora e financimit për vitin 2022 është 12,000,000 lekë me tvsh
Vlora e financimit për vitin 2023 është 16,371,642.5 lekë me tvsh.

Në lidhje me këtë kontratë nga AK është lidhur një shtesë kontrate me Nr. 10645 prot. datë 01.12.2022 për zgjatjen e afatit të punimeve të ndërtimit duke parashikuar përfundimin e punimeve për datë 31.12.2022.

Në lidhje me këtë procedurë prokurimi konstatohet se: nuk ka qenë në kushtet e ndonjë kontrate shumë vjeçare por të një kontrate me një afat prej rreth 4 muaj për zbatimin e punimeve dhe në këto kushte dhe vetë procedurat e prokurimit janë përzgjedhur me të drejtë për një procedurë prokurimi jo shumëvjeçare. Por në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Lushnje nr 101 date 23.12.2021 (Nr.9679/2 prot. 24.12.2021) “ Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2022, të programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 (PBA) dhe të kalendarit të programit buxhetor afatmesëm të Bashkisë” është përcaktuar vlere e plotë e investimit të objektit prej: 35,140,216 lekë dhe kjo e ndarë për vitin 2022: 12,000,000 lekë dhe për vitin 2023 në vlerën prej 23,140,216 lekë. Po ashtu dhe në kontratën e lidhur me ofertuesin e shpallur fitues në përfundim të procedurave të prokurimit me nr. 6154 prot datë 08.07.2022 është e përcaktuar në nenin 5 (si dhe

në në DST) që afati i punimeve është 113 ditë kalendarike duke nisur nga data e lidhjes së kontratës. Ndërsa në nenin 10 të kontratës është përcaktuar Grafiku i pagesës duke përcaktuar në 10.1. Vlera përfundimtare e kontratës: 28,371,642.5 lekë me tvsh
Vlera e financimit për vitin 2022 është 12,000,000 lekë me tvsh
Vlera e financimit për vitin 2023 është 16,371,642.5 lekë me tvsh.

Nga kjo konstatohet se, për këtë prokurim nga AK nuk kanë qenë në dispozicion fondet e plota të nevojshme për realizimin e punëve, duke qenë përpara një kontrate prokurimi me kohëzgjatje sipas DST por dhe Kontratës së lidhur për afat përfundimi të punimeve të parashikuar për 113 ditë kalendarike.

Një gjë e tillë është në kundërshtim me pikën 1 dhe 3 të nenit 106 “Kohëzgjatja e kontratës” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, përcakton se:

“1. Autoriteti/enti kontraktor për fondet buxhetore prokuron kontrata bazuar në fondin e një viti buxhetor.

3. Autoriteti/enti kontraktor nuk lidh kontrata shumëvjeçare për punë, mallra ose shërbime, për të cilat bëhen planifikim dhe përdorime vjetore, që gjenden lehtësisht në treg dhe mund të prokurohen normalisht.”

Një veprim i tillë bën që të ulet konkurrenca dhe njëkohësisht të përdoret legjislacioni i Prokurimit Publik si një legjislacion që mundëson AK të realizojë punë apo blerje pa patur buxhetin në dispozicion.

Gjë e cila ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit si dhe titullarin e Autoritetit Kontraktor të cilët përgatisin Urdhërat e Prokurimit dhe janë përgjegjës për të gjithë procedurat e prokurimit, konform ndër të tjera dhe nenit 21 “Autoriteti Kontraktor (AK)” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në pikën 1 të të cilit citohet: *1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Dhe në pikën 5 të tijë citohet: 5. Të gjitha proceset e parashikuara në këtë nen zhvillohen nën mbikëqyrjen e titullarit të autoritetit kontraktor ose personit të autorizuar prej tij.

Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike.

2. Objekti: “Ndërhyrje në infrastrukturën e rrugës Unazë e ish depos së duhanit”

Kjo procedurë prokurimi ka nisur me nxjerrjen nga ana e titullarit të AK të Urdherit të Prokurimit nr. 182 date 07.07.2022 për prokurimin e këtij objekti me fond limit prej: 28,725,352 lekë pa tvsh ose 34,470,422.4 leke me TVSH, me procedure prokurimi me mjete elektronike të formës “Procedure e hapur” .

Fondi i venë në dispozicion nga buxheti i Bashkise Lushnje të miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Lushnje Nr 101 date 23.12.2021 “ Mbi miratimin e buxhetit të vitit 2022” dhe Vendimin nr. 44, date 26/05/2022 ”Për rishpërndarje në buxhetin e vitit 2022”.

Kriteret e kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë nga A. M arkitekt, B.B ing.ndërtimi dhe A. M ing.Mekanik. Komision i ngritur me Urdhërin e titullarit të AK me nr.53 datë

01.03.2022 i ndryshuar me urdhërin 100 datë 22.04.2022 të cilët për këtë qëllim kanë mbajtur procesverbalin nr.3531/1 datë 01.07.2022.

Nga Njësia e Prokurimit është hartuar procesverbali nr.6275 prot datë 13.07.2022 për argumentimin e miratimin e specifikimeve teknike dhe kriteret e kualifikimit. Dhe janë përgatitur DST në të cilën përcaktohet data e tenderit 29.07.2022 me afat punimesh 175 ditë. Dhe Fondi limit vlera e pritshme e kontratës prej : 28,725,352 lekë pa tvsh ose 34,470,422.4 leke me TVSH, Vlera e financimit për vitin 2022 është 7,500,000 lekë pa tvsh dhe për vitin 2023 është përcaktuar në vlerën 21,225,352 lekë pa tvsh.

Në këtë procedurë prokurimi ka ndërhyrë dhe Kordinatori i APP duke ndërhyrë me rekomandim në lidhje me kapacitetet teknike pikën 2.5.b. në lidhje me një certifikatë ISO të kërkuar duke ndërhyrë njëkohësisht dhe në prokurimin e prokurimit “Sistemim Asfaltim i segmentit rrugor “Taulant Sinani-EsmaDervishi me fond limit 23,102822 lekë pa tvsh gjë e cila është reflektuar nga AK duke bërë ndryshim DST më datë 15.07.2022.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave ngritur me urdhërin e titullarit të AK nr. 183 date 07.07.2022 , i perbere nga 3 anëtarë sipas përcaktimit në tabelën e mësipërme. Rezulton se në këtë procedurë prokurimi kanë paraqitur ofertat e tyre 14 OE nga të cilët janë skualifikuar 3 dhe me ofertuesin më të ulët të paraqitur në këtë procedurë prokurimi e konkretisht: Shoqëria “Z” shpk Lushnje vlera sipas formularit te ofertes 21,084,614,25 Lekë pa TVSH është lidhur dhe kontrata me nr.7941 prot. Datë 12.09.2022.

Operatorët ekonomik që kanë paraqitur ofertë dhe që janë skualifikuar dhe kualifikuar nga ana e KVO si dhe vlerat e ofertës ekonomike të tyre paraqiten si më poshtë:

1. “A”, vlera e ofertës : 24,645,550 Lekë pa TVSH
2. “A” shpk Fier vlera e ofertës: 25,188,817,5 Lekë pa TVSH
3. “B.” Shpk Elbasan, vlera e ofertës: 23,020,363,8 Lekë pa TVSH
4. “B” shpk Fier vlera e ofertës: 23,825,025 Lekë pa TVSH
5. “G. B” shpk & “J” shpk vlera e ofertës: 28, 410,120 Lekë pa TVSH.
6. “C R” shpk Tirane vlera e ofertës: 22,689,503 Lekë pa TVSH.
7. “I” shpk Tirane vlera e ofertës: 22,261,480,5 Lekë pa TVSH.
8. “L C” shpk vlera e ofertës: 22,336,062 Lekë pa TVSH. **(Skualifikuar)**
9. “S.” shpk Shkoder vlera e ofertës: 22,866,795 Lekë pa TVSH.
10. “N” shpk Tirane vlera e ofertës: 22, 261,480,5 Lekë pa TVSH. **(Skualifikuar)**
11. “LL” shpk Lushnje vlera e ofertës: 23,133,527 Lekë pa TVSH. **(Skualifikuar)**
12. “P. G” shpk Tiranë vlera e ofertës: 23,688,021.9 Lekë pa TVSH.
13. “S” shpk Tiranë vlera e ofertës: 27,245,757 Lekë pa TVSH.
14. “Z” shpk Lushnje vlera e ofertës: 21,084,614,25 Lekë pa TVSH. **(Fituesi me të cilën është**

lidhur kontrata)

Si në DST ashtu dhe në Kontratën e lidhur me operatorin fitues me nr.7941 prot. Datë 12.09.2022. konstatohet se në në nenin: 10 “Grafiku i pagesës” është përcaktuar vlera: 25,301,537.1 lekë me tvsh nga të cilat: për vitin 2022 është 9.000.000 lekë me tvsh ndërsa për vitin 2023 është: 16.301.537.1 lekë me tvsh. Sipas nenit 5 afati i kryerjes së punimeve është 175 ditë kalendarike. Nga kjo konstatohet se, për këtë prokurim nga AK nuk kanë qenë në dispozicion fondet e plota të nevojshme për realizimin e punëve, duke qenë përpara një kontrate prokurimi me kohëzgjatje sipas DST por dhe Kontratës së lidhur për afat përfundimi të punimeve të parashikuar për 113 ditë kalendarike.

Një gjë e tillë është në kundërshtim me pikën 1 dhe 3 të nenit 106 “Kohëzgjatja e kontratës” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, përcakton se:

“1. Autoriteti/enti kontraktor për fondet buxhetore prokuron kontrata bazuar në fondin e një viti buxhetor.

3. Autoriteti/enti kontraktor nuk lidh kontrata shumëvjeçare për punë, mallra ose shërbime, për të cilat bëhen planifikim dhe përdorime vjetore, që gjenden lehtësisht në treg dhe mund të prokurohen normalisht.”

Një veprim i tillë bën që të ulet konkurrenca dhe njëkohësisht të përdoret legjislacioni I Prokurimit Publik si një legjislacion që mundëson AK të realizojë punë apo blerje pa patur buxhetin në dispozicion.

Gjë e cila ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit si dhe titullarin e Autoritetit Kontraktor të cilët përgatisin Urdhërat e Prokurimit dhe janë përgjegjës për të gjithë procedurat e prokurimit, konform ndër të tjera dhe nenit 21 “Autoriteti Kontraktor (AK)” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në pikën 1 të të cilit citohet: *1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Dhe në pikën 5 të tij citohet: 5. Të gjitha proceset e parashikuara në këtë nen zhvillohen nën mbikëqyrjen e titullarit të autoritetit kontraktor ose personit të autorizuar prej tij.

Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike.

3. Objekti: “Sistemim, Asfaltim i rrugës Shpresa plus rrugës së Repartit në Zhamë Sektor”.

Kjo procedurë prokurimi ka nisur me nxjerrjen nga ana e titullarit të AK të Urdherit të Prokurimit nr. 105 date 06.05.2022 për prokurimin e këtij objekti me fond limit me vlerë prej: 16,915,012.8 lekë pa TVSH ose 20,298,015.4 lekë me TVSH.

Fondi nga të ardhurat e Bashkise Lushnje i miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Lushnje me nr 101 date 23.12.2021 “ Mbi miratimin e buxhetit te vitit 2022”. Përcaktuar si procedure prokurimi me mjete elektronike të formës “Procedure e hapur” .

Nga Njësia e Prokurimit është hartuar procesverbali për argumentimin e miratimin e specifikimeve teknike dhe kriteret e kualifikimit dhe janë përgatitur DST në të cilën përcaktohet data e tenderit 29.07.2022 me afat punimesh 58 ditë.

Në DST Në Njoftimin e Kontratës është përcaktuar:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 16,915,012.8 lekë pa TVSH.

Vlera e financimit për vitin 2022 është: 5,833,333.3 lekë pa TVSH dhe për vitin 2023 : 11,081,679.5 lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja në dite : 58 dite kalendarike duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave ngritur me urdhërin e titullarit të AK nr. 106, datë 06.05.2022, i përbere nga 3 anëtarë sipas përcaktimit në tabelën e mësipërme. Rezulton se në këtë procedurë prokurimi kanë paraqitur ofertat e tyre 9 OE të cilët janë kualifikuar të gjithë dhe me ofertuesin

më të ulët të paraqitur në këtë procedurë prokurimi e konkretisht: Shoqëria BOE “E.” & “F.” shpk, me ofertë ekonomike 10,710,493 lekë pa tvsh është lidhur kontrata me nr.6124 Prot, datë 07.07.2022.

Operatorët ekonomik që kanë paraqitur ofertë dhe që janë skualifikuar dhe kualifikuar nga ana e KVO si dhe vlerat e ofertës ekonomike pa tvsh të tyre paraqiten si më poshtë:

1. **“E ” shpk Lushnje & “F” shpk Berat, vlera e ofertës: 10.710.493 Lekë (fituesi me të cilin është lidhur dhe ontrata)**

2. “SH” shpk Mallakaster vlera e ofertës: 12,000,007 Lekë

3. “A ” shpk Berat & “A” shpk Fier vlera e ofertës: 15,132,274.5 Lekë

4. “BE - SH.P.K” shpk Kukes vlera e ofertës: 15,158,953 Lekë.

5. “B” shpk Fier vlera e ofertës: 12,622,659 Lekë.

6. “C 2008” shpk Tirane vlera e ofertës:13,191,811 Lekë.

7. “I” shpk Tiranë vlera e ofertës: 13,210,419 Lekë.

8. “K.T.” shpk Durrës vlera e ofertës: 13,901,437 Lekë.

9. “S.” shpk Shkodër vlera e ofertës: 12,453,462 Lekë.

Nga llogaritjet e kryera nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka rezultuar anomalisht e ulët një nga ofertat e kualifikuara e konkretisht ajo e Bashkimit të shoqerive “E ” shpk Lushnje & “F” shpk Berat.

Nga AK i është kërkuar me shkresën nr.5007 prot. datë 03.06.2022 justifikimi i ofertes të paraqitur prej tyre e cila ka rezultuar anomalisht e ulët.

Bashkimi i shoqerive “E ” shpk Lushnje & “F” shpk Berat ka paraqitur sqarimin per oferten e tyre me shkresën e datës 06.6.2022 e protokolluar në AK Bashkinë Lushnje me nr.5071prot. datë 07.6.2022.Arsyetim që është pranuar nga AK. Në përfundim të procedurave ligjore të prokurimit nga KVO është vendosur renditja në vendin e parë të ofertuesit me ofertën më të ulët të paraqitur dhe me të cilin nga AK është lidhur dhe kontrata me nr.6124 Prot, datë 07.07.2022,

Si në DST ashtu dhe në Kontratën e lidhur me operatorin fitues ku është përcaktuar grafiku i pagesës konstatohet se, për këtë prokurim nga AK nuk kanë qenë në dispozicion fondet e plota të nevojshme për realizimin e punëve, duke qenë përpara një kontrate prokurimi me kohëzgjatje sipas DST por dhe Kontratës së lidhur për afat përfundimi të punimeve të parashikuar për 58 ditë kalendarike.

Një gjë e tillë është në kundërshtim me pikën 1 dhe 3 të nenit 106 “Kohëzgjatja e kontratës” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, përcakton se:

“1.Autoriteti/enti kontraktor për fondet buxhetore prokuron kontrata bazuar në fondin e një viti buxhetor.

3.Autoriteti/enti kontraktor nuk lidh kontrata shumëvjeçare për punë, mallra ose shërbime, për të cilat bëhen planifikim dhe përdorime vjetore, që gjenden lehtësisht në treg dhe mund të prokurohen normalisht.”

Një veprim i tillë bën që të ulet konkurrenca dhe njëkohësisht të përdoret legjislacioni i Prokurimit Publik si një legjislacion që mundëson AK të realizojë punë apo blerje pa patur buxhetin në dispozicion.

Gjë e cila ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit si dhe titullarin e Autoritetit Kontraktor të cilët përgatisin Urdhërat e Prokurimit dhe janë përgjegjës për të gjithë procedurat e prokurimit, konform ndër të tjera dhe nenit 21 “Autoriteti Kontraktor (AK)” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në pikën 1 të të cilit citohet: *1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim*

të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Dhe në pikën 5 të tijë citohet: 5. Të gjitha proceset e parashikuara në këtë nen zhvillohen nën mbikëqyrjen e titullarit të autoritetit kontraktor ose personit të autorizuar prej tij. Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike.

4. Objekti: “ Sistemim, Asfaltim i rrugës Jakov Xoxa dhe vazhdimi pas Unazës ”.

Kjo procedurë prokurimi ka nisur me nxjerrjen nga ana e titullarit të AK të Urdherit të Prokurimit nr. 163, dt 22.06.2022 për prokurimin e këtij objekti me fond limit me vlerë prej: **17, 499, 987 lekë pa TVSH ose 20,999,984.4 lekë me TVSH.**

Fondi nga të ardhurat e Bashkise Lushnje i miratuar me Vendimin e Keshillit Bashkiak Lushnje me nr 101 date 23.12.2021 “ Mbi miratimin e buxhetit te vitit 2022”. Përcaktuar si procedure prokurimi me mjete elektronike të formës “Procedure e hapur ”.

Nga Njësia e Prokurimit është hartuar procesverbali për argumentimin e miratimin e specifikimeve teknike dhe kriteret e kualifikimit dhe janë përgatitur DST në të cilën përcaktohet data e tenderit 12.07.2022 me afat punimesh 56 ditë.

Në DST Në Njoftimin e Kontratës është përcaktuar:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 17,499,987 lekë pa TVSH.

Vlera e financimit për vitin 2022 është: 6,666,653.7 lekë pa TVSH dhe për vitin 2023 : 10,833,333.3 lekë pa TVSH

Kohëzgjatja në dite: 56 dite kalendarike duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.

Nga auditimi konstatohet se, nga AK në DST në kriteret e veçanta për kualifikim, në pikën 2.5.b – ka kërkuar: *Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit OHSAS 18001-2007 ose ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).*

Nga AK është gabuar pasi Çertifikata e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit OHSAS 18001-2007 është shfuqizuar dhe për rrjedhim do të duhej të kërkonte vetëm çertifikatën për standartin e përditësuar (ISO 45001:2018).

Një kërkesë e tillë ka rezultuar dhe në dy procedurat e prokurimit të zhvilluara nga ky Autoritet Kontraktor e konkretisht në procedurat: Ndërhyrje në infrastrukturën e rrugës Unazë e ish depos së Duhanit” dhe në procedurën “Sistemim, Asfaltim segmentit rrugor : “Taulla Sinani- Esmat Dervishi”. Për këto dy procedura është ndërhyrë nga APP (Kordinatori) dhe nga AK është korigjuar nëpërmjet Ndryshimeve të dokumentave të tenderit.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave është ngritur me urdhërin e titullarit të AK nr. 164, datë 22.06.2022, i përbërë nga 3 anëtarë sipas përcaktimit në tabelën e mësipërme. Rezulton se në këtë procedurë prokurimi kanë paraqitur ofertat e tyre 9 OE nga të cilët janë skualifikuar dy prej tyre dhe janë kualifikuar shtatë të tjerë dhe me ofertuesin më të ulët të paraqitur në këtë procedurë prokurimi e konkretisht: **OE “SH”** shpk, me ofertën ekonomike prej: **10,000,021** lekë pa tvsh është lidhur Kontrata nr.7546 Prot, datë 31.08.2022.

Operatorët ekonomik që kanë paraqitur ofertë dhe që janë skualifikuar dhe kualifikuar nga ana e KVO si dhe vlerat e ofertës ekonomike pa tvsh të tyre paraqiten si më poshtë:

1. “SH” shpk Mallakaster vlera e ofertës: 10,000,021 lekë. (**e renditur e para dhe me të cilën është lidhur dhe kontrata**)
2. “A ” shpk Berat & “ASI-2A CO” shpk Fier vlera e ofertës: 14,896,708.72 lekë.
3. “B ” shpk Elbasan vlera e ofertës: 12,282,393.62 lekë.
4. “B” shpk Fier vlera e ofertës: 13,954,051.69 lekë.
5. “I” shpk Tiranë vlera e ofertës: 13, 880, 455 lekë.
6. “K.T” shpk Durrës vlera e ofertës: 14,896,510 lekë pa tvsh.
7. “MF ” shpk Tiranë vlera e ofertës: 13,969,190.6 lekë. (**e skualifikuar**)
8. “N ” shpk Shkodër vlera e ofertës: 13,905,078.3 lekë pa tvsh. (**e skualifikuar**)
9. “S” shpk Fier vlera e ofertës: 15,235,520 lekë.

Nga llogaritjet e kryera nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka rezultuar anomalisht e ulët një nga ofertat e kualifikuara e konkretisht ajo e Operatorit Ekonomik: “SH” shpk Mallakaster .

Nga AK i është kërkuar me shkresën nr.6569 prot. datë 22.07.2022 justifikimi i ofertes të paraqitur prej tyre e cila ka rezultuar anomalisht e ulët dhe dokumentacioni mbështetës e sqarues. Arsyetimi i paraqitur nga ofertuesi është pranuar nga AK. Në përfundim të procedurave ligjore të prokurimit nga KVO është vendosur renditja në vendin e parë të ofertuesit me ofertën më të ulët të paraqitur dhe me të cilin nga AK është lidhur dhe kontrata me nr. 7546 Prot, datë 31.08.2022. Si në DST ashtu dhe në Kontratën e lidhur me operatorin fitues ku është përcaktuar grafiku i pagesës konstatohet se, për këtë prokurim nga AK nuk kanë qenë në dispozicion fondet e plota të nevojshme për realizimin e punëve, duke qenë përpara një kontrate prokurimi me kohëzgjatje jo shumë vjeçare, sipas DST por dhe Kontratës së lidhur për afat përfundimi të punimeve të parashikuar për 56 ditë kalendarike.

Fakti se nga AK në DST në Njoftimin e Kontratës është përcaktuar:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 17,499,987 lekë pa TVSH.

Vlera e financimit për vitin 2022 është: 6,666,653.7 lekë pa TVSH dhe për vitin 2023 : 10,833, 333.3 lekë pa TVSH

Kohëzgjatja në dite : 56 dite kalendarike duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.

Një gjë e tillë është në kundërshtim me: Paragrafin 2 të nenit 77 ”Urdhëri i Prokurimit” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën citohet:

“Pas përlllogaritjes së fondit limit sipas nenit 76, të këtyre rregullave, titullari i autoritetit/entit kontraktor nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë:

-fondin e përlllogaritur të vitit buxhetor, si dhe fondin total të përlllogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare dhe marrëveshjes kuadër;”.

(Në rastin konkret nuk jemi përpara kontratave shumëvjeçare apo marrëveshjes kuadër)

Bie në kundërshtim dhe me pikën 2 të nenit 85 ”lidhja e kontratës” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën citohet:

2.Lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit/entit kontraktor.

Bie në kundërshtim dhe me pikën 1 dhe 3 të nenit 106 “Kohëzgjatja e kontratës” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, përcakton se:

“1.Autoriteti/enti kontraktor për fondet buxhetore prokuron kontrata bazuar në fondin e një viti buxhetor.

3.Autoriteti/enti kontraktor nuk lidh kontrata shumëvjeçare për punë, mallra ose shërbime, për të cilat bëhen planifikim dhe përdorime vjetore, që gjenden lehtësisht në treg dhe mund të prokurohen normalisht.”

Një veprim i tillë bën që të ulet konkurrenca dhe njëkohësisht të përdoret legjislacioni I Prokurimit Publik si një legjislacion që mundëson AK të realizojë punë apo blerje pa patur buxhetin në dispozicion.

Gjë e cila ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit si dhe titullarin e Autoritetit Kontraktor të cilët përgatisin Urdhërat e Prokurimit dhe janë përgjegjës për të gjithë procedurat e prokurimit, konform ndër të tjera dhe nenit 21 “Autoriteti Kontraktor (AK)” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në pikën 1 të të cilit citohet: *1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Dhe në pikën 5 të tij citohet:

“5.Të gjitha proceset e parashikuara në këtë nen zhvillohen nën mbikëqyrjen e titullarit të autoritetit kontraktor ose personit të autorizuar prej tij.

Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike.”.

5. Objekti: “Ndërhyrje në infrastrukturën e rrugës Vasilika Gogu dhe Hysen Dervishi”

Kjo procedurë prokurimi ka nisur me nxjerrjen nga ana e titullarit të AK të Urdhërit të Prokurimit nr. 218 datë 30.08.2022 për prokurimin e këtij objekti me fond limit me vlerë prej: 16,256,952 lekë pa TVSH ose 19,508,342.4 me TVSH.

Fondi nga të ardhurat e Bashkisë Lushnje i miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Lushnje me nr 101 date 23.12.2021 “ Mbi miratimin e buxhetit te vitit 2022”. Përcaktuar si procedure prokurimi me mjete elektronike të formës “Procedure e hapur ” .

Nga Njësia e Prokurimit është hartuar procesverbali për argumentimin e miratimin e specifikimeve teknike dhe kriteret e kualifikimit dhe janë përgatitur DST në të cilën përcaktohet data e tenderit e cila është ndryshuar pas ndërhyrjes nga AK me ndryshim në DST në preventiv duke përcaktuar datën e hapjes 23.09.2022 me afat punimesh 42 ditë kalendarike.

Në DST Në Njoftimin e Kontratës është përcaktuar:

2.10.Përshkrimi i shkurtër i kontratës / Marrëveshjes Kuadër :

1.Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 16,256,952 lekë pa TVSH.

Vlera e financimit për vitin 2022 është: 9,166,666.67 lekë pa TVSH dhe për vitin 2023: 7,090,285.33 lekë pa TVSH.

3.Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Lushnje të miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Lushnje me nr.101 datë 23.12.2021 “ Mbi miratimin e buxhetit te vitit 2022”

Kohëzgjatja në ditë: 42 (dyzet e dy) ditë kalendarike.

Për këtë procedurë prokurimi Komisioni i Vleresimit te Ofertave është ngritur me urdhërin e titullarit të AK nr. 219 , date 30.08.2022, i përbërë nga 3 anëtarë sipas përcaktimit në tabelën e mësipërme. Rezulton se në këtë procedurë prokurimi kanë paraqitur ofertat e tyre 8 OE nga të

cilët janë skualifikuar 3 prej tyre dhe janë kualifikuar 5 të tjerë dhe me ofertuesin më të ulët të paraqitur në këtë procedurë prokurimi e konkretisht: **BOE “K.M.K ”& “C. M” shpk me ofertën ekonomike prej: 9,520,833** lekë pa tvsh është lidhur Kontrata nr. 11407 Prot, datë 28.12.2022. Operatorët ekonomik që kanë paraqitur ofertë dhe që janë skualifikuar dhe kualifikuar nga ana e KVO si dhe vlerat e ofertës ekonomike pa tvsh të tyre paraqiten si më poshtë:

1. “ N ” shpk Tiranë, vlera e ofertës: 10,354,184 Lekë.
2. “B” shpk Fier vlera e ofertës:11,130,291 Lekë.
3. “D” Tiranë Shpk , vlera e ofertës: 12,454,342.8 Lekë.
4. “E shpk”, Tiranë vlera e ofertës: 12,811,149 Lekë. **(skualifikuar)**
5. “K.” Shpk Fier & “M” shpk Fier, vlera e ofertës: 9,520,833 Lekë. **(fituesi me të cilin është lidhur kontrata)**
6. “LL” shpk Lushnje vlera e ofertës: 13,354,100 Lekë.
7. “S” shpk,Fier vlera e ofertës: 13,879,007 Lekë. **(Skualifikuar)**
8. “S” shpk Tiranë vlera e ofertës: 12,041,242.8 Lekë. **(Skualifikuar)**

Nga llogaritjet e kryera nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka rezultuar anomalisht e ulët një nga ofertat e kualifikuara e konkretisht ajo e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik: . “K.” Shpk Fier & “C” shpk Fier.

Nga AK i është kërkuar me shkresën nr.8608 prot. datë 30.09.2022 justifikimi i ofertes të paraqitur prej tyre e cila ka rezultuar anomalisht e ulët dhe dokumentacioni mbështetës e sqarues. Arsyetimi i paraqitur nga ofertuesi elektronikisht me shkresën 8608/1 prot. Datë 04.10.2022 është pranuar nga AK. Në përfundim të procedurave ligjore të prokurimit nga KVO është vendosur renditja në vendin e parë të ofertuesit (BOE) me ofertën më të ulët të paraqitur dhe me të cilin nga AK është lidhur dhe kontrata me nr. nr. 11407 Prot, datë 28.12.2022.

Si në DST ashtu dhe në Kontratën e lidhur me operatorin fitues ku është përcaktuar grafiku i pagesës konstatohet se, për këtë prokurim nga AK nuk kanë qenë në dispozicion fondet e plota të nevojshme për realizimin e punëve, duke qenë përpara një kontrate prokurimi me kohëzgjatje jo shumë vjeçare, sipas DST por dhe Kontratës së lidhur për afat përfundimi të punimeve të parashikuar për 42 ditë kalendarike.

Fakti se nga AK në DST në Njoftimin e Kontratës është përcaktuar:

*Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **16,256,952 lekë pa TVSH.***

*Vlera e financimit për vitin 2022 është :**9,166,666.67 lekë pa TVSH dhe për vitin 2023: 7,090,285.33 lekë pa TVSH.***

*Kohëzgjatja në dite: **42 ditë kalendarike.***

Një gjë e tillë është në kundërshtim me: Paragrafin 2 të nenit 77 ”Urdhëri i Prokurimit” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën citohet:

“Pas përlllogaritjes së fondit limit sipas nenit 76, të këtyre rregullave, titullari i autoritetit/entit kontraktor nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë:

***-fondin e përlllogaritur të vitit buxhetor,** si dhe fondin total të përlllogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare dhe marrëveshjes kuadër;”.*

(Në rastin konkret nuk jemi përpara kontratave shumëvjeçare apo marrëveshjes kuadër)

Bie në kundërshtim dhe me: pikën 2 të nenit 85 ”lidhja e kontratës” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën citohet:

2.Lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit/entit kontraktor.

Veprim në kundërshtim dhe me pikën 1 dhe 3 të nenit 106 “Kohëzgjatja e kontratës” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, përcakton se:

“1. Autoriteti/enti kontraktor për fondet buxhetore prokuron kontrata bazuar në fondin e një viti buxhetor.

3. Autoriteti/enti kontraktor nuk lidh kontrata shumëvjeçare për punë, mallra ose shërbime, për të cilat bëhen planifikim dhe përdorime vjetore, që gjenden lehtësisht në treg dhe mund të prokurohen normalisht.”

Një veprim i tillë bën që të ulet konkurrenca dhe njëkohësisht të përdoret legjislacioni i Prokurimit Publik si një legjislacion që mundëson AK të realizojë punë apo blerje pa patur buxhetin në dispozicion.

Gjë e cila ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit si dhe titullarin e Autoritetit Kontraktor të cilët përgatisin Urdhërat e Prokurimit dhe janë përgjegjës për të gjithë procedurat e prokurimit, konform ndër të tjera dhe nenit 21 “Autoriteti Kontraktor (AK)” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në pikën 1 të të cilit citohet: *1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Dhe në pikën 5 të tij citohet: 5. Të gjitha proceset e parashikuara në këtë nen zhvillohen nën mbikëqyrjen e titullarit të autoritetit kontraktor ose personit të autorizuar prej tij. Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike.

Ajo që konstatohet nga auditimi është dhe fakti se: Dosjet fizike të procedurave të prokurimit të paraqitura për auditim nuk janë të inventarizuara në mënyrë të rregullt dhe të sistemuara nga ana dokumentare për të gjitha fazat e procedurës deri në zbatimin e kontratës, Përgjegjësi kjo e Personit përgjegjës të prokurimit sipas nenit 74 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, gjë që kërkon një ri inventarizim më të plotë e të kujdesshëm nga ana e AK.

Titulli i gjetjes	Mbi rregullshmërinë e Inventarizimit e administrimit të plotë të dokumentacionit në dosjet e procedurave të prokurimit.
Situata	Nga auditimi i procedurave të prokurimeve të zhvilluara nga Autoriteti kontraktor (Bashkia Lushnje) për vitin 2022 rezultoi se, Dosjet fizike të procedurave të prokurimit të paraqitura për auditim por dhe e gjithë praktika e ndjekur ndër vite nga ky Autoritet Kontraktor nuk janë të inventarizuara në mënyrë të rregullt dhe të sistemuara nga ana dokumentare për të gjitha fazat e procedurës deri në zbatimin e kontratës, Përgjegjësi kjo e Personit përgjegjës të prokurimit sipas nenit 74 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, gjë që kërkon një ri inventarizim më të plotë e të kujdesshëm nga ana e AK.
Kriteri	Neni 74 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti	Ndikon në mos dokumentimin e evidentimin në mënyrë të plotë të të gjitha procedurave të ndjekura nga AK për realizimin e procedurës së prokurimit duke mos mundësuar realizimin auditimit nga strukturat kompetente.
Shkaku	Mos zbatim i rregullt i detyrimeve ligjore nga ana e NJP.
Rëndësia	E mesme
Rekomandim	Njësia e Prokurimit të marrë masat që në përfundim të procedurave të prokurimit të inventarizohet në mënyrë të rregullt, të plotë e kronologjike të gjithë dokumentacionit që lidhet me procedurën e prokurimit.

Titulli i gjetjes	Mbi rregullshmërinë e hartimit nga NJP i kërkesave specifike për kualifikim përsa i përket certifikatave të kërkuara, në DST për procedurat e prokurimeve për punë publike.
Situata	<p>Nga auditimi konstatohet se në procedurën e prokurimit me objekt: “Sistemim, Asfaltim i rrugës Jakov Xoxa dhe vazhdimi pas Unazës ” nga AK në DST në kriteret e veçanta për kualifikim, në pikën 2.5.b – ka kërkuar: <i>Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit OHSAS 18001-2007 ose ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).</i> Nga AK është gabuar pasi Çertifikata e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit OHSAS 18001-2007 është shfuqizuar dhe për rrjedhim do të duhej të kërkonte vetëm çertifikatën për standartin e përditësuar (ISO 45001:2018). Një kërkesë e tillë ka rezultuar edhe në dy procedurat e prokurimit të zhvilluara nga ky Autoritet Kontraktor e konkretisht në procedurat: “Ndërhyrje në infrastrukturën e rrugës Unazë e ish depos së Duhanit” dhe në procedurën “Sistemim, Asfaltim segmentit rrugor : “Taulla Sinani- Esma Dervishi”. Për këto dy procedura është ndërhyrë nga APP (Kordinatori) dhe nga AK është korigjuar nëpërmjet ndryshimeve të dokumentave të tenderit.</p> <p>Përgjegjësi kjo e AK sipas nenit 78 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën kërkohet që çdo kriter i veçantë dhe specifik teknik duhet të argumentohet teknikisht e ligjërishit. Kjo me qëllim në këtë rast mosdikimin në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar nga Operatorët Ekonomik për një vlerësim sa më korrekt nga KVO në procesin e vlerësimit të ofertave të paraqitura në procedurat e prokurimit.</p>
Kriteri	Neni 78 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Mund të ndikojë në problematikë të panevojshme në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar nga Operatorët Ekonomik si dhe në procesin e vlerësimit, nga KVO, të ofertave të paraqitura në procedurat e prokurimit.

Shkaku	Mos zbatim i rregullt i detyrimeve ligjore nga ana e NJP.
Rëndësia	E mesme
Rekomandim	Njësia e Prokurimit ti argumentojë një për një të teknikisht e ligjërisht duke patur për bazë objektin e prokurimit si dhe zërat e volumet e punës të parashikuara në preventiv që të gjitha kërkesat për kualifikim të kërkuara si pjesë e Dokumenteve Standarde të Tenderit, me qëllim provimin nga Operatoret Ekonomik të kapaciteteve teknike e profesionale duhet.

Titulli i gjetjes	Lidhja e kontratave për punë publike në përfundim të procedurave të prokurimit.
Situata	<p>Nga auditimi është konstatuar se në 5 procedurat e prokurimit të trajtuara si më sipër në këtë Raport Auditimi konkretisht:</p> <p>1.Procedura me objekt: “Ndërtimi i tregut në lagjen Xhevdet Nepravishta” me nr. REF-22598-03-18-2022; 2.Procedura me objekt: “Ndërhyrje në infrastrukturën e rrugës Unazë e ish depos së duhanit” me nr. REF-36236-07-13-2022; 3.Procedura me objekt: “Sistemim, Asfaltim i rrugës Shpresa plus rrugës së Repartit në Zhamë Sektor” me nr. REF- 27742-05-06-2022; 4.Procedura me objekt: “Sistemim, Asfaltim i rrugës Jakov Xoxa dhe vazhdimi pas unazës” me nr. REF-34084-06-23-2022 dhe 5.Procedura me objekt: “Ndërhyrje në infrastrukturën e rrugës Vasilika Gogu dhe Hysen Dervishi” me nr. REF-40255-08-30-2022,) si në DST ashtu dhe në Kontratat e lidhura me operatorët fitues ku është përcaktuar grafiku i pagesës konstatohet se, në këto prokurime nga AK nuk kanë qenë në dispozicion fondet e plota të nevojshme për realizimin e punëve, duke qenë përpara kontratave prokurimi me kohëzgjatje jo shumë vjeçare, sipas DST por edhe Kontratës së lidhur për afat përfundimi të punimeve të parashikuara nga AK.</p> <p>Ky veprim bën që të ulet konkurenca dhe njëkohësisht të përdoret legjislacioni i Prokurimit Publik si një legjislacion që mundëson AK të realizojë punë apo blerje pa patur buxhetin në dispozicion.</p> <p>Gjë e cila ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit si dhe titullarin e Autoritetit Kontraktor të cilët përgatisin Urdhërat e Prokurimit dhe janë përgjegjës për të gjithë procedurat e prokurimit.</p>
Kriteri	Paragrafi 2 i nenit 77 ”Urdhëri i Prokurimit” ; Pika 2 e nenit 85 “lidhja e kontratës” ; Pikat 1 dhe 3 të nenit 106 “Kohëzgjatja e kontratës” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Krijimi detyrimeve të padrejta për buxhetin e AK si dhe ndikim në konkurrencën në procedurën e prokurimit duke bërë pjesmarrës vetëm ato operatorë ekonomik të cilët marrin përsipër realizimin e punëve me likuiditete të mëvonëshme.
Shkaku	Keqinterpretim i dispozitave ligjore e nënligjore të Prokurimit Publik nga AK.
Rëndësia	E Lartë

Rekomandim	Autoriteti Kontraktor, të marrë masat e nevojshme që në përfundim të procedurave të prokurimit të nënshkruaj kontratën vetëm pasi të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor fondi i nevojshëm për realizimin e kontratës.
-------------------	---

Në lidhje me këtë pikë të trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit është paraqitur observacion nga znj. E.S; z. E. Dh dhe L.L me shkresën nr. 10113/2 prot datë 14.12.2023 e cila është protokolluar në KLSH me Nr.866/4 Prot. datë 18.12.2023.

Prendimi i Subjektit: Në observacion pretendohet se: *Autoriteti kontraktor Bashkia Lushnje i ka nisur procedurat e prokurimit pas miratimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak Lushnje me nr. 101 datë 23.12.2021 “Mbi miratimin e buxhetit të vitit 2022” ku ndër të tjera është përcaktuar dhe vlera e financimit për kontratat e investimeve që do të lidhen përgjatë vitit 2022. E këto veprime janë kryer në mbështetje të Ligjit Nr. 68/2017 “Për Financat e vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar ku në nenin 40 të tijë përcaktohet qartë se kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit projektbuxhetin vjetor dhe si dokumentacion baze dhe shoqërues ndër të tjera janë dhe pikat si më poshtë: Dokumentacioni shoqërues: a) informacionin të detajuar për shpenzimet , sipas klasifikimeve buxhetore; b) Listën e projekteve të investimeve publike, për çdo program, e cila përmban:*

i) koston e plotë të projekteve;

ii) vlerën e financuar deri në fund të vitit buxhetor paraardhës;

iii) vlerën e parashikuar për tu financuar në vitin buxhetor;

iv) vlerën e mbetur për tu financuar në vitet pasardhëse buxhetore;

v) burimet e financimit;

Nga observuesit pretendohet: *Sa më sipër, në Ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar përcaktohet qartë se njësitë e vetëqeverisjes vendore (Ku përfshihet dhe Bashkia Lushnje) mund të lidhë kontrata për të cilat financimi është i shtrirë edhe në vitet pasardhëse.*

Qëndrimi i audituesit: Në dispozitat e Ligjit Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, përcaktohet qartë se njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të lidhin kontrata për të cilat financimi është i shtrirë edhe në vitet pasardhëse, por ajo që konstatohet nga auditimi është fakti se kontratat e lidhura nga kjo bashki në cilësinë e Autoritetit Kontraktor nuk janë kontrata shumëvjeçare në kuptim të Legjislacionit të Prokurimit Publik të trajtuar në materialin auditues. Përsa më sipër këto observime nuk qëndrojnë përsa kohë që nuk jemi përpara kontratave të investimeve shumëvjeçare sipas kërkesave të rregulluara nga Legjislacioni i Prokurimit Publik.

2.5. Mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit

5.1. Mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve zhvillimore, ndërtimore si dhe miratimi i certifikatave të përdorimit.

5.2. Mbi mandat pagesat dhe ballafaqimi me fletën e përlllogaritjes së bërë nga drejtoria e PZHT, në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe rillogaritja e pagesës së bërë në bazë të situacionit përfundimtar të punimeve të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave, etj.

Bashkia e Lushnjes kufizohet në veri me bashkinë e Rrogozhinës, në verilindje me bashkinë e Peqinit, në lindje me bashkinë e Belshit, në juglindje me bashkinë Ura Vajgurore, në jug me bashkinë e Roskovecit, në jugperëndim me bashkinë e Fierit dhe në perëndim me bashkinë e

Në planin e përgjithshëm vendor, sipërfaqja e bashkisë është ndarë në 1,453 njësi strukturore të veçanta dhe për secilën është hartuar një pasaportë, e cila përfshin kushtet e planifikimit.

Gjithashtu, njësitë strukturore, të cilat janë parashikuar nga plani i përgjithshëm të trajtohen me plan të detajuar vendor (PDV) përfshijnë një sipërfaqe prej 136.7 ha në qytetin e Lushnjes dhe 17.2 ha në Njësitë Administrative të zonës rurale.

Përsa më sipër, është parashikuar që të trajtohen me plan të detajuar vendor (PDV) 19 njësi strukturore në qytetin e Lushnjes, 2 njësi strukturore në njësinë administrative Dushk, 2 njësi strukturore në njësinë administrative Kolonje, 2 njësi strukturore në njësinë administrative Fiershegan, dhe 1 njësi strukturore në njësinë administrative Bubullimë.

Në vitin 2022 është miratuar plani i detajuar vendor për njësinë strukturore 1/108 në qytetin e Lushnjes, të miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Nr. 442, datë 18.07.2022.

Në bashkinë e Lushnjes për vitin 2022 janë dhënë 31 leje ndërtimi ose 29 % prej tyre për ndërtim çatie, 29 leje ndërtimi ose 27 % e tyre për shtëpi banimi, 11 leje ndërtimi leje ose 10 % për infrastrukturën publike, 9 leje ndërtimi për magazina bujqësore, 9 leje ndërtimi ose 8 % për rikonstruksione, 6 leje ndërtimi për ndryshime projekti, 4 leje ndërtimi për mure rrethues, 2 leje ndërtimi për ndryshim destinacioni, 2 leje ndërtimi për objekte shërbimi të kombinuar, 1 leje ndërtimi për magazinë jo bujqësore, 1 leje për ndërtim ambulance mjekësore dhe 1 leje për objekt kulturi.

Të gjitha kërkesat dhe procedurat për leje janë realizuar nëpërmjet sistemit elektronik E-Leje.

Në bashkinë Lushnje, gjatë vitit 2022, nga 303 kërkesa për leje ndërtimi janë miratuar gjithsej 227 prej tyre, që sipas llojit të lejes janë ndarë si më poshtë:

Emërtimi i llojit të lejes	Totali i kërkesave	Kërkesa të refuzuara	Kërkesa të miratuara
Leje Ndërtimi	122	16	106
Leje Zhvillimi	46	6	40
Çertifikatë Përdorimi	18	7	11
Deklaratë për kryerje punimesh	117	47	70
Gjithsej	303	76	227

Përsa më sipër, lejet e ndërtimit janë dhënë sipas kërkesave të Ligjit Nr.107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, si edhe të Vendimit Nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.

Taksa e ndikimit të infrastrukturës është mbledhur në zbatim të nenit 46 të Ligjit Nr.107, datë 31.07.2014, i ndryshuar, dhe Vendimit Nr.100, datë 23.12.2021 i Këshillit Bashkiak Lushnje, dhe se nuk rezultojnë diferenca në pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë midis preventivit të paraqitur gjatë marrjes së lejes dhe situacionit përfundimtar me mbarimin e punimeve.

Titulli i gjetjes	Planifikimi i strukturave për informacionin gjeohapësinor (GIS).
Situata	<p>Në vitin 2022 me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Nr. 442, datë 18.07.2022 është miratuar plani i detajuar vendor (PDV) për njësinë strukturore 1/108, e cila ndodhet në Lagjen Karbunarë e Poshtme në njësinë administrative nr.5 të qytetit të Lushnjës.</p> <p>Plani i detajuar vendor, sa më sipër, nuk figuron i azhurnuar në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit në sistemin GIS.</p> <p>Në bashkinë Lushnje rezulton se nuk ka struktura (drejtori/sectorë/njësi) të dedikuara për informacionin gjeohapësinor, gjithashtu nuk janë kryer proceset e grumbullimit, përpunimit dhe përditësimit të informacionit gjeohapësinor.</p>

	<p>Kufizimi në burime, ekspertizë, teknologji, etj, përfundon në një informacion me cilësi të ulët, jo në kohën e duhur dhe që nuk ndihmon në njohjen apo kuptimin e situatës duke zhvleftësuar nevojën për të në të ardhmen.</p> <p>Gjithashtu, meqenëse regjistrimi i pronave të paluajtshme në ASHK Lushnje nuk është dixhitalizuar akoma, mund të ndodhë që lejet e dhëna të jepen ose jo pa ditur pozicionimin e saktë në territor, dhe se në këtë mënyre të sjellin situata problematike, duke hyrë në beteja ligjore për anulimin e këtyre lejeve.</p> <p>Gjithashtu, përdorimi i ortofotos (fotografimi satelitor) në një shumicë rastesh krijon edhe ‘probleme’ për shkak të ballafaqimit me saktësinë e IG, të tilla si psh. me cilësinë e rregjistrimit të pronave në ASHK etj.</p> <p>Në këtë kuptim, mospërdorimi i informacionit gjeohapësinor (IG) për vendimmarrjen në territor bëhet shkak që vendimet që marrim sot të japin efekte negative në të ardhmen.</p>
Kriteri	<p>-pika 4, neni 25 i Ligjit Nr.107, datë 31.07.2014“ Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.</p> <p>- pikat 1, 3,4, neni 55 i Ligjit Nr.107, datë 31.07.2014“ Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.</p> <p>-Pikat 7.3, paragrafi 2.4.1, në Vendimin Nr.402 datë 20.05.2020 “Për miratimin e dokumentit të politikave për qeverisjen e sektorit të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri”.</p>
Ndikimi	Performancë e ulët e informacionit gjeohapësinor dhe mungesa e interesit për përdorimin e tij.
Shkaku	Nuk janë zbatuar kërkesat ligjore për përdorimin e informacionit gjeohapësinor.
Rëndësia	E lartë.
Rekomandim	<p>- Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Lushnje të marrë masa për publikimin në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit të planeve të zhvillimit, që miratohen nga Bashkia si edhe të gjitha akteve që autoriteti përgjegjës për zhvillimin e territorit nxjerr lidhur me vendimet për leje, ato në proces etj.</p> <p>- Kryetari i Bashkisë Lushnje të marrë masa për ngritjen e strukturës (drejtori/sectorë/njësi) të dedikuar për Informacionin Gjeohapësinor, me qëllim rritjen e cilësisë së vendimmarrjes në dhënien e lejeve.</p>

Sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi Znj. E. S me detyrë Kryetare e Bashkisë Lushnje dhe Znj. M. H me detyrë Drejtoare e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit;

2.6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit, Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)

6.1. Mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.

6.2. Mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV; Për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të paarkëtuara nga IMTV.

6.3. Mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimin me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Inspektoriati i mbrojtjes së territorit ushtron aktivitetin e tij në zbatim të Ligjit Nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, si edhe në zbatim të Ligjit Nr.107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.

Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit (IMT) në Bashkinë Lushnje, në strukturën e tij është i përbërë nga 4 punonjës, 1 k/inspektor, 2 inspektorë terreni dhe 1 Jurist.

Për vitin 2022 rezulton se në zbatim të akteve të konstatimit të shkeljes, të hartuara nga ana e inspektoriatit të mbrojtjes së territorit të bashkisë Lushnje janë dhënë, në 61 raste, vendime me gjobë subjekteve në shkelje të ligjit, gjithsej në vlerën prej 11,461,100 lekë.

Sa më sipër, 20 subjekte, në vlerën gjithsej prej 2,205,000 lekë ose 19 % të vlerës totale të gjobave, kanë arkëtuar në mënyrë vullnetare.

Gjithashtu, 32 subjekte, në vlerën gjithsej prej 6,016,100 lekë ose 53 % e totalit të gjobave, janë në proces për arkëtimin e tyre. Për këto subjekte po ndiqen procedurat për arkëtimin e tyre konform kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.

Gjithashtu, 9 subjekte, në vlerën gjithsej prej 3,240,000 lekë ose 28 % të vlerës totale të gjobave, kanë ankimuar vendimet e IMT dhe janë në procese gjyqësore.

Sa më sipër, nga ankimet gjyqësore, në 7 raste vendimet e IMT janë dhënë për punime pa leje ndërtimi, në 1 rast për punime pa leje në kapërcim të afatit të përfundimit të punimeve, si dhe në 1 rast punime ndërtimi me shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit.

Titulli i gjetjes	Rekrutimi i inspektorëve të IMT.
Situata	<p>Inspektoriati vendor i mbrojtjes së territorit në bashkinë Lushnje është i përbërë nga 4 punonjës, k/Inspektori me arsim të lartë akademinë e rendit, 2 inspektorë terreni (njëri me formim juridik dhe tjetri me arsim të mesëm të përgjithshëm) dhe Juristi.</p> <p>Në vitin 2022, struktura e IMT përbëhej nga k/inspektori me arsim të lartë ekonomist, 2 inspektorë terreni me arsim të mesëm të përgjithshëm, si edhe 1 jurist.</p> <p>Inspektorët e IMT, në Bashkinë Lushnje, nuk kanë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit.</p> <p>Mungesa e kontributeve profesionale të IMT ndikon në përmbushjen e detyrave si në drejtim të gjykimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, ashtu edhe në marrjen e vendimeve gjatë ushtrimit të detyrave të tij.</p> <p>Sa më sipër, në Vendimin Nr.118, datë 22.05.2022, nga ana e IMT është vendosur masa e gjobës për punime të kryera pa leje në shtyrje të afatit, për subjektin G.shpk, lagjja Saver, Rajoni nr.5, Lushnje, i cili e ka ankimuar në gjykatë vendimin e sipërcituar.</p> <p>Në Vendimin Nr.16, datë 22.05.2022, nga ana e IMT Lushnje është vendosur masa për pezullimin e punimeve për subjektin e sipërcituar, referuar procesverbalit të konstatimit të shkeljes nr.122, datë 21.05.2022. Ne aktin e pezullimit, sa më sipër, rezulton se punimet janë në fazën përfundimtare, por ato nuk janë specifikuar sipas llojit të tyre nga ana e grupit të inspektimit, gjithashtu nuk është shpjeguar mungesa apo</p>

	<p>ekzistenca e akteve të kontrollit (të kolaudimit) etj. Në rastin kur ndërtimi i objekteve ka përfunduar dhe nuk janë kryer aktet e kontrollit, është njësi vendore, që në zbatim të paragrafit të fundit, neni 12 të Ligjit Nr.8402, datë 10.09.1998 “Për disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, kryen aktin përmbledhës për të gjitha fazat e kontrollit.</p> <p>Nga ana tjetër, veprimi i inspektoriatit bie në kundërshtim me pikën 3, neni 51 të Ligjit Nr.107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, për arsye se nuk ka mundur të bashkëveprojë, në këtë rast, me autoritetin e planifikimit, për rritjen e efektivitetit të inspektimit.</p> <p>Sa më sipër, veprimet dhe mosveprimet e IMT e bashkisë Lushnje dëshmojnë për mungesë të kapaciteteve të mjaftueshme profesionale të IMT.</p>
Kriteri	- neni 11 i Ligjit Nr.9780, date 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”
Ndikimi	Shpenzime të mundëshme me efekt negativ financiar nga proceset gjyqësore në formën e dëmshpërblimeve.
Shkaku	Nuk zbatohen kërkesat ligjore për rekrutimin e inspektorëve të IMTV.
Rëndësia	E lartë.
Rekomandim	Kryetari i Bashkisë Lushnje të marrë masa për rritjen e kontributeve profesionale në inspektoriatin e mbrojtje së territorit, me qëllim rritjen e cilësisë së punës së Inspektoriatit dhe bashkëveprimin me strukturat e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.9708/1 prot., datë 24.11.2023, nga. Znj. E. S, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: *Mbi problematikën e gjetur nga ana juaj, lidhur me organizimin dhe funksionimin e IMT, ju sqarojmë si më poshtë:*

-IMT ka dhënë vendimin për pezullimin e punimeve për subjektin Grenlink me nr.16, datë 22.05.2022 me nr.000016 serie ku është konstatuar kundravajtja administrative për mos përfundimin e punimeve brënda afatit të lejes së ndërtimit, por është harruar t`ju vendoset në dispozicion (gjeni bashkëlidhur me observacionin).

-Lidhur me rekrutimin e inspektorëve të IMT, janë hequr dy inspektorë me arsim të mesëm dhe është rekrutuar një inspektor me arsim të lartë. Aktualisht është njëinspektor me arsim të mesëm që del në pension në fund të vitit 2023.

Oëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Në lidhje me observacionin e bërë, dërguar me shkresën nr. 9708/1prot., datë 24.11.2023 grupi i auditimit sqaron si më poshtë:

- Në Vendimin, nga ana e IMT Lushnje është vendosur masa për pezullimin e punimeve për subjektin e sipërcituar. Ne aktin e pezullimit, nr.16, datë 22.05.2022, nga ana e inspektorëve të IMT nuk janë treguar lloji i punimeve të papërfunduara nga grupi i inspektimit, gjithashtu ekzistenca e akteve të kontrollit (të kolaudimit) etj.

Në këtë mënyrë nuk është përcaktuar qartë nëse punimet e ndërtimit kanë përfunduar, duke pasur parasysh se mund të ketë edhe punime përfundimtare deri në dhënien e certifikatës së përdorimit

nga autoriteti i planifikimit. Në zbatim të nenit 12 të Ligjit Nr.8402, datë 10.09.1998 “Për disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, në rastin kur ndërtimi i objekteve ka përfunduar dhe nuk janë kryer aktet e kontrollit, është njësia vendore, që kryen aktin përmbledhës për të gjitha fazat e kontrollit. Në këtë mënyrë, akti i pezullimit tregon për mungesën e kapaciteteve të nevojshme profesionale të inspektorëve të IMT Lushnje.

-Lidhur me rekrutimin e inspektorëve të IMT, nga ana e grupit të auditimit është kërkuar, që në momentin e rekrutimit të inspektorëve të IMT të respektohen kushtet e nenit 11 të Ligjit Nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale të inspektorëve, dhe jo vetëm kërkesa e arsimit të lartë.

Për sa më sipër kundërshtimet pranohen pjesërisht.

Sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi Znj. E.S me detyrë Kryetare e Bashkisë Lushnje.

2.7. Të ndryshme

Në zbatim të pikës 7 të programit të auditimit: “Të ndryshme të dala gjatë auditimit”, objekt i këtij Raporti, është bërë kërkesa për auditim e qytetarit A. H me adresë Rruga “Marin Barleti” Nd .010,H.1,Ap.2, Lushnje, e protokolluar në KLSH me nr.prot.778, datë 19.08.2022 dhe nr.785, datë 30.08.2022 në lidhje me procedurën e ndjekur me objekt “Për miratimin e dhënies me qira të pronës me numër pasurie 18/4, me emërtim shesh këndi i lojrave L.Park” si edhe shkresa me nr.531/7, datë 07.06.2023, nga Federata Shqiptare e Futbollit në lidhje me zhvillimet dhe ndryshimet ligjore në veprimtaritë sportive për të organizuar sportin në Republikën e Shqipërisë.

Në kërkesë pretendohet se:

Në datën 10.08.2022, kam marrë pjesë në dëgjuesën publike të njoftuar nga Komisioni Juridik dhe situatave emergjente në Këshillin Bashkiak Lushnje me temë “Për miratimin e dhënies me qira të të pronës me numër pasurie 18/4, me emërtim shesh këndi i lojrave L. Park”.

Në lidhje me procedurën e ndjekur nga institucionet publike parashtrij se në shkresën e Këshillit Bashkiak nr. 6574, datë 22.07.2022 me lëndë “Thirrje mbi zhvillimin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak” në datën 28.08.2022, Kryesia e këshillit miratoi rendin paraprak të mbledhjes për muajin Korrik ku në pikën 6 thuhet se dhe projekt - vendim i cituar me sipër “Për miratimin e dhënies me qira të pronës me numër pasurie 18/4 me emërtimin shesh (këndi i lojrave Luna Park) lagjia “Kongresi i Lushnjes”.

Në datën 28.07.2022, ditën kur u zhvillua mbledhja e Këshillit Bashkiak, nuk u shqyrtua pika 6, megjithëse ishte në rendin e ditës. Po në atë ditë Komisioni Juridik dhe i Situatave Emergjente me shkresën nr.6697, date 28.07.2022 ka njoftuar dëgjuesë publike me të njejtën temë. Një ditë më pas shkresa me numër 6727, datë 29.07.2022 në fillim të saj ku paraqitet institucioni që harton shkresën thuhet Këshilli Bashkiak, Lushnje dhe në fund është nënshkruar nga Drejtori Juridik i Bashkisë. Me shkresën numër 6727/1, datë 29.07.2022 paraqitet Projekt vendim nr.72, datë 29.07.2022 “Për miratimin e dhënies me qira të pronës me numër pasurie 18/4 me emërtimin shesh (këndi i lojrave Luna Park) lagjia “Kongresi i Lushnjes”.

1. Pse u bë pjesë e Rendit të Ditës të mbledhjes së datës 28.07.2022 ky Projekt vendim kur duhej të zhvillohej më parë dëgjesa publike?

2. Me çfarë vendimi dhe kur e kush e morri vendimin për heqjen nga shqyrtimi në mbledhjen e datës 28.07.2022 të pikës 6?

3. A është futur pika 6, në rendin e ditës së mbledhjes së datës 28.07.2022 pa dëgjuar më parë dëgjuesë publike?

4. Po në atë ditë pra në 28 korrik që ishte planifikuar si pike e rendit të ditës a ka një shkresë nga Komisioni Këshillit Bashkiak?

5. Në datën 29.08.2022 me shkresën nr.6727 në fillim të saj ku paraqitet institucioni që harton shkresën thuhet Këshilli Bashkiak, Lushnje dhe në fund është nënshkruar nga Drejtori Juridik i Bashkisë. A është ligjore kjo shkresë?

6. A janë 2 Projektvendime për të njëjtën çështje ai i datës 28 dhe 29 korrik?

Njoftimi që ka bërë Komisioni në fjalë nuk është aspak ligjor pasi ky njoftim nuk i përmbush aspak kërkesat e ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe Konsultimin Publik” neni 13, pika 1, germa a,b, dhe c.

Në lidhje me dëgjesën publike që u zhvillua në datën 10.08.2022, merrnin pjesë edhe familjarë të atyre të cilët e kanë pasur me qira këtë ambient për 20 vite dhe lind pyetja a është normale dhe ligjore kjo dëgjesë publike.

Kërkesa e datës 30.08.2022

Përmbajtja e njoftimit në lidhje me nismën vendimmarrëse arrij në përfundimin se shkresa e Komisionit Juridik, Rendit dhe Situatave Emergjente nr.6697, date 28.07.2022 nuk është hartuar siç parashikohet nga ligji. Shkresa nuk përmban kriteret sipas nenit 13 të ligjit nr.146/2014, e cila nuk përmban arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projektaktit, ndikimin që do të ketë, afatin, vendin dhe mënyra me të cilët palët janë të interesuara dhe dërgojnë rekomandimet e tyre, adresa e kontaktit të koordinаторit për njoftimin dhe konsultimin publik të organit publik për mbledhjen e rekomandimeve e komenteve të projektaktit.

Dëgjesa publike është bërë në datën 10.08.2022, ndërsa njoftimi për dëgjesën është në datën 28.07.2022, pra 10 ditë pune dhe jo 20 sipas ligjit.

Pra, është njoftuar një dëgjesë publike nga Komisioni por për temën e kësaj dëgjese nuk kishte Projektvendim në kohën e njoftimit por 1 ditë më pas.

Në shkresën e Këshillit Bashkiak nr.7401/1, date 25.08.2022 citohet se Me shkresën nr 6534, date 21.07.2022 të Kryetares së Bashkisë kërkohet përfshirja në rendin e ditës të mbledhjes së Këshillit Bashkiak për muajin Korrik 2022, pikat sipas kërkesës. Një ndër pikat ishte edhe relacioni 6446, datë 19.07.2022 si dhe projektvendimi nr.65, datë 19.07.2022 “Për miratimin e dhënies me qira të pronës me numër pasurie 18/4 me emërtimin shesh Këndi i lojrave Luna Park”.

Pra, kërkesën për përfshirjen në rendin ditës së mbledhjes së Këshillit të muajit Korrik e ka bërë Kryetarja e Bashkisë ndaj lind pyetja:

-Si mund të kërkonte Kryetarja e Bashkisë përfshirjen në rendin e ditës kur për këtë çështje më përpara duhej të zhvillohej dëgjesa publike?

-A është këshilluar Kryetarja e Bashkisë me stafin e saj ligjor për këtë çështje përpara se të bënte kërkesën për përfshirjen e çështjes në fjalë në rendin e ditës të mbledhjes së muajit Korrik?

Nga auditimi konstatohet se:

-Me datë 27.07.2022 Komisioni Juridik dhe Situatave Emergjente ka zhvilluar mbledhjen e tij ku ka konstatuar se pika 6 kërkonte konsultim publik në bazë të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 54 germa “e”, “Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak” dhe neni 18 “Seanca e këshillimit me bashkësinë” pikat 1,2 (kjo e dokumentuar me procesverbalin përkatës). Ky Komision në cilësinë e Komisionit përgjegjës i ka propozuar Këshillit Bashkiak heqjen nga rendi i ditës të pikës 6, për t’iu nënshtruar detyrimeve ligjore të konsultimit publik sipas pikave të cituara me sipër.

-Me shkresën nr. 6534, datë 21.07.2022 me lëndë “Kërkesë” të Kryetares së Bashkisë kërkohet përfshirja në rendin e ditës të mbledhjes së Këshillit Bashkiak për muajin Korrik 2022, pikat sipas kërkesës. Një ndër pikat në rend dite ishte edhe relacioni nr. 6446, datë 19.07.2022 si dhe projekt vendimi me numër 65, datë 19.07.2022 “Për miratimin e dhënies me qira të pronës me numër pasurie 18/4 me emërtimin shesh (këndi i lojrave Luna Park) lagjja “Kongresi i Lushnjes”.

Në mbledhjen e Këshillit të datës 28.07.2022 Këshilli Bashkiak ka hequr nga rendi i ditës pikën 6 “Për miratimin e dhënies me qira të pronës me numër pasurie 18/4 me emërtimin shesh (këndi i lojrave Luna Park), lagjia “Kongresi i Lushnjes”. Kjo në zbatim të *Rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak nr. 37, datë 24.04.2020 neni 65 “Hartimi dhe miratimi i rendit të ditës së mbledhjes së këshillit pika 11, ku citohet: Rendi i ditës miratohet nga Këshilli. Para propozimit për të aprovuar rendin e ditës, Kryetari/Kryesuesi i drejtohet këshilltarëve nëse dëshirojnë që një pikë e rendit paraprak të ditës të paraqitur të hiqet apo të shtohet një pikë tjetër.* Pas mbledhjes së Këshillit Bashkiak është mbledhur Kryesia e Këshillit ku me vendim nr. 3, datë 28.07.2022 ka vendosur për fillimin e procedurës së konsultimit publik për projekt vendimin “Për miratimin e dhënies me qira të pronës me numër pasurie 18/4 me emërtimin shesh (këndi i lojrave L. Park), lagjia “Kongresi i Lushnjes” si dhe ngarkon Komisionin Juridik dhe Situatave Emergjente, Koordinatorin për konsultimin publik për planifikimin dhe realizimin e këtij konsultimi duke përcaktuar afatet përkatëse të realizimit të këtij procesi, duke u asistuar nga Sekretariati i Këshillit. Po në datën 28.07.2022 pas mbledhjes së këshillit (të kryesisë) Kryetari i Komisionit Juridik dhe Situatave Emergjente, kanë nënshkruar shkresën nr. 6697, datë 28.07.2022 me lëndë: Dëgjësë publike me temë “Për miratimin e dhënies me qira të pronës me numër pasurie 18/4 me emërtimin shesh (këndi i lojrave L. Park), lagjia “Kongresi i Lushnjes” si dhe kalendarin e konsultimeve publike. Pavarësisht se projekt-vendimi i publikuar për konsultim ka datën 29.07.2022 këshilltarët ishin njohur me projekt vendimin e datës 19.07.2022 ku u hoq nga rendi i ditës, por Këshilli Bashkiak ka parashtruar për konsultim projektin e ri të ardhur nga Bashkia ku tematika ishte e njejtë. Pas këtyre procedurave më datë 10.08.2022 Këshilli Bashkiak në bashkëpunim me Bashkinë Lushnje kanë zhvilluar konsultimin publik me qytetarët, të cilët kanë pasqyruar qëndrimin e tyre edhe në kërkesat e drejtuara këshillit apo bashkisë me shkrim.

-Duke u nisur edhe për sa i referoheni ligjit 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” konkretisht nenit 13 ku pretendohet se nuk është zbatuar ky nen, sqarohet se për nenin 13, pika 1 “a”, arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projekt aktit, si dhe ndikimi që ai do të ketë, nuk është pasqyruar në njoftim pasi gjendet tek relacioni dhe projektvendimi i ardhur nga bashkia. Për sa i përket pikës 1 “b” afati, vendi dhe mënyra me të cilën palët paraqesin rekomandimet, vetë kërkesë-ankesa juaj drejtuar këshillit bashkiak Lushnje dhe bashkisë Lushnje vërteton se kjo pikë është e përmbushur. Gjithashtu, në pikat 1 dhe 2 të nenit 11 “Mënyra e njoftimit dhe marrja e komenteve dhe e rekomandimeve” të ligjit 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” ku në regjistrin elektronik të konsultimeve publike të këshillit bashkiak Lushnje, gjendet edhe ky projekt akt i publikuar. Për sa i përket pikës 2 të nenit 11, rekomandimi juaj është marrë si në formë verbale ashtu edhe me shkrim regjistruar në procesverbalin e takimit publik nr. 6999/1, datë 10.08.2022 i cili rezulton i nënshkruar nga ankuesi.

-Për sa i përket pikës 1 “c” Adresa e kontaktit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik konstatohet se këto të dhëna janë të publikuara në faqen web të Bashkisë Lushnje me të gjithë informacionin e nevojshëm.

- Për sa i përket pikës 1 “ç”, “Vendi dhe data e organizimit të takimit publik”, këto të dhëna janë në njoftimin publik të bërë nga Komisioni Juridik dhe Situatave Emergjente me shkresën nr.6697, datë 28.07.2022 ku përcaktohet, dita, data, ora dhe vendi i konsultimit publik. Sa i takon pikës 2

neni 13 të ligjit 146/2014 rezulton se i gjithë materiali i nevojshëm për konsultim ishte pasqyruar në faqen facebook të këshillit bashkiak dhe nëse do të kërkohej informacion shtesë do të vihej në dispozicion.

- Për sa i përket pikës 2, se në vendimin e këshillit bashkiak nr. 36, datë 24.04.2020 “Mbi miratimin e rregullores se marrëdhënieve të këshillit bashkiak me publikun dhe median (konsultimeve) neni 31 “Përgatitja e njoftimit dhe e takimeve këshillimore me bashkësinë” pika 3, citohet se “Njoftimi bëhet publik në faqen e internetit të Bashkisë në median sociale të Këshillit në tabelën e shpalljeve në ndërtesën kryesore të Bashkisë jo me vonë se 10 ditë para mbajtjes së takimit. Pra 10 ditë kanë qenë në dispozicion për të gjithë të interesuarit të konsultoheshin me materialin, *këshilli bashkiak nuk ka respektuar kohën e njohjes me materialin e cila është 20 ditë.*

Në lidhje me marrjen pjesë në këte konsultim edhe të familjarëve të atyre që e kanë pasur me qira për 20 vjet këtë objekt, konsultimet publike janë të hapura për të gjithë qytetarët e Bashkisë Lushnje, grupe interesi, përfaqësues nga shoqëria civile, biznes, media, etj.

Sa i takon shkresës nr.6727, datë 29.07.2022 si edhe projektvendimit nr.6727/1, datë 29.07.2022 për këtë qëllim, rezulton se ato janë të nënshkruara nga drejtori Juridik dhe logo e shkresës është ajo e Këshillit Bashkiak.

Ankesa II

Me shkresën nr.531/7, datë 07.06.2023, është depozituar ankesa nga Federata Shqiptare e Futbollit në lidhje me zhvillimet dhe ndryshimet ligjore në veprimtaritë sportive për të organizuar sportin në Republikën e Shqipërisë, me qëllim implementimin e këtyre ndryshimeve në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Në lidhje me këtë kërkohej si më poshtë:

Në datën 29.07.2020, kanë hyrë në fuqi ndryshimet në ligjin nr.79/2017 “Për Sportin”. Bazuar në nenin 22 të ligjit 105/2020, datë 29.07.2020 të gjitha institucionet publike qendrore dhe vendore, të cilat kanë në zotërim aksione të shoqërive tregtare sportive, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji i nxjerrin ato në shitje në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Pas përfundimit të këtij afati, institucionet publike qendrore dhe vendore nuk mund të zotërojnë aksione të shoqërive tregtare sportive.

Aktualisht, edhe pse ka kaluar më shumë se 1 vit nga hyrja në fuqi e ndryshimeve ligjore, në të dhënat e regjistrit tregtar të Shoqërisë “Klubi i Futbollit Lushnja 1930” sh.a, rezulton se Bashkia Lushnje është zotëruese e 100% të aksioneve të saj.

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se nga Bashkia Lushnje nuk kanë filluar ende procedurat për kalimin në shitje të “Klubit të Futbollit Lushnja 1930” sipas procedurave ligjore dhe nga periudha që klubi sportiv duhej të kalonte procedurat e shitjes, për këtë qëllim janë disbursuar fonde nga Bashkia Lushnje në vlerën 120,000,000 lekë.

Titulli i Gjetjes	Ndryshimet në veprimtaritë sportive
Situata	Në datën 29.07.2020, kanë hyrë në fuqi ndryshimet në ligjin nr.79/2017 “Për Sportin”, edhe pse ka kaluar më shumë se 1 vit nga hyrja në fuqi e ndryshimeve ligjore, në të dhënat e regjistrit tregtar të Shoqërisë “Klubi i Futbollit Lushnja 1930” sh.a, rezulton se Bashkia Lushnje është zotëruese e 100% të aksioneve të saj. Bashkia Lushnje nuk ka filluar ende procedurat për kalimin në shitje të “Klubit të Futbollit Lushnja 1930” sipas procedurave ligjore dhe nga periudha që klubi sportiv duhej të kalonte procedurat e shitjes, për këtë

	qëllim janë disbursuar fonde nga Bashkia Lushnje në vlerën 120,000,000 lekë.
Kriteri	ligji nr.79/2017 “Për Sportin”, i ndryshuar, neni 22 i ligjit 105/2020, datë 29.07.2020.
Ndikimi/Efekti	Ulje e të ardhurave të Bashkisë
Shkaku	Neglizhencë nga strukturat drejtuese
Rëndësia	E lartë
Rekomandim	Kryetari i Bashkisë, Këshilli Bashkiak dhe strukturat drejtuese të marrin masa për rivlerësimin e asetëve të “Klubi i futbollit Lushnja 1930” si edhe fillimin e procedurave për shitje referuar legjislacionit në fuqi me qëllim uljen e shpenzimeve të kryera nga Bashkia.

Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se:

-Bashkia Lushnje nuk ka hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike. Një problematikë tjetër e evidentuar është mungesa e programeve të trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës.

Plani vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit nuk është i shoqëruar me buxhet të planifikuar për trajnime.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

-Titullari nuk merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga Auditi i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese.

-Mungon ndarja e proceseve të punës dhe përcaktimi i detyrave që ka secili punonjës. Drejtoria Juridike nuk bashkëpunon me drejtoritë e tjera si Drejtoria e Financës, Drejtoria e Aseteve etj, për të zbatuar detyrat funksionale.

-Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm” i cili përcakton se “Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm.

-Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin, në këto kushte, evidentohet se Bashkia Lushnje nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime.

-Bashkia Lushnje nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së

të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Ruajtja e të dhënave bëhet në mënyrë shkresore dhe elektronike.

- Në Bashkinë Lushnje mungojnë rregullat e brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, por është hartuar plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

-Në Bashkinë Lushnje aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të performancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave të përshtatshëmrisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

-Njësia e Auditit të Brendshëm ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara. Bashkia Lushnje nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi.

-Nuk janë ndërtuar gjurmë auditimi për proceset kryesore të punës. Gjurmë auditimi ka vetëm Drejtoria Ekonomike, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, neni 8, pika 8/a, 8/b; neni 9/3; neni 10; neni 12/3; neni 16; neni 18/1; neni 21/2; neni 27, Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1, Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 ‘*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*’, Vendimi nr. 142, datë 12.3.2014 ‘*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*’, neni 24; neni 35 dhe Ligji nr. 119/2014 “*Për të drejtën e informimit*” neni 4; neni 8 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 16-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.Rekomandim: Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme që të njohë punonjësit me aktet ligjore dhe nënligjore lidhur me MFK-në dhe të përcaktojë detyra të qarta mbi zbatimin e tyre.

Menjëherë

1.2.Rekomandim: Titullari i institucionit të ngrejë një grup pune i cili të nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin e komponentëve të MFK-së, të hartojë një plan pune për zbatimin e menjëhershëm të tyre dhe të ndjekë me rigorozitet aplikimin dhe zbatimin e të gjithë komponentëve të MFK-së.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2022, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete që kryen Bashkia Lushnje, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Drejtoria Ligjore, Drejtoria e Taksave, Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Urbanistikës, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Shërbimeve, auditime të teknologjisë së informacionit etj. Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit dhe Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik, nuk është hartuar në përputhje me formatin e paraqitur në Manualin të Auditimit të Brendshëm, *Programi për sigurimin e brendshëm të cilësisë të drejtorisë së auditimit të brendshëm*, nuk ka të përcaktuara mjetet që do të përdoren për monitorim të vazhdueshëm dhe vetëvlerësim periodik, të cilat duhet të mbulojnë të gjitha fazat e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, me qëllim analizimin e nivelit të zbatimit të indikatorëve të performancës. Programit të miratuar i mungon komponenti “*Reagimet e subjektit të audituar*”

-Nuk dokumentohet procesi i ndarjes së detyrave/sistemeve për tu vlerësuar, sipas drejtimeve të auditimit për secilin anëtar të grupit të punës, dokument ky i nevojshëm për vlerësimin e punës për secilin auditues.

-Audituesit e brendshëm nuk janë trajnuar në fushat e planifikuara në Planin Strategjik të Auditimit, miratuar me shkresën nr. 7715, datë 15.10.2021 dhe trajnime mbi menaxhimin e riskut.

-NJAB në periudhën objekt auditimi ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara;

-Raportet e Auditimit nuk kanë në përmbledhjen ekzekutive të përfshirë një përshkrim të shkurtër të subjektit sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

-Dosjet e auditimit nuk përmbajnë “Dokumentet e mbledhura përpara fillimit të angazhimit të auditimit” sipas kërkesave të MAB.

-Mungon Memorandumi drejtuar Titullarit të Bashkisë mbi gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet, si dhënia e opinionit mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit dhe cilat sisteme janë vlerësuar me risk (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 16-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1.Rekomandim: Njësia e Auditimit të Brendshëm, të marrë masa për verifikimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e përfunduara, për të ndjekur në vijimësi ecurinë e zbatimit të tyre si dhe për të informuar Titullarin e Institucionit mbi rezultatet e auditimeve, mbi masat e marra nga subjekti i audituar si dhe shkallën e realizimit të tyre.

2.2.Rekomandim: Njësia e Auditimit të Brendshëm, gjatë veprimtarisë audituese të marrë masa të kryejë auditime në drejtori që paraqesin risk të lartë dhe që nuk janë audituar në këtë Bashki, si edhe të plotësojë dosjen e auditimit sipas kërkesave të përcaktuara në Manualin e Auditimit, me qëllim kryerjen e misionit të auditimit që i shërben përmirësimit të vazhdueshëm të veprimtarisë së institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në datën 29.07.2020, kanë hyrë në fuqi ndryshimet në ligjin nr.79/2017 “Për Sportin”, edhe pse ka kaluar më shumë se 1 vit nga hyrja në fuqi e ndryshimeve ligjore, në të dhënat e regjistrit tregtar të Shoqërisë “Klubi i Futbollit Lushnja 1930” sh.a, rezulton se Bashkia Lushnje është zotëruese e 100% të aksioneve të saj. Bashkia Lushnje nuk ka filluar ende procedurat për kalimin në shitje të “Klubit të Futbollit Lushnja 1930” sipas procedurave ligjore dhe nga periudha që klubi sportiv duhej të kalonte procedurat e shitjes, për këtë qëllim janë disbursuar fonde nga Bashkia Lushnje në vlerën 120,000,000 lekë. me ligjin nr.79/2017 “Për Sportin”, i ndryshuar, neni 22 i ligjit 105/2020, datë 29.07.2020 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 117-121, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, Këshilli Bashkiak dhe strukturat drejtuese të marrin masa për rivlerësimin e asetëve të “Klubi i futbollit Lushnja 1930” si edhe fillimin e procedurave për shitje referuar legjislacionit në fuqi me qëllim uljen e shpenzimeve të kryera nga Bashkia.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i programimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2022 u konstatua se:

a. Realizimi i buxhetit për vitin 2022 është 1,739,911 mijë lekë nga 2,069,652 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 85%. Në mosrealizim kanë ndikuar realizimi në nivele jo të kënaqshme i zërit 602 “Shpenzime operative” në masën 71%, zërit 230-231 “Shpenzime për investime” në masën 35%, i cili ka ardhur nga mosrealizimi i një projekti të financuar nga Agjencia Kombëtare

e Mbrojtjes Civile dhe nga realizimi me vonesë i procedurave të prokurimit të 15 projekteve të reja të financuar nga Bashkia.

b. Detyrimet e papaguara në fund të vitit 2022 paraqiten në shumën 35,818,782 lekë, ku vlera prej 14,826,175 lekë i përket Aparatit të Bashkisë dhe vlera prej 20,279,807 lekë i përket Ndërmarrjes së Pasurisë Publike. Detyrimet e papaguara janë në masën 2.58 % të shpenzimeve të planifikuara, të cilat janë ulur krahasuar me fund vitin 2021, që ishin në shumë të konsiderueshme prej 98,540,609 lekë. Detyrimet e papaguara rakordojnë me gjendjet e llog. të klasës 4 të bilancit të vitit 2022, si dhe me raportimin në MFE të vitit 2022.

c. Financimi i buxhetit vjetor 2022 është bërë në masën më të madhe prej 73.9% nga Buxheti i Shtetit (transferta e pakushtëzuar dhe transferta e kushtëzuar e transferta specifike) dhe 26.1% nga të ardhurat e veta, pasi të ardhurat e mbledhura nga taksat dhe tarifatat vendore janë në nivel të ulët në krahasim me të ardhurat që siguron njësitë vendore nga burime të tjera. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 43 paragrafi 4,47,48,52; ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40/h,42; Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Kreu “Detyrimet e prapambetura të Njësitëve të Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 82-91; ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 12 pika 3 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 39-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1.Rekomandim: Strukturat drejtuese të Bashkisë Lushnje, nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe në bashkëpunim me Menaxheret e Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme në mënyrë që, programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor të jenë sa më të argumentuara, si dhe të kujdesen për realizimin e projekteve të investimeve të planifikuara, sipas prioriteteve strategjike, duke eliminuar vonesat në procedurat e prokurimit, në lidhjen e kontratave, në rritjen e bashkëpunimit me operatorët ekonomikë për përfundimin dhe dorëzimin e punimeve në afat, sigurimin e mbërritjes së faturave në institucion dhe likuidimin e tyre, duke eliminuar limitimin e likuidimeve për anagazhime të marra. Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta. Për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material të plotë për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të pa likuiduara të prapambetura, të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Bashkia Lushnje ka 4 njësi shpenzuese të cilat janë Aparati dhe 3 institucione të varësisë si: Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Pasurisë Publike, Qendra e Kulturës dhe Klubi i Sportit dhe Qendra e Arsimit që financohen me fondet e bashkisë, si edhe për vitin 2022 nuk janë hartuar Pasqyrat Financiare të Konsoliduara. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu IV “Përbërja, përgatitja dhe rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara” Kreu III pikat 23-27 dhe pika 103 dhe me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, Kreu X, neni 53 “Pasqyrat financiare dhe konsolidimi” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1.Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa, që në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 të kërkojë dhe të disponojë Pasqyrat Financiare të njësisve të varësisë si: Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Pasurisë Publike, Qendra e Kulturës dhe Klubi i Sportit dhe Qendra e Arsimit. Të kryejë konsolidimin e pasqyrave financiare të Bashkisë, të cilat të japin një pamje të strukturuar të pozicionit financiar dhe transaksioneve financiare me qëllim që, të japin informacion të besueshëm për vendimmarrje për vetë Bashkinë rreth burimeve financiare dhe alokimin e tyre, për mënyrën e financimit të aktiviteteve dhe kërkesave për fonde, për aftësinë e Bashkisë për të financuar aktivitetet dhe për të përmbushur detyrimet dhe angazhimet si dhe vlerësimin e performancës së Bashkisë.

Deri me datë 31.03.2024

6. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 1,738,957,622 lekë, ku sipas analizës është në vlerën 1,723,418,647 lekë, pasi në këtë vlerë është përfshirë në mënyrë të gabuar sipas kërkesës së degës së Thesarit Lushnje gjendja e llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 15,538,975 lekë në pasiv të bilancit, e cila duhej të ishte pjesë e gjendjes së llogarive kundër parti të saj në aktiv të bilancit si llog. 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” ose llog. 4342 “Të tjera operacione me Shtetin (të drejta)”. Në vlerën e lartë të gjendjes së llogarisë së debitorëve ka ndikuar edhe gjendja e debitorëve të taksave në vlerën 1,643,277,452 lekë, që zënë 95% të vlerës debitore. Pjesa tjetër janë detyrimet e lindura nga rekomandimet “shpërblim dëmi” të lëna nga KLSH në vite, për të cilat nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve, duke kaluar afatet e kërimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 42, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” pika 3.3 “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) nën-pika 8 “Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin” (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 66-95, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1.Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa që në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 të bëjë kontabilizimin e saktë të të drejtave të arkëtueshme nga të tretët në llog.468 “Debitorë të ndryshëm” dhe gjendjen e llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” ta kontabilizojë në llogarinë kundër parti në aktiv të bilancit si llog. 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” ose llog. 4342 “Të tjera operacione me Shtetin (të drejta)”.

Deri me datë 31.03.2024

7. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i përlllogaritjeve të amortizimit të AAGJ, rezulton se amortizimi është llogaritur për grup aktivesh në total dhe jo aktiv për aktiv, duke mos përlllogaritur saktësisht amortizimin, pasi aktive të ndryshme kanë vlerë të ndryshme amortizimi të akumuluar sepse kanë kohë (vite) të ndryshme përdorimi. Në mungesë të regjistrit të aktiveve me të dhënat e tij u bë e pamundur sondazhi i përlllogaritjes së amortizimit për aktive të veçanta në llogari të ndryshme si dhe përlllogaritja e saktë e amortizimit të aktiveve për të bërë diferencën. Kështu, në rastin e aktivit “komputer” është përlllogaritur gabim norma e amortizimit në masën 20% dhe jo sipas normës ligjore në masën 25%, pasi është përlllogaritur në grup në aktivet e llog. 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”. Në inventarët kontabël të llogarive 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 15,786,107 lekë; 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 249,000 lekë, 212 “Ndërtesa Konstrukione” në vlerën 411,698,111 lekë; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 3,569,343,129 lekë; 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 23,109,446

lekë janë azhurnuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit, sipas emërtesave të projekteve të investimeve, pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv. Për këto aktive nuk është kryer inventar fizik për të verifikuar statusin e tyre, nëse ekzistojnë apo jo dhe marrjen e masave për ndjekjen e procedurave ligjore për sistemimin e tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 66-95, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1.Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa të hartojë një regjistër të plotë historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vend-ndodhjen, përshkrimi i aktivit, vlera e blerjes, vlera e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlera e akumuluar e amortizimit dhe vlera e mbetur. Mbi bazën e tij të llogarisë amortizimin aktiv për aktiv si dhe të realizojë inventar fizik për të gjithë AAGJ, për verifikim e tyre dhe ekzistencës fizike.

Deri me datë 31.02.2024

8. Gjetje nga auditimi: Nga testet e transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi se janë kryer pagesa në vitin 2022 me urdhër-shpenzime në 33 raste faturash me vlerë 41,109,902 lekë, mbi afatin 30 ditor të faturave për shpenzime mallra e shërbime/ investime të mbërritura në Bashkinë Lushnje, ku në pjesën më të madhe të rasteve janë krijuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh dhe mbërritje me vonesë të faturave. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52, me ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 44 “Kontrolli i shpenzimeve” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 66-95, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1.Rekomandim: Bashkia Lushnje të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (*përrjashtuar kufizimet e MFE*), për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim mos krijim borxhi për fatura të pa likuiduara dhe krijimin e vështirësisë në aftësinë paguese.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Bashkisë Lushnje i janë transferuar në pronësi/në përdorim 6462 prona të paluajtshme publike, shtetërore, ku për 4 Njësi Administrative si Ballagat, Karbunarë, Hysgjokaj dhe Fiershegan janë në fazën e miratimit të listave paraprake. Nga këto prona janë hipotekuar 57 prona dhe janë në proces hipotekimi 54 prona të tjera. Për pjesën tjetër të pronave nuk është bërë inventarizimi dhe përditësimi i të dhënave. Nga ish-Titullari i Bashkisë ka dalë Urdhri nr.82 datë 22.06.2021 “Për ngritjen e strukturës së posaçme, që ka për objekt të veprimtarisë së saj inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave dhe regjistrin publik të pasurive të paluajtshme”. Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se, nuk janë kryer procedurat për miratimin e listave përfundimtare të pronave të transferuara pranë Bashkisë Lushnje për 4 NJA Ballagat, Karbunarë, Hysgjokaj dhe Fiershegan. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme Shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore” pikat 18,22, me ligjin nr.20/2020 datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV “Përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike” nenet 35-44, me Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të

kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 66-95, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1.Rekomandim: Bashkia Lushnje nëpërmjet strukturave drejtuese dhe përgjegjëse të marrë masa për kryerjen e procedurave të plota për miratimin e listave përfundimtare të pronave për 4 NJA Ballagat, Karbunarë, Hysgjokaj dhe Fiershegan, duke kryer inventarizimin dhe përditësimin e listave paraprake të pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM Bashkisë dhe NJA-ve dhe më pas miratimi me VKB e paraqitja pranë ASHK në Drejtorinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike me vërejtjet dhe ndryshimet e listave paraprake të pronave të miratuara. Gjithashtu për pjesën tjetër të pronave të kaluara Bashkisë me VKM në pronësi/përdorim të pa hipotekuara të përgatisë dokumentacionin tekniko-ligjor dhe të ndjekë deri në fund regjistrimin e tyre në ASHK, Drejtoria Rajonale Lushnje.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Bashkia Lushnje ka lidhur 71 kontrata për dhënien me qira të aseteve, me subjekte të ndryshëm fizik/ juridik, kryesisht për veprimtari bujqësore e blegtorale e kultivim të ullirit në parcelat e fondit të tokave bujqësore të pandara, ku 48 kontrata në vitet 2013 me afat 99 vjeçar, 1 me afat 40 vjeçar dhe 11 me afat 30vjeçar, për dhënie me qira të pasurisë “truall” 2 kontrata me afat 20 vjeçar, për veprimtari “Agro-pylltari” 3 kontrata me afat 10 vjeçar dhe 1 kontratë me afat 5 vjeçar për shfrytëzim të burimeve ujore nëntokësore në parcelat nga fondi pyjor, si dhe 5 kontrata me afat 1 vjeçar për dhënie me qira të ambienteve të ndërtesave për veprimtari tregtare. Kontratat shumëvjeçare nuk janë të noterizuara si dhe nuk ka të dhëna nëse janë regjistruar në ASHK Drejtoria Lushnje. Kontratat nuk janë shoqëruar me procesverbalin e marrjes në dorëzim të parcelës sipas inventarizimit fizik të gjendjes në terren. Në asnjë rast të kontratave të qiradhënies nuk është parashikuar në kontratë marrja në konsideratë e ndryshimeve ligjore në lidhje me tarifën e qirasë si dhe nuk është kryer monitorimi i kontratave. Në fund të vitit 2021 janë debitorë 7 subjekte në vlerën 6,196,410 lekë, gjatë vitit 2022 është shtuar vlera debitore 479,806 lekë, ndërsa në fund të vitit 2022 janë 7 subjekte debitorë në vlerën 6,676,216 lekë, *duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Lushnje*. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, nenet 826-829-840, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4/26, neni 11/4 dhe neni 12/f dhe UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kap III, pika 30, VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar, VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” dhe kontratat përkatëse pika 4 “dispozita të veçanta”, neni “Pagesa” ose “Të drejtat dhe detyrimet e përdoruesit” (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 66-95, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1.Rekomandim: Bashkia Lushnje nëpërmjet strukturave përgjegjëse për hartimin, menaxhimin dhe monitorimin e kontratave të qiradhënies së aseteve, të marrë masa për monitorimin e kontratave, në lidhje me zbatimin e objektit të kontratës, realizimin e detyrimeve të palës qiramarrëse, në lidhje me dëmtimet e pronës, dhe në të gjitha rastet të mbahen procesverbale dypalëshe. Nëse konstatohen parregullsi në zbatimin e kontratave të ndiqen procedurat administrative dhe ligjore pas shqyrtimit dhe miratimin në Këshill Bashkiak të problematikës. Të verifikohen nëpërmjet korrespondencës zyrtare nëse kontratat afatgjatë janë të regjistruara në ASHK Drejtoria Lushnje, nëse jo të bëhet regjistrimi i tyre. Të ndiqen të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës debitore të 7 subjekteve, që nuk kanë paguar detyrimet kontraktore të tarifës së qirasë në vlerën 6,676,216 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Bashkia Lushnje ka një sipërfaqe prej 379.58 km² dhe ka në përbërjen e saj 11 njësi administrative. Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV) është miratuar me Vendimin Nr.04 datë 29.12.2016 të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT-se). Plani është rishikuar me vendimin e KKT-së nr. 2, datë 13.01.2020. Sipërfaqja që mbulohet nga Bashkia Lushnje është ndarë në 1,453 njësi strukturore të veçanta dhe për secilën është hartuar një pasaportë, e cila përfshin kushtet e planifikimit për atë njësi strukturore. Njësitë strukturore të cilat parashikohen të trajtohen me PDV, përfshijnë një sipërfaqe prej 136.7 ha në qytetin e Lushnjes dhe 17.2 ha në Njësite Administrative të zonës rurale.

Në vitin 2022 është miratuar plani i detajuar vendor me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Nr. 442, datë 18.07.2022 për njësinë strukturore 1/108 në qytetin e Lushnjes. Plani i detajuar vendor, sa më sipër, nuk figuron i azhurnuar në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit në sistemin GIS. Në Bashkinë Lushnje rezulton se nuk ka struktura (drejtori/sectorë/njësi) të dedikuara për Informacionin Gjeohapësinor (GIS), dhe nuk janë kryer proceset e grumbullimit, përpunimit dhe përditësimit të informacionit gjeohapësinor.

Sa më sipër, është në kundërshtim me pikën 4, neni 25 i Ligjit Nr.107, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, pikën 7.3 në paragrafin 4.2.1 në Vendimin Nr.402, datë 20.05.2020 “Për miratimin e dokumentit të politikave për qeverisjen e sektorit të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri”.

Mungesa e burimeve dhe ekspertizës të dedikuar për IG, ka shkaktuar një informacion me cilësi të ulët, mungesën e interesit për përdorimin e IG, cilësinë e dobët në përdorimin e burimeve dhe kohës në dispozicion (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 95-111, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1. Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Lushnje të marrë masa për publikimin në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit të planeve të zhvillimit, që miratohen nga Bashkia si edhe të gjitha akteve që autoriteti përgjegjës për zhvillimin e territorit nxjerr lidhur me vendimet për leje, ato në proces, etj.

11.2. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Lushnje të marrë masa për ngritjen e strukturës (drejtori/sectorë/njësi) të dedikuar për Informacionin Gjeohapësinor, me qëllim rritjen e cilësisë së vendimmarrjes në dhënien e lejeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Bashkia Lushnje ushtron përgjegjësinë e kontrollit të territorit dhe zbatimit të ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, nëpërmjet inspektoratit të mbrojtjes së territorit, i cili është i përbërë nga 4 punonjës, k/Inspektori me arsim të lartë akademinë e rendit, 2 inspektorë terreni (njëri me formim juridik dhe tjetri me arsim të mesëm të përgjithshëm) dhe Juristi.

Në vitin 2022 në Bashkinë Lushnje struktura e IMT përbëhej nga k/inspektori me arsim të lartë ekonomist, 2 inspektorë terreni me arsim të mesëm të përgjithshëm, si edhe 1 jurist. Pra, k/Inspektori nuk është me profesion inxhinier ndërtimi sipas kërkesave ligjore. Në vitin 2022, nga 61 subjekte të penalizuara me vendime për dhënie gjobe, 9 prej tyre në vlerën gjithsej prej 3,240,000 lekë ose 28 % të vlerës totale të gjobave të dhëna, kanë ankimuar vendimet e IMT dhe janë në procese gjyqësore. Me urdhrin nr.118, datë 22.05.2022 është vendosur gjobë për punime të kryera pa leje në shtyrje të afatit, sipas procesverbalit të konstatimit të shkeljes nr.122, datë 21.05.2022, por nuk është marrë një vendim për pezullimin e punimeve, gjithashtu nuk është përcaktuar një afat kohor paraprak i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e

detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikën ç) neni 5, gjithashtu me pikën c) neni 13, të Ligjit Nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”. Në inspektoratin vendor të mbrojtjes së territorit në Bashkinë Lushnje, inspektorët e IMT nuk kanë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 11 të Ligjit Nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”. Mungesa e kontributeve profesionale të IMT ndikon në përmbushjen e detyrave si në drejtim të gjykimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, ashtu edhe në marrjen e vendimeve gjatë ushtrimit të detyrave të tij (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 11-114, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Lushnje të marrë masa për rritjen e kontributeve profesionale në inspektoratin e mbrojtjes të territorit, me qëllim rritjen e cilësisë së punës së Inspektoratit dhe bashkëveprimin me strukturat e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Menjëherë dhe në vijimësi

13.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimeve të zhvilluara nga Autoriteti kontraktor për vitin 2022 rezultoi se, Dosjet fizike të procedurave të prokurimit të paraqitura për auditim por dhe e gjithë praktika e ndjekur ndër vite nga ky Autoritet Kontraktor nuk janë të inventarizuara dhe të sistemuara nga ana dokumentare për të gjitha fazat e procedurës deri në zbatimin e kontratës, në kundërshtim me nenin 74, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 114-117, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1.Rekomandim: Njësia e Prokurimit të marrë masat që në përfundim të procedurave të prokurimit të inventarizohet në mënyrë të rregullt, të plotë e kronologjike të gjithë dokumentacionit që lidhet me procedurën e prokurimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

14.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në procedurën e prokurimit me objekt: “Sistemim, Asfaltim i rrugës Jakov Xoxa dhe vazhdimi pas Unazës” nga AK në DST në kriteret e veçanta për kualifikim, në pikën 2.5.b – ka kërkuar: *Certifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit OHSAS 18001-2007 ose ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit)*. Nga AK është gabuar pasi Certifikata e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit OHSAS 18001-2007 është shfuqizuar dhe për rrjedhim do të duhej të kërkonte vetëm certifikatën për standardin e përditësuar (ISO 45001:2018). Një kërkesë e tillë ka rezultuar edhe në 2 procedurat e prokurimit të zhvilluara nga ky Autoritet Kontraktor e konkretisht në procedurat: “Ndërrhyrje në infrastrukturën e rrugës Unaza e ish depos së Duhanit” dhe “Sistemim, Asfaltim segmentit rrugor: “Taulla Sinani- Esmat Dervishi”. Për këto 2 procedura është ndërhyrë nga APP (Kordinatori) dhe nga AK është korrigjuar nëpërmjet ndryshimeve të dokumenteve të tenderit. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 95-111, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1.Rekomandimi: Njësia e Prokurimit të argumentojë një për një teknikisht e ligjërish duke pasur për bazë objektin e prokurimit si dhe zërat e volumet e punës të parashikuara në preventiv që të gjitha kërkesat për kualifikim të kërkuara si pjesë e Dokumenteve Standarde të Tenderit, me qëllim provimin nga Operoret Ekonomik të kapaciteteve teknike e profesionale.

Menjëherë dhe në vijimësi

15.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se në 5 procedurat e prokurimit (konkretisht: 1.Procedura me objekt: “Ndërtimi i tregut në lagjen Xhevdet Nepravishta” me nr. REF-22598-03-18-2022; 2.Procedura me objekt: “Ndërhyrje në infrastrukturën e rrugës Unazë e ish depos së duhanit” me nr. REF-36236-07-13-2022; 3.Procedura me objekt: “Sistemim, Asfaltim i rrugës Shpresa plus rrugës së Repartit në Zhamë Sektor” me nr. REF- 27742-05-06-2022; 4.Procedura me objekt: “Sistemim, Asfaltim i rrugës Jakov Xoxa dhe vazhdimi pas unazës” me nr. REF-34084-06-23-2022 dhe 5.Procedura me objekt: “Ndërhyrje në infrastrukturën e rrugës Vasilika Gogu dhe Hysen Dervishi” me nr. REF-40255-08-30-2022,) si në DST ashtu dhe në kontratat e lidhura me operatorët fitues ku është përcaktuar grafiku i pagesës konstatohet se, për këto prokurime nga AK nuk kanë qenë në dispozicion fondet e nevojshme për realizimin e punëve, duke qenë përpara kontratave prokurimi me kohëzgjatje jo shumë vjeçare, sipas DST por dhe Kontratës së lidhur për afat përfundimi të punimeve të parashikuar nga AK. Ky veprim është në kundërshtim me Paragrafin 2, të nenit 77 “Urdhëri i Prokurimit” ; Pikën 2 të nenit 85 “lidhja e kontratës” Pikën 1 dhe 3 të nenit 106 “Kohëzgjatja e kontratës” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 95-111, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

15.1.Rekomandim: Autoriteti Kontraktor, të marrë masat e nevojshme që në përfundim të procedurave të prokurimit të nënshkruaj kontratën vetëm pasi fondi i nevojshëm për realizimin e kontratës të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2022 realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë Lushnje paraqitet në masën 71.59 %, nga 610,900 mijë lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 437,372 mijë lekë. Referuar akt-rakordimeve për të ardhurat konstatohet se, për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulëta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet më shumë mbi planin, fakt që tregon se planifikimi i të ardhurave në disa zëra të ardhurash nuk është mbi baza reale si edhe në disa zëra të tjerë të ardhurash nuk është bërë punë e mjaftueshme për arkëtimin e tyre, gjë që ka sjellë ndikim negativ në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave. Vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në fund të vitit 2021 është në vlerën **1,487,784,334 lekë**, vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2022 është **155,493,118 lekë** dhe gjendja e debitorëve në mënyrë progresive në fund të vitit 2022 është në vlerën **1,643,276,112 lekë** e cila përbëhet nga:

- Detyrimet nga taksat dhe tarifatat e biznesit të vogël dhe të madh në shumën **409,906,944 lekë**;
- Detyrimet nga taksat dhe tarifatat e familjareve në shumën **1,233,369,168 lekë**;

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, Kreu XI-

“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” nenet 89,90,91 93 dhe 94, ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshime, neni 181.VKB nr. 100, datë 23.12.2021 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Lushnjes dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2022”(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 39-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Lushnje, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të vitit 2022 në vlerën progresive **1,643,276,112 lekë**, ku përveç masave shtrënguese të marra si urdhër bllokimet e llogarive bankare, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme), në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar:

-Të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo ditë të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar dhe nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

- Të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Lushnje, për mos kalimin e subjekteve debitore me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

- Në dosjet e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Lushnje aktualisht familjet ngarkohen me detyrime për taksën e ndërtesës e truallit dhe tarifave pastrim-gjelbërim-ndriçimit. Nga të dhënat në dispozicion, në Bashkinë Lushnje dhe NJA taksohen gjithsej 57680 familje më shumë se numri i familjeve të regjistrit aktual të Gjendjes Civile prej 20,283 familje, numër i cili shërben për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë "familjar". Nga familjarët e taksuar konstatohet se në Bashkinë Lushnje dhe NJA në fund të vitit 2021 janë trashëguar 44366 familje me vlerë debitorë prej 770,085,178 lekë dhe në fund të vitit 2022, janë gjithsej 45411 familje debitore për vlerën **815,931,493 lekë**, nga të cilat 39768 taksapagues për vlerën 61,451,531 lekë janë debitorë të krijuar brenda vitit 2022. Bashkia Lushnje ka si Agjent Tatimor për arkëtimin e tarifës së pastrimit dhe taksën e ndërtesës Sha Ujësjellës-Kanalizime Lushnje, e cila sipas akt rakordimit me Bashkinë Lushnje për të ardhurat rezulton se deri në fund të vitit 2022 ka mbetur pa u derdhur Bashkisë vlera në mënyrë progresive prej 58,253,311.09 lekë nga vlera e deklaruar e maturimit prej 58,253,311.09 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me VKB nr.100, datë 23.12.2021, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Lushnjes dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2022”, Kreu III neni 16,17, Kreu V “Taksa mbi truallin” neni 24, me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, neni 12 pika 1, ligjin nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4 pika 7, ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 70 dhe 117 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 39-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandim: Bashkia Lushnje nëpërmjet Drejtorisë së të Ardhurave Vendore të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore të debitorëve familjarë në vlerën **815,931,493 lekë**, si dhe të plotësojë e përditësojë regjistrin për taksapaguesit e kategorisë familjare me të gjitha të dhënat e nevojshme, i cili të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve vendore, që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të

Bashkisë Lushnje. Gjithashtu të shqyrtohet mundësia e arkëtimit të shumës së të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore të mbledhur nga agjenti tatimor Sha Ujësjellës Kanalizime Lushnje në vlerën **58,253,311 lekë**, nëse nuk është e mundur të shikohet mundësia e ndëshkimit me gjobë sipas dispozitave ligjore në fuqi për detyrimin e pa derdhur ndaj Bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, realizimi i taksës bujqësore është në vlerën 45,904 mijë lekë nga 100,000 mijë lekë, ose në masën 45.9%, ku 27648.16 Ha, sipërfaqe shërben si bazë për planifikimin e kësaj takse. Regjistri i taksës për tokën bujqësore ka mangësi në numrin e taksapaguesve objekt taksimi, pasi në këtë regjistër nuk janë kryer përditësimet për çdo vit, pasi ASHK Lushnje nuk ka dërguar të dhëna mbi transaksionet e kryera në tokën bujqësore (shitje-blerje) me qëllim përditësimin e regjistrit të taksës së tokës bujqësore. Arkëtimi i kësaj takse paraqitet me problem në Bashkinë Lushnje, për arsye se familjet, të cilat taksohen për tokën bujqësore në 60 % të tyre janë të identifikuar me të dhënat personale (emër, atësia, mbiemër, Nr. Id, datëlindje) dhe 40 % e taksapaguesve nuk janë të identifikuar me të dhënat personale, me qëllim arkëtimin e kësaj takse. DAV Bashkia Lushnje arkëtimin e kësaj takse e mundëson vetëm kur familjari/personi që ka në përdorim/ pronësi tokë bujqësore, aplikon pranë Bashkisë Lushnje për të marrë një vërtetim/shërbim të caktuar, si dhe duke kryer procedurën e dërgimit të Njoftimit detyrimeve me anën e shërbimit postar pranë adresave të deklaruara. Debitorët për taksën e tokës bujqësore në fund të vitit 2021 janë në vlerën 346,648,955 lekë, gjatë vitit 2022 janë krijuar 15047 familje debitorë për vlerën 70,788,720 lekë dhe në fund të vitit 2022 debitorët në vlerë progresive janë **417,437,675 lekë**. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 pika1, Aneksi 1 dhe me VKB nr.100, datë 23.12.2021, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Lushnjes dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2022” Kreu IV “Taksa mbi tokën bujqësore” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 39-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandim: Bashkia Lushnje, nëpërmjet Drejtorisë së të Ardhurave Vendore të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksën e taksës bujqësore nga debitorët fermerë në vlerën **417,437,675 lekë**. Drejtoria e të Ardhurave Vendore nëpërmjet Strukturave drejtuese të bashkëpunojë me ASHK Lushnje për marrje informacioni dhe të marrë masa për të identifikuar numrin e familjeve me të dhënat personale, që kanë në pronësi apo në përdorim tokë bujqësore si dhe sipërfaqen e saktë që ato zotërojnë, me qëllim krijimin e një regjistri me të dhëna të plota dhe të sakta. Ky regjistër më pas të shërbejë si bazë për të bërë, planifikimin e plotë dhe përlllogaritjen e detyrimeve që ju lindin këtyre familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Lushnje.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit financiar të pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet e ndërtimeve informale rezulton se, në Bashkinë Lushnje vlera debitorë për taksën e infrastrukturës nga përfituesit e legalizimeve deri në datë 31.12.2022 është **33,991,461 lekë**, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Lushnje. Vlera e debitorëve në fund të vitit 2021 prej 40,144,563 lekë e raportuar në KLSH nga Bashkia Lushnje është vlerë e pasaktë për arsye se, është bërë mbledhja e gjendjes debitorë progresive në fund të vitit 2020 prej 15,337,415.55 lekë dhe gjendja debitorë progresive në fund të vitit 2021 prej 24,807,149 lekë, duke dubluar vlerën e debitorëve. Nga korrespondenca zyrtare e Bashkisë Lushnje me ASHK Rajonale Lushnje për periudhën objekt auditimi rezulton

se, gjatë vitit 2022 është krijuar gjendje debitore prej **9,787,133 lekë**. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, ligjin nr. 95/2018 “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c, ligjin nr. 98/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 1, neni 27, pika 3, shkronja “c”, me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “ Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5 dhe VKB nr. 100, datë 23.12.2021, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Lushnjes dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2022” kreu VII (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 39-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1.Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Lushnje të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore mbi subjektet debitore për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 617 debitorë në vlerën **33,991,461 lekë**, si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Lushnje të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) Rajonale, Lushnje për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen, si dhe të bëhen marrëveshje për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Në territorin e Bashkisë Lushnje për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 78 subjekte me status “aktiv” në QKB nga të cilët 68 subjekte me aktivitet karburant dhe 10 me aktivitet tregti gaz, gjithashtu 20 subjekte janë me status çregjistruar ose pezulluar. Për vitin 2022 janë konstatuar 38 subjekte pa licencën e tregtimit me pakicë të karburantit dhe 5 subjekte tregti gaz. Me shkresën nr.prot.6769, datë 01.08.2022 Bashkia Lushnjë ka dërguar informacion në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës dhe Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial u ka kërkuar marrjen e masave nga ana e tyre për bllokimin e të gjithë karburanteve dhe pikave të tregtimit të gazit, të cilat nuk janë të pajisura me Autorizimin përkatës, si dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar për marrjen e masave për të gjithë ata subjekte, të cilët nuk janë të pajisur me autorizimin e hyrje-dalje në autostradë. Nga ana e institucioneve të sipërpërmendura nuk është ndërmarrë asnjë masë për moslejimin e ushtrimit të aktivitetit për këto subjekte. Referuar dosjeve të subjekteve që operojnë në territorin e Bashkisë Lushnje për shitje me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tij konstatohet se, kanë **detyrime të papaguara 39 subjekte në vlerën 29,550,000 lekë**, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Lushnje. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, nenet 4,15 dhe 20/2” dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, kreu II, pika 3, pika 15.1 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 39-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1.Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Publike dhe Sociale të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për tarifën e autorizim/licencën në ushtrimin e aktivitetit të shitjes së hidrokarbureve, të papaguara nga **39 subjektet në vlerën 29,550,000 lekë**.

Nga strukturat drejtuese të Bashkisë Lushnje të vazhdohet komunikimi zyrtar institucional me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës, me Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial për marrjen e masave nga ana e tyre për bllokimin e të gjithë karburanteve dhe pikave të tregimit të gazit, të pa licencuara, si dhe me Autoritetin Rrugor Shqiptar për marrjen e masave për subjektet, të cilët nuk janë pajisur me autorizimin e hyrje-daljeve në autostradë.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE.

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH-ja, mbështetur në nenin 15 “*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, nenin 58 “*Llojet e masave disiplinore*”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”, i rekomandojmë Kryetares së Bashkisë Lushnje, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

a - “Vërejtje” neni 58 shkronja (a), për 12 punonjës si më poshtë:

1. **z.D. N** me detyrë Drejtor i të Ardhurave Vendore,
2. **z.K. M** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Vlerësimit, Asistencës dhe Shërbimit ndaj Tatimpaguesve
3. **z.A. S** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit dhe Zbatimit
4. **z. D. S** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Borxhit

Për mangësitë e konstatuara:

Në mospërputhje me kërkesat e VKB nr.100, datë 23.12.2021, VKB nr.100, datë 23.12.2021, “*Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Lushnjes dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2022*”, të ligjit nr.139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*” i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr.68/2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, neni 12 pika 1, ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “*Për sistemin e taksave vendore*”, i ndryshuar, neni 3/3 neni 4/1,7, neni 6/3 neni 23 neni 24, neni 4 pika 7, nenet 89, 90, 91,93,94 si:

- Mos planifikim i të ardhurave mbi bazë reale, duke mos pasqyruar saktë bazën e tatueshme dhe burimin e të ardhurave, proces i cili sjell ndikim negativ në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore.

- Mos marrjen e masave për mbledhjen e detyrimeve tatimore nga biznesi i madh, i vogël dhe familjarë, të cilat në fund të vitit 2022 janë në vlerën progresive debitore prej 1,643,276,112 lekë për taksa e tarifa vendore.

- Planifikim jo i saktë i taksës bujqësore, pasi familjet, të cilat taksohen për tokën bujqësore në 60 % të tyre janë të identifikuar me të dhënat personale (emër, atësia, mbiemër, Nr. Id, datëlindje) dhe 40 % e taksapaguesve nuk janë të identifikuar me të dhënat personale, me qëllim arkëtimin e kësaj takse. Mos arkëtim i taksës bujqësore, ku realizimi i saj është në masën 45.9% dhe detyrimet debitore progresive në fund të vitit 2022 janë në vlerën 417,437,675 lekë.

5. **zj. M. H** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Për mangësitë e konstatuara:

- Për mos zbatim të kërkesave të VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, si dhe ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë*”, për objektet që legalizohen, të VKB nr. 100, datë 23.12.2021, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Lushnjës dhe penaltitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2022” kreu VII rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë 617 persona në vlerën 33,991,461.8 lekë.

6. **zj. Xh.T** me detyrë specialiste për transportin dhe licencat profesionale (për periudhën 15.05.2022)

Për mangësitë e konstatuara:

- Për moszbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 datë 10.07.2014 nenet 4, 15, 20 pika 2, 11 dhe me VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, kreu II, pika 3, gjë që ka sjellë mos arkëtimin e vlerës prej **29,550,000 lekë** nga **39 subjekte** që ushtrojnë aktivitetet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse.

7. **zj. J. H** me detyrë Drejtoresë e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe të hartuesit të pasqyrave financiare

Për mangësitë e konstatuara:

Për moszbatim të Udhëzimit e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

- Për vitin 2022 nuk janë hartuar Pasqyrat Financiare të Konsoliduara.

- Në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, në mbyllje të vitit 2022 është përfshirë në mënyrë të gabuar gjendja e llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 15,538,975 lekë e cila duhej të ishte pjesë gjendjes llogarive 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” ose llog. 4342 “Të tjera operacione me Shtetin (të drejta)”

- Amortizimi është llogaritur për grup aktivesh në total dhe jo aktiv për aktiv, duke mos përllogaritur saktësisht amortizimin. Në rastin e përllogaritjes së aktiveve artikulli “kompjuter” është përllogaritur gabim norma e amortizimit në masën 20% dhe jo 25%, siç i takon këtij grup aktivesh, sipas normave të miratuara.

- AAGJM në llogaritë: 210 “Toka, Troje, Terrene”, 211 “Pyje, Plantacione”, 212 “Ndërtesa Konstruksione”; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”; 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” janë azhurnuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit, , pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv, në mungesë të një libri të plotë aktivesh. Për këto aktive nuk është ngritur në strukturat drejtuese problemi i kryerjes së inventarit fizik për të verifikuar statusin e tyre, nëse ekzistojnë apo jo dhe marrjen e masave për ndjekjen e procedurave ligjore për sistemimin e tyre.

- Në vitin 2022 janë paguar me urdhër-shpenzime në 33 raste faturash me vlerë 41,109,902 lekë, mbi afatin 30 ditor të faturave për shpenzime mallra e shërbime/ investime të mbërritura në Bashkinë Lushnje.

8. **z.B. H** me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Prokurimeve Publike.

Për mangësitë e konstatuara:

- Kontratat shumëvjeçare nuk janë të noterizuar si dhe nuk ka të dhëna nëse janë regjistruar në ASHK Drejtoria Lushnje. Në asnjë rast të kontratave të qiradhënies si ato të hershmet dhe ato të rejat nuk është parashikuar në kontratë marrja në konsideratë e ndryshimeve ligjore gjatë kohës që shtrihet afati i kontratës sidomos në lidhje me tarifën e qirasë si dhe nuk është kryer monitorimi i kontratave në lidhje me objektin dhe detyrimet e përdoruesit.

- Në hartimin e 3 kontratave 1 vjeçare për dhënien e objekteve me qira nuk është përcaktuar mënyra e pagesës së qirasë dhe mbështetja e ligjore e shpërndarjes me përqindje e të ardhurave të përfituara. Gjithashtu në kontratë nuk përcaktohet ndryshimi i vlerës ose kushteve të saj në varësi të ndryshimeve në legjislacion.

9. **zj. S. M** me detyrë specialiste për ligjshmërinë në Zyrën e Menaxhimit të Aseteve

10. **zj. L. M** me detyrë specialist topograf në Zyrën e Menaxhimit të Aseteve

11. **zj. J. S** me detyrë specialist për inventarizimin e Aseteve në Zyrën e Menaxhimit të Aseteve (për periudhën 01.01.2022-31.10.2023, aktualisht specialiste në DAV)

12. **zj.E. P** me detyrë specialiste në Zyrën e Menaxhimit të Aseteve (për periudhën 01.01.2021-07.08.2022 dhe aktualisht specialiste auditit në AB për periudhën gusht 2022 e në vazhdim)

Për mangësitë e konstatuara:

Për moszbatim të VKM nr.500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme Shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendor”, ligjin nr.20/2020 datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimi nr.15 datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”.

- Nuk janë kryer procedurat për miratimin e listave përfundimtare të pronave të paluajtshme Shtetërore dhe transferimin e pronave në Bashkinë Lushnje për 4 NJA Ballagat, Karbunarë, Hysgjokaj.

- Janë 6462 të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, të transferuara në pronësi ose në përdorim Bashkisë Lushnje dhe 8 e Njësi Administrative, nga të cilat janë hipotekuar 57 prona dhe janë në proces hipotekimi 54 prona të tjera, ku për pjesën tjetër të asetëve nuk janë kryer procedurat e regjistrimit në ASHK.

- Kontratat shumëvjeçare për dhënien me qira të parcelave pyjore si nga fondi pyjor dhe nga fondi i tokave bujqësore të pa ndara nuk janë shoqëruar me inventarizimin fizik të gjendjes në terren e shoqëruar me procesverbalin e marrjes në dorëzim si dhe nuk është kryer monitorimi i kontratave në lidhje me objektin dhe detyrimet e përdoruesit.

F. Për punonjësit e larguar.

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte “Vërejtje” përkatësisht:

1. z. E. K me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Publike dhe Sociale (për periudhën 01.01.2022 deri 03.05.2022, larguar)

2. zj.K. Sh me detyrë specialist topograf në Zyrën e Menaxhimit të Aseteve (për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, larguar për vitin 2023)

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLI I LARTE I SHTETIT